

**Amnisti për
"27 prillin" po,
por jo për
dhunuesit**

Fq.4



**FORUM
EKONOMIK**
Ndhmë
për grupet e
margjinalizuara

Fq.4



**Kandidohet
Sejdini?**

Sport

Fq.19



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3531 · e martë, 11 dhjetor 2018

-4°C | 4°C

15 DEN



**KOHA për
kulturë**

Fq.12-15

FORUM

**Kriza e
Makronit,
një rrezik
për mbarë
Evropën**




Për hir të Evropës, Emanuel Makron ka nevojë për ndihmën, dhe jo neverinë apo urrejtjen tonë. Një president i ri, reformist në Francë, që premtoi një "rilindje evropiane", e sheh tanimë veten duke u përpëlitur në krye të një vendi, që po bëhet sërish dhe me shpejtësi "e sëmura e Evropës". Momenti me domethënës i protestave, ishte kur protestuesit shpërftyruan fityrën e përmendores së Marianës, simbolit të republikës në Harkun e Triumfit në Paris. Vetëm 3 javë... Fq.10

RAJON

**Në Kosovë
jepet mito
dhe ndërhyhet
në drejtësi** Fq.16

GLOBI

**Një hap
para krizës
ekonomike** Fq.17



GRAMOS RUÇI I DREJTOHET PARLAMENTIT

PA PRETENDIME NDAJ MAQEDONISË



"Shqipëria nuk ka asnjë pretendim territorial ndaj asnjë vendi fqinj. Kundrejt zërave shpesh herë të motivuara nga qëllime të brendshme të qarqeve apo individëve politikë, vendi ynë nuk ka asnjë projekt apo nën tryezë për krijimin e 'Shqipëri të Madhe'", theksoi Ruçi Fq.3

Ushqim cilësor për t'u mbrojtur nga ndotja

Shkup, 10 dhjetor - Qytetarët e Maqedonisë vazhdojnë të jetojnë akoma në zona ku ndotja e ajrit është një kërcënim për shëndetin. Ndotja e ajrit jo vetëm që mund të shkaktojë sëmundjen kronike pulmonare e të përkeqësuar astmën, por edhe të vrasë njerëz, thonë mjekët. Organizatat që luftojnë ndotjen e ajrit thonë se duhet të bëhet ndryshim duke mbështetur ligjet për ajrin e pastër dhe duke kundërshtuar

përpjekjet që dëmtojnë këto rregullore. Në aspektin individual, rekomandohet që të shmangjet ngrohja me dru apo të plehrave, dhe në ambiente të hapura dhe të mbyllura. Njerëzit, veçmas ata me sëmundje kronike dhe astmë, duhet të mbrohen e të marrin masa për mos keqësimin të gjendjes shëndetësore. Nga institucionet përgjegjëse thonë se të gjitha organet e shtetit kanë për qëllim zbatimin... Fq.7



EDITORIAL

PËR SERBINË,
KOSOVA ËSHTË STANDARD
PARAADERUES PËR NË BE

Emin AZEMI

Vendosja e disa masave reciproke ndaj Serbisë (tash së fundmi edhe heqja e tabelave serbe të veturave dhe vendosja e atyre të përkohshme), përfundimisht ka shkundur letargjinë e të gjithë atyre që kishin menduar se depërtimi i Serbisë në Kosovë, kishte vetëm karakter ekonomik e tregtar. Me vetë faktin se kohë më parë ishte publikuar një dokument "Top Sekret" i Shërbimit Sekret të Serbisë (BIA) që kishte të bënte me strategjinë e Beogradit në fushën e ekonomisë, ku parashiheshin masa konkrete për depërtimin agresiv të Serbisë në tregun e Kosovës dhe paralizimin e ekonomisë së kësaj të fundit, tregonte qëllimin e qartë të Beogradit që Kosovën nga varshmëria ekonomike ta shndërrojë edhe në varshmëri të natyrave të tjera nga Serbia. Të gjitha shqetësimet serbe burimin e kanë në pavarësinë e Kosovës dhe mbështetjen e saj nga një pjesë e madhe e shteteve perëndimore, në krye me SHBA-të. Këto shqetësimet po bëhen edhe më të mëdha këtyre ditëve kur është paralajmëruar formimi i Ushtrisë së Kosovës.

Logjika hegjemoniste serbe nuk e ka lehtë të pajtohet me një realitet të ri që po krijohet para hundëve të saj, kurse propaganda që po përhapet me të madhe në Serbi ditëve të fundit po tregohet e paaftë ta paraqes këtë realitet si favor i politikave aktuale që po udhëheq kreu serb. Maniret e vjetra të paketimit të këtij realiteti si vuajtje e popullit serb në Kosovë, po tregohen si të dalë boje, sepse janë jo pak media botërore që kanë regjistruar kamionë të mbushur plot me mallra që në rrugë klandestine kanë depërtuar në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në enkalvat tjera serbe. Në anën tjetër, edhe Qeveria e Kosovës është treguar e gatshme të furnizojë shitoret dhe barnatoret e serbëve me barna dhe ilaçe, pa pasur nevojë që kjo popullatë të trajtohet me nota vajtuese nga mediat e Beogradit.

Një kohë të gjatë Serbia ka qenë ajo që ka zhvilluar një luftë të pistë tregtare ndaj Kosovës, me ç'rast ishte përpiluar edhe strategjia e dëmtimit në formë të ndryshme të prodhuesve vendor. Në këtë strategji ishin përpunuar të dhënat me detaje për të gjitha kompanitë kosovare, potenciali i tyre, pikat e dobëta, dhe aksionet/hartat të cilat

operativët e BIA-s në terren kishin ndërmarrë ndaj atyre dhe prodhimet e tyre. Në listën e gjatë të BIA figuronin kompanitë më të fuqishme të Kosovës, të cilat duhej të zëvendësoheshin me kompanitë serbe, në mënyrë që ekonomia e këtij vendi të mos bankrotonte. Ndër to përmendej Fluidi (Gjilan) me prodhimin e "Jaffa-s", cili duhej të zëvendësohej me kompaninë serbe "Nektar", pastaj Pestova (Vushtrri) me prodhimin e "Vipa Çips", që duhej të zëvendësohej me produktin serb "Çips", Fruteks (Suharekë) me prodhimin e "Golden Eagle", që duhej të zëvendësohej me produktin serb "Guarana", M Silosi (Rahovec) me prodhimin e miellit "Finesa", si zëvendësim për "Fidelinka", Kllokoti (Kllokot) me prodhimin e "Ujit Kllokoti", si zëvendësim për "Heba", Liri (Prizren) me prodhimin e "Sempre" si zëvendësim për "Plazma Keks", "Eurofood" (Prizren) me prodhimin e "Tomato Keçap" si zëvendësim për "Diamant Keçap", qumështi Vita (Istog) me prodhimin e "Vita" si zëvendësim për "Moja Kravica", "Gllareva" (Gllarevë) me prodhimin e "Spec i kuq Dukagjini", si zëvendësim për "Aleva", "ASK Foods" (Gjilan) me prodhimin e "ASK marmelata", si zëvendësim për "Pionir Mermelada", "Stone Castle" (Rahovec) me prodhimin e "Stone Castle", si zëvendësim për "Navip".

Kjo strategji serbe kishte bërë që Kosova, ndonëse nuk njihet si e pavarur nga Serbia, megjithatë të mbetet 'parajsë' për ndërmarrjet e caktuara serbe, qoftë në zvogëlimin e obligimeve tatimore, qoftë në ikjen e tërësishtme të tatimeve. Për habinë e të gjithëve, kjo strategji djallëzore e Beogradit, as që ishte regjistruar nga radarët e burokratëve të Brukselit. Këta të fundit një kohë të gjatë abuzuan me disponimin dhe orientimin proserb të Kosovës dhe shqiptarëve dhe për rrjedhojë vendosën standarde asimetrike, duke e favorizuar Serbinë, në kufijtë e përkëdhelisë së pakuptimtë. Është koha e fundit që standardet të rikthehen në kuptimin burimor të tyre, duke respektuar të gjitha parimet që parashohin dokumentet dhe konventat para aderuesve në BE, ku Serbia, mbi të gjitha, duhet tregohet se nuk është më ajo e mëparshme, luftënxënësja e konflikteve të përgjakshme, por një Serbi tjetër që e pranon realitetin e ri, përfshi edhe pavarësinë e Kosovës.

STUDENT, MOS LËSHONI PE

"Studentë shqiptarë, mos lëshoni pe në kërkesat tuaja minimaliste, sepse Ju nuk jeni studentë të Instagrameve, e të dembelisë së mediave sociale, por, shtresa më aktive, më fisnike dhe më e padjallëzuar sociale, që mund ta konkretizoj angazhimin dhe përkushtimin e vetë edukues, përmes rezistencës paqësore. Një rezistence, shumë më këmbëngulëse në krijimin e parakushteve ekzistenciale, për një arsimim e edukim koherent me rrjedhat e botës së civilizuar. Ju bëjë apel, që të mos bjeni assesi pre e 'kudestarive' eventuale; partiake e ideologjike! Por, në ndërkohë, assesi mos e mohoni përkrahjen dhe solidaritetin e gjerë qytetar! Sepse, vetëm nëse animoni publikun e gjerë shqiptar, Ju do mund të bëheni edhe aktorë e protagonist evident, edhe për një ndryshim të mundshëm substancial të qeverisjes së degraduar, tashmë politike. Keni shans reale t'i konvertoni në favorin Tuaj, ato katër kërkesa minimaliste! Merrni, lëksion nga studentët francez, të cilët për katër javë të tëra, me këmbëngulje imponante, po u rezistojnë teknokratëve francez për të fuqizuar frymën europiane të ndryshimeve! Sukseset", shkruan në profilin e tij në Facebook, sociologu kosovar, Fadil Maloku.

PËR USHTRINË E KOSOVËS

"Nëse ka dilema se ke duhet dëgjuar për ta bërë apo jo ushtrinë, atëherë ja mendimi im për cilindo që mund t'i hyjë në punë. BE-ja, OKB-ja dhe NATO-ja një ditë mund të shpërbëhen, por SHBA-ja nuk shpërbëhet kurrë. Ne duhet t'i dëgjojmë të gjitha palët dhe të vendosim sipas interesit tonë dhe këshillës së SHBA-së. Ajo gjithmonë do të jetë superfuqi botërore dhe gjithmonë në krahun tonë", shkruan në Facebook, shkrimtari Liri Loshi.

MASA RRËNJËSORE PËR
ARSIMIN

"Ministria e Arsimit nuk ka përse pret që studentët të paraqesin kërkesat e tyre me anë të një delegacioni, kjo është një gjë, kurse nga ana tjetër nëse mendon se vërtet studentët kanë të drejtë, atëherë të nisi marrjen e masave rrënjësore për të dalë nga kjo krizë e arsimit të lartë. Unë sot shoh urgjente që:

1. Të shkarkohen të gjithë anëtarët e bordeve të administrimit të universiteteve. Duke i pezulluar ato borde derisa të ndryshohet mekanizmi i menaxhimit të universiteteve.
2. Të pranohet abrogimi ose nevoja për amendime shumë të thella të ligjit për arsimin e lartë.
3. Të krijohet një këshill emergjence me aprovimin e studentëve për të realizuar të gjitha ndryshimet rrënjësore në modelin e universiteteve shqiptare.

MEDIACitate

NIKOL
PASHINYAN
FITUES I
ZGJEDHJEVE
NË ARMENI

Fitues i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Armeni është aleanca "Emri im" e udhëhequr nga kryeministri i përkohshëm, Nikol Pashinyan, që fitoi 70.4 për qind të votave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Armeni njoftoi rezultatet jozyrtare të zgjedhjeve të mbajtura ditën e djeshme. Sipas rezultateve paraprake, 48.6 për qind e 2.5 milionë votuesve të regjistruar kanë votuar në zgjedhje. Aleanca "Emri im" e kryesuar nga partia "Kontrata civile" e Pashinyan ka marrë 70.4 për qind të votave. Përveç aleancës së drejtuar nga Pashinyan, në Parlamentin e Armenisë kanë mundur të hyjnë dy parti që kanë arritur të kalojnë pragun zgjedhor. Partia Armenia e Begatë e qendrës së djathtë nën drejtimin e biznesmenit Gagik Tsarukyan ka marrë 8.2 për qind dhe Partia e Ndrishme e Armenisë nën kryesimin e Edmon Marukyan ka marrë 6.3 për qind të votave. Ndërsa Partia Republikane e kryesuar nga ish-presidenti Serzh Sargsyan ka marrë 4.7 për qind të votave dhe Partia Tashnak 3.9 për qind, ku në këtë mënyrë nuk kanë mundur të hyjnë në parlament pasi nuk kanë kaluar pragun zgjedhor. Në Armeni për partitë që hyjnë të vetme në zgjedhje ka një prag prej 5 për qind, ndërsa për aleancat një prag 7 për qind. Pjesëmarrja në zgjedhje ka mbetur shumë më e ulët nga sa pritej, ku nga 2.5 milionë votues armenë kanë votuar 48.6 për qind e tyre. Kjo pjesëmarrje në zgjedhjet e mëparshme ka qenë 60 për qind. Në zgjedhjet e parakohshme në Armeni, garuan 11 parti dhe aleanca. Pas formimit të parlamentit, deputetët e rinj do të zhvillojnë një seancë më 31 dhjetor ku do të zgjedhin kryeministrin i cili gjithashtu do të formojë qeverinë.

(Anadolu Agency, 10 dhjetor)

NËSE NUK
E KËNI DITUR...A E DINI SECILI ËSHTË USHQIMI QË KONSUMOHET
MË SHUMË NË BOTË?

Orizi është i pranishëm në qindra varietete të dietës së përditshme të popujve të secilit kontinent dhe është gjithashtu edhe ushqimi më i konsumuar në botë. Për herë të parë ai është përdorur si ushqim në Azi, ku konsumohet prej së paku 10 mijë vitesh dhe akoma sot përbën bazën ushqimore për miliarda njerëz. Përshtatshmëria e tij me terrenet dhe temperaturat e ndryshme ka bërë që ky ushqim të ketë sukses në çdo

cep të botës. Veç orizit dhe drithërave, mes ushqimeve më të përhapura janë edhe makaronat dhe picat. E nëse për konsumin e makaronave Italia zë vendin e parë (thuaje 30 kilogramë në vit për person) për konsumin e picës, vendin e parë e mbajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me një mesatare konsumi 13 kilogramë për person. Çdo vit në SHBA nga furra dalin 900 milionë pica.

GRAMOS RUÇI I DREJTOHET PARLAMENTIT

SHQIPËRIA PA PRETENDIME NDAJ MAQEDONISË

“Shqipëria nuk ka asnjë pretendim territorial ndaj asnjë vendi fqinj. Kundrejt zërave shpesh herë të motivuara nga qëllime të brendshme të qarqeve apo individëve politikë, vendi ynë nuk ka asnjë projekt apo nën tryezë për krijimin e ‘Shqipëri të Madhe’”, theksoi Ruçi

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 10 dhjetor - Dialogu parlamentar midis të dyja vendeve kohën e fundit është në rritje, megjithatë ne kemi edhe mundësi të tjera të cilat janë të pashfrytëzuara. Shqipëria dhe Maqedonia janë dy vende fqinje, dy vende miqësore të cilat i ka bashkuar historia e largët, por edhe e afërt, theksoi sot kryetari i Parlamentit të Republikës së Shqipërisë Gramos Ruçi, gjatë fjalimit në Parlamentin e Maqedonisë. Ai theksoi se Maqedonia dhe Shqipëria kanë në bashkëpunim shumë të mirë ekonomik, duke theksua se po bëhen përpjekje për krijimin e një infrastrukture, për lëvizje të lirë të mallrave, njerëzve dhe të kapitalit.

“Ne lartë i vlerësojmë përpjekjet për modernizimin e Maqedonisë. Për vendimet historike të cilat i keni marrë, për përshtetimin e ritmit të proceseve demokratike dhe integruese. Ju keni dëshmuar vullnet dhe frymë evropiane drejt modernizimit të Maqedonisë. Muajve të fundit me ndërjegjien dhe pajtueshmërinë tuaj morët dy vendime dhe ligje historike, ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe ligjin për ndryshimin e emrit kushtetues të vendit tuaj. Këto janë vendime të mëdha”, theksoi Ruçi, ndërsa shtoi se, fakti që vizita e tij po ndodh në momen-



I PËRMBUSHIM STANDARDET PËR PAKICAT

Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve për atë se çka është bërë në Shqipëri për pakicën maqedonase, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Ruçi tha se në ligjin për pakicat nacionale ku janë të përfshirë edhe të drejtat e pakicës nacionale maqedonase siç thotë, “i përmbush të gjitha standardet ndërkombëtare për trajtimin e pakicave”. “Komuna e Prespës ku jetojnë banorë të

pakicës nacionale maqedonase sipas parametrave që janë paraparë me ligjin e ri të organizimit territorial nuk i përmbushin kushtet e nevojshme që të formojnë komunë. Megjithatë, si Qeveri, si shtet, vendosëm atë ta mundësojmë edhe ata të funksionojnë si komunë, të zgjedhin kryetarin e komunës dhe përbërjen e saj si edhe komunat tjera”, ka thënë Ruçi.

te të rëndësishme për të ardhmen e Maqedonisë, është dëshmi e qartë se Shqipëria është njëra ndër mbështetëset e vendit.

“Zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit, përmes realizimit të ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe miratimin e ndryshimeve kushtetuese për çështjen e emrit të vendit, dhe përmes votimit përfundimtar do ta vërtetojë rrugën e pakthyeshme të Maqedonisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO”, theksoi kryetari i Parlamentit shqiptar. Ruçi tha se Shqipëria është

prononuar se është e hapur dhe pa rezervë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.

“Të dyja vendet plotësisht e meritojnë anëtarësimin, jo vetëm për angazhimin dhe detyrën tonë, por edhe si faktor të rëndësishëm për paqen në rajon. Ne jemi të vetëdijshëm për vështirësitë në të cilat po ndodhet BE-ja, jemi të vetëdijshëm edhe për eurospekticizmin dhe për tendencat ekstremiste nacionaliste dhe raciste në disa vende anëtare të Unionit. Anëtarësimi i të dyjave vendeve tona me popullatë proe-

vropiane vetëm do ta përforcojë boshhtin progresiv integruet të Evropës, potencoi Ruçi. Theksoi se shqiptarët dhe maqedonasit sipas rrënjëve, sipas kulturës, sipas shpirtit janë popuj evropianë, duke theksuar se në një të ardhme të afërt do të bashkëngjiten drejt familjes evropiane edhe formalisht edhe juridikisht. “BE-ja në klimën e konkurrencës globale dhe në funksion të qëllimeve strategjike duhet t’i shohë dhe vlerësojë marrëdhëniet e vendeve tona. BE-ja ka nevojë për rajonin tonë, siç edhe vendet

tona kanë nevojë për integrimin në familjen e madhe evropiane”, u shpreh Ruçi. Ai theksoi se rruga e të dyja vendeve drejt Unionit, ka pasur dhe do të ketë vështirësi dhe barriera, ndërsa përgjegjësia buron edhe nga veprimi i faktorëve të brendshëm dhe fenomeneve të korrupsionit apo krimit të organizuar. “Integrimi i rajonit drejt BE-së para së gjithash kërkon stabilitet të brendshëm afatgjatë të secilit vend, zgjidhja e moskuptimeve përmes dialogut, shmangien e konflikteve të mundshme, si dhe pranimin e realiteteve të reja të krijuara”, theksoi kryetari i Parlamentit të Shqipërisë.

Sipas tij, se Shqipëria promovon politikë rajonale mbi bazë të parimeve të njohura të respektimit të sovranitetit të vendeve fqinje dhe të rajonit, mospërzjerje në politikën e brendshme, bashkëpunim me interes të ndërsjellë në funksion të eurointegritit të plotë, ruajtjen e paqes dhe sigurisë rajonale. “Shqipëria nuk ka asnjë pretendim territorial ndaj asnjë vendi fqinj. Kundrejt zërave shpesh herë të motivuara nga qëllime të brendshme të qarqeve apo individëve politikë, vendi ynë nuk ka asnjë projekt apo nën tryezë për krijimin e ‘Shqipëri të Madhe’”, theksoi Ruçi, duke konkluduar se shqiptarët në Maqedoni me rolin e tyre qenësor në demokratizimin e dhe avancimin e shoqërisë janë bartës dhe kontribuues të drejtpërdrejtë në zhvillimin e të drejtave dhe zhvillimit të prosperitetit, bashkëjetesës dhe të ardhmes evropiane të vendit.

Han: Nuk ka gjasa Gruevski të ekstradohet

Bruksel, 10 dhjetor - Eurokomisari për zgjerim, Johanesh Han, mëngjesin e djeshëm para fillimit të Këshillit të ministrave të punëve të jashtme të BE-së tha se nuk beson se



Nikolla Gruevski do të ekstradohet nga Hungaria në Maqedoni. I pyetur nëse i mbështetë amendamentet e Parlamentit Evropian në raportin për Maqedoninë ku kërkohet që Hungaria të kthejë Gruevskin në Maqedoni, Han u përgjigj “shpresoj se ajo do të ndodh, por nuk ka shumë mundësi sepse të dy vendet nuk kanë asnjë marrëveshje, dhe e kuptoj pozitën e Parlamentit Evropian”. Han tha se me ministrat Nikola Dimitrov dhe Radmila Shekerinska gjatë javës së kaluar kanë biseduar për “rrugën përpara” për Marrëveshjen e Prespës në javët e ardhshme, si dhe për reformat të cilat duhet të zbatohen që Maqedonia të fitoj raport pozitiv nga ana e Komisionit Evropian.

XHAFERI PËR AMENDAMENTET KUSHTETUESE

Më 15 janar vuloset “Maqedonia Veriore”

Shkup, 10 dhjetor - Komisioni për amendamentet e Kushtetutës, të cilat dalin si detyrim nga Marrëveshja e Prespës, do të fillojë më 17 dhjetor, seanca plenare duhet të caktohet më së voni 9 janar të vitit të ardhshëm, ndërsa votimi të ndodhë më 15 janar. Kështu deklaroi dje kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, sipas të cilit, me përfundimin e punës së Komisionit, i cila do të rrjedh sipas fazave që janë paraparë në Rregulloren, parashikimet janë se më së largu më 9 janar do të thirret seancë plenare e cila duhet të përfundojë më 15 janar.

“Sot përfundojnë dy diskutimet e fundit publike që i organizon Qeveria në Shtip dhe në Tetovë. Tani Qeveria ka përdetyrë të dorëzojë raportin deri në Kuvend lidhur me debatet publike si dhe propozim-amendamente që duhet të debatohen në fazën përfundimtare të seancës plenare. Konform Rregullores, Komisioni debatues do të ndodhë më 17 dhjetor ku do të mund të propozohen amendamente nga ana e Qeverisë. Me përfundimin e atij Komisioni e cila do të rrjedh si-



pas fazave që janë paraparë në Rregulloren, parashikimet e mia janë se më së largu më 9 janar do të thirret seancë plenare e cila duhet të përfundojë më 15 janar ku do të ndodhë votimi final i amendamenteve të Kushtetutës”, ka thënë Xhaferi në pres konferencën e përbashkët me kolegun e tij shqiptar, Gramoz Ruçi.

Lidhur me shqetësimin e shprehur të liderit të BDI-së Ali Ahmeti rreth miratimit të ndryshimeve kushtetuese, Xhaferi ka thënë se është me siguri apel për

të patur kujdes në veprimet që të mos irritohet, apo provokohet situata e cila do të ishte në kundërshtim me përcaktimet për implementim të tërësishëm të Marrëveshjes së Prespës. “Pas përmbushjes së detyrimeve tona, radhën e ka Greqia e cila duhet të ratifikojë Marrëveshjen e Prespës në Parlamentin e saj dhe protokollin për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në NATO me çka rumbullakohet ky proces”, ka thënë Xhaferi, pas takimit me kryeparlamentarin e Shqipërisë, Gramoz Ruçi. (Z.V)

“Nëse gjatë këtyre dy ditëve nuk pranojmë përgjigje konkrete pozitive nga ana e Qeverisë dhe Komitetit parlamentar për pajtim, do të vazhdojmë me grevën e urisë si dhe do të organizojmë protesta të qeta nga familjarët tanë para Qeverisë së Maqedonisë”, thuhet në njoftimin me shkrim të burgosurve

Shkup, 10 dhjetor - Të burgosurit e burgut më të madh në Maqedoni - Idrizovë, kanë paralajmëruar se do të futen në grevë dyditore urie. Ata kërkojnë të përfshihen në Ligjin për amnisti dhe ai të mos ketë të bëjë vetëm me ngjarjet e 27 prillit, ndërsa njoftimin me shkrim ia kanë dërguar drejtorit të burgut.

“Zotëri drejtor, ju njoftojmë se ne, të dënuarit, nga sot fillojmë grevën dyditore të urisë, sepse përkundër kërkesave tona drejtuar Qeverisë dhe kryeministrit, deri tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje për Ligjin për amnisti që tashmë po përgatitet. Duam amnisti të përgjithshme për të gjitha veprat që i lejon Kushtetuta e Maqedonisë, gjithashtu statusi i të dënuarve të përjetshëm të kthehen në dënim me vite burg, gjithmonë konform ligjeve

TË BURGOSURIT PRESIN PËRGJIGJE NGA QEVERIA DHE ZAEVI

FILLON GREVA NË IDRIZOVË, KËRKOHEM AMNISTI



evropiane. Nëse gjatë këtyre dy ditëve nuk pranojmë përgjigje konkrete pozitive nga ana e Qeverisë dhe Komitetit parlamentar për pajtim, do të vazhdojmë me grevën e urisë si dhe do të organizojmë protesta të qeta nga familjarët tanë para Qeverisë së Maqedonisë”, thuhet në njoftimin me shkrim të të burgosurve.

Ndërkohë, e para që ka mbështetur grevën e të dënuarve të Idrizovës është Aleanca për Shqiptarët e Ziadin Selës. Përmes një komunikate, ASH ka shprehur mbështetjen e plotë si subjekt politik për hapin që kanë paralajmëruar

të burgosurit, sepse, “konsiderojmë se kjo është një drejtë themelore e tyre”. “Aleanca për Shqiptarët konsideron se një vendim i tillë është i pritshëm dhe i logjikshëm, sidomos pas paralajmërimeve për të amnistuar dhunuesit e 27 prillit të vitit të kaluar. Aleanca për Shqiptarët përkujton opinionin disa herë me radhë se qëndrimi politik i ASH-së rreth mundësisë për amnisti të huliganëve dhe dhunuesve të tempullit të demokracisë, përbën një precedent të rrezikshëm, që do të bartë pasojë për rrugën euro-intergruese të vendit por dhe reflektimi që mund

të ketë në aspekt të sigurisë së brendshme të vendit”.

Aleanca për Shqiptarët, vijon më tej komunikata, kërkon që kjo temë shumë serioze të analizohet më mirë, të debatohet dhe nëse insistohet që me çdo kusht të falen disa huliganë për të cilët ka dëshmi të shumta për veprat penale që kanë kryer, atëherë është e logjikshme që ata që po vuajnë burgjeve, me vite të tëra pa asnjë dëshmi konkrete, urgjentisht të lirohen si të pa fajshëm sepse nuk ka nevojë të falet dikush që vuan dënim nga procese të montuara politike. (O.Xh)

Kundër rritjes së çmimit për parkim

Shkup, 10 dhjetor - Sindikata e të punësuarve në Qendrën Klinike “Nënë Tereza” reagoi për rritjen e propozuar të parkimit vjetor për të punësuarit në vendet e parkimit në kompleksin e klinikave dhe kërkon nga ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, ta shfrytëzojë autoritetin e tij personal dhe të institucionit për tejkalimin e këtij problemi. Sipas sindikatës, rritja e paralajmëruar e çmimit të shërbimeve të parkingut më së shumti do t'i prek të punësuarit në Qendrën Klinike të cilët marrin neto pagë prej 12.503 denarë. “Njëkohësisht nëse Këshilli i Qytetit të Shkupit e voton këtë propozim të NP ‘Parkingjeve të qytetit’ dhe i njëjti fillon të zbatohet, rritja e planifikuar e pagës për këtë kategori të të punësuarve prej 5 për qind për vitin 2019, duke filluar nga paga e shtatorit në këtë bazë, praktikisht barazohet me zero për qind”, thonë nga Sindikata. Nga Sindikata thonë se nëse votohet propozimi i NP “Parkingjet e qytetit” atëherë do të detyrohen të ndërmarrin masa përkatëse për mbrojtjen e anëtarëve të tyre.

ZAEVI SHPREHET I PRERË

Amnisti për “27 prillin” po, por jo për dhunuesit

Shkup, 10 dhjetor - Në periudhën e ardhshme nuk planifikohet miratimi i një Ligji për amnisti të përgjithshëm. Bisedohet vetëm për amnisti për ngjarjet më 27 prill në Parlament, por duke i përjashtuar të gjithë ata që kanë marrë pjesë në dhunë, organizim apo kanë qenë konceptuesit. Kështu ka thënë dje kryeministri Zoran Zaev, ndërsa konfirmoi se ka marrë letër nga të dënuarit nga burgu në Idrizovë se do të mbajnë grevë urie, nëse aprovet amnistia vetëm për pjesëmarrësit në ngjarjet e 27 prillit, nga ana e Trupit parlamentar për pajtim.

“Bisedohet për Ligj për amnisti për ngjarjet e 27 prillit, por duke i përjashtuar të gjithë ata që kanë marrë pjesë në dhunë, organizim apo kanë qenë konceptuesit e ngjarjeve të këtyra të tmerrshme. Maqedonia solli Ligj për amnisti të përgjithshme, Parlamenti këtë e ka bërë para disa muajve. Nuk mundet asnjë shtet modern në çdo gjashtë apo nëntë muaj të miratojë Ligj për amnisti. Praktika në botë është që ligje të përgjithshme për amnisti të aprovet në çdo katër deri tetë muaj. Kështu që deri



30 për qind të asaj që është lejuar të amnistohet gjithkund në Evropë, ka qenë e lejuar edhe në Maqedoni. Parlamenti e ka marrë vendimin përmes një Ligji të ri për amnisti dhe kjo tashmë është zbatuar. Në periudhën e ardhshme nuk do të ketë Ligj të përgjithshëm për amnisti”, tha Zaevi pas debatit të përgjithshëm për ndryshimet kushtetuese, që u mbajt në Qendrën komunale multimediale “Kiro Gligorov” në Shtip.

Në ndërkohë, grupi parlamentar për pajtim, reforma dhe integrim në Parlamentin e Maqedonisë, takimi vijues do të mbahet me siguri të mërkurën, paralajmëruan

anëtarë të grupit. Takimi i djeshëm i nëngrupit të punës për pajtim u ndërpre për shkak të informacioneve të reja, për të cilat janë të nevojshme konsultime shtesë lidhur me vendimet ligjore për amnistinë e një pjesë të pjesëmarrësve në ngjarjet e 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë vitin e kaluar.

Kryesuesi i këtij nëngrupi, Zekir Ramçiloviç, tha se në mënyrë shtesë do të informohet për vazhdimin e takimit në të cilin duhet që të rregullohet propozimi ligji për amnisti. Në takimin e djeshëm të nëngrupit mori pjesë edhe zëvendësministri i Drejtësisë, Oliver Risteovski.

Institucionet e pavarura gjyqësore, garanci për të drejtat e njeriut

Shkup, 10 dhjetor - Realizimi i të drejtave të qytetarëve fillon në nivel të vogël, gjithkund përreth nesh, nga shtëpia, familja, shkolla, mjedisi i punës... Ato janë vendet ku duhet të kërkohej të drejtat e barabarta, mundësitë e barabarta, respektimi i dinjitetit pa diskriminim, pa këtë ata nuk mund të luftojnë në bashkësinë më të gjerë ose në botë. Duhet të sigurohet gjyqësi e pavarur, e liruar nga ndikimet politike, të biznesit, ndërsa në procedurat gjyqësore të respektohet e drejta e prezumimit të pafajësisë dhe t’i sigurohet gjykim i drejtë. Këto ishin qëndrimet e një pjesë të pjesëmarrësve në konferencën e sotme “70 vite nga Deklarata universale për të drejtat e njeriut: roli i avokatëve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut”. Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, theksoi se realizimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut në Maqedoni nuk është në nivel të lartë dhe se edhe më tutje ka mosesim të lartë në institucionet dhe sundimin e së drejtës. Këtë vit për 41 për qind është rritur numri i qytetarëve të cilët ankohen për sistemin gjyqësor në krahasim me vitin e kaluar. Vitin e kaluar për këtë janë ankuar 576 qytetarë, ndërsa këtë vit ai numër është rritur në 811. Sipas Memetit, për 60 për qind më shumë ankesa ka për të drejtat nga lëmi i marrëdhënieve të punës, për marrëdhëniet pronësore për 37 për qind dhe për të drejtat e fëmijëve, dhunës familjare, moskujdesit për fëmijët...për 25 për qind. Ministrja e Drejtësisë Renata Deskoska thotë se sfida e Qeverisë në luftën për realizimin e të drejtave të qytetarëve është edhe më e vogël nëse kemi parasysh, siç tha, se Maqedonia sapo ka dalë nga ajo që teoria e quan “shtet i robëruar”. Sipas Deskoskës pavarësia e gjyqësisë për të cilën angazhohemi të gjithë, paraqet shtyllë të të drejtave të njeriut dhe për këtë, potencon, në atë drejtim janë ndryshimet e ligjeve për gjykata dhe këshilla gjyqësore si dhe ndjekja e rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Pavarësia dhe përkrahja e gjyqësorit nga partitë politike, lobi-grupeve, biznes-intereseve, udhëheqësia e gjykatave është kyçe për sigurimin e drejtësisë dhe garancinë e të drejtave. Ajo shtoi edhe se realizimi i të drejtave duhet të fillojë nga niveli më i ulët, nga shtëpia, familja, shkollat dhe mjedisi i punës. Pas kësaj, tha, mund të kërkohej realizimi i të drejtave në bashkësinë më të gjerë dhe në botë.

Analizat dhe ekspertiza e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Shkup tregojnë se likuidimi i katër të rinjve dhe peshkatarit të Liqeni i Smilkovës tyre është realizuar shpejtë, nga afër dhe me plumba të cilët mund të dalin vetëm nga armët me tyta të gjata

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 10 dhjetor - Vrasja e pesëfishit në Liqenin e Smilkovës në prill të vitit 2012 është realizuar në një interval të shkurtë kohor dhe nga afër. Në prezantimin e ekspertizës të Institutit për Mjekësi Ligjore (IML), në seancën e fundit për rastin "Monstra", u tha se mjekët dhe specialistët në vendngjarje kanë arritur rreth orës 22 më 12 prill, ku edhe janë parë trupat e katër të rinjve dhe trupi i peshkatarit të vrarë. Sipas mjekut ligjor, Zlatko Jaqovski, i cili e ka kryer ekspertizën e trupit të peshkatarit Borçe Stefanovski dhe të riut Filip Sllavkovski, nën trupat e të viktimit ka pasur gjak, që e vërteton faktin se ekzekutimi i tyre është realizuar në atë vend.

"I ndjeri Stefkovski është gjetur i vdekur pak më larg se trupat e viktimit tjerë. Nga ajo që pamë kur arritëm në vendngjarje, ishte se i ndjeri Stefkovski ishte afër veturës së tij, i kthyer me fytyrë drejt pjesës së përparme të makinës. Në trupin e tij kishte pesë plagë nga arma e zjarrit, prej të cilëve kryesorja ishte në kokë. Si pasojë e kësaj plaje, një pjesë e trurit i ishte shpërndarë mbi pjesë e përparme të veturës, ndërsa katër plagët tjera i kishte në shpinë dhe qafë. Toka nën të ishte

MJEKËSIA LIGJORE PREZANTOI EKSPERTIZËN PËR RASTIN "MONSTRA"

EKZEKUTIMI NË SMILKOVË ËSHTË KRYER SHPEJTË



FAMILJARËT NUK I DËGJUAN DËSHMITË E VRASJES

Familjarët e djemve dhe peshkatarit të vrarë nuk morën pjesë në seancën e djeshme, pasi siç theksuan paraprakisht, është shumë e dhimbshme për ta dhe nuk do të mund t'i ndjekin dëshmitë rreth mënyrës se si janë ekzekutuar djemtë e tyre. Rasti "Monstra" nga shkurti i këtij viti filloi nga fillimi dhe akoma ndodhet në procedurë dëshmuese. Për vrasjen e pesëfishit në Liqenin e Smilkovës më 12 prill 2012, kur janë vrarë djemtë Kire Triçkovski, Filip Sllavkovski, Cvetanço Ackovski, Aleksandar Naqevski dhe peshkatarin Borçe Stefanovski, me burgim të përjetshëm u dënuan Alil Demiri, Afrim dhe Agim Ismailloviq, Fejzi dhe Haki Aziri dhe Sami Luta. Gjykata Supreme në dhjetor të vitit të kaluar i pezulloi aktgjykimet dhe rastin e ndërmori PPS.

plotësisht gjakosur. Të shtënat ndaj tij janë realizuar nga një largësi prej një metra e gjysmë. Përderisa ekspertiza e realizuar mbi të ndjerin Filip Sllavkovski ka konstatuar se ai kishte tre plagë nga armë zjarri, respektivisht plaga e cila e kishte shkaktuar vdekjen kishte qenë në zemër. Ndaj tij po ashtu është shtënat nga afër. Ai u gjet në pozitë të shtrirë, i përmbysur dhe me

këmbë të mbledhura", tha mjeku ligjor Jaqovski.

Analizat dhe ekspertiza e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Shkup, kur bëhet fjalë për viktimit në rastin "Monstra", thonë se likuidimi i tyre është realizuar shpejtë, nga afër dhe me plumba të cilët mund të dalin vetëm nga armët me tyta të gjata. Mbase ekipet e para të IML-së në Liqenin e Smilkovës kishin ar-

ritur disa orët pas ngjarjes, Jaqovski theksoi se ekspertizën mbi trupat e viktimit kanë realizuar tre ekipe të mjekësisë ligjore, përfshi edhe veten në ato grupe. Në vendngjarje, po ashtu siç informuan nga IML, janë gjetur gëzhoja të shumta. Nga gjithsej pesë të vrarë natën e kobshme të 12 prillit të vitit 2012, siç informoi Goran Pavlovski, mjek nga IML, plagë më të shumta nga arma e zjarrit kishte marrë i ndjeri Aleksandar Naqevski.

"Në trupin e të ndjerit Naqevski janë zbuluar tetë plagë, prej të cilëve kryesorja kishte këputur lidhjen e boshtit kurrizor me trurin. Plagët tjera ishin në pjesën e kurrizit, të cilët kishin depërtuar në pjesën e zemrës dhe më tej. Ndërkaq gjatë ekspertizës së të ndjerit Kire Triçkovski janë konstatuar katër plagë, me çka kryesorja ishte në zemër. Trupat e Naqevskit dhe Triçkovskit kanë qenë afër njëri-tjetrit, gjegjësisht këmbët e të ndjerit Triçkovski kanë qenë mbi trupin e pajetë të Naqevskit", theksoi Pavlovski, mjek ligjor në IML.

Plagë po thuajse të njëjta atë ditë kishte marrë edhe i ndjeri Cvetanço Acevski. Ndryshe, ekspertiza e trupave të ndjerë është realizuar edhe në aspektin toksikologjik, ku është vërtetuar se në gjakun e viktimit nuk ka pasur asnjë përqindje të alkoolit apo substancave narkotike. Seanca e radhës për rastin "Monstra" është caktuar të mbahet me datë 20 dhjetor.



Eugen Cami, u.d. kryetar i Dibrës

Dibër, 10 dhjetor - Këshilli i Komunës së Dibrës në seancën e djeshme të rregullt, për ushtrues detyre kryetar komune, me shumicë votash e zgjodhi Eugen Camin, këshilltar prej radhëve të Aleancës për Shqiptarët. Nga gjithsej pesëmbëdhjetë këshilltarë, qsa i numëron Këshilli, Cami i mori tetë vota edhe atë tre këshilltarët nga partia e tij, dy nga VMRO-DPMNE, dy nga BESA dhe një këshilltar nga PE. Ai në këtë funksion do të jetë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës, për çka do të zbatohen zgjedhje. "Meqë ligji parasheh zgjedhjen e një Kryetari të ri të Komunës në afat prej gjashtë muajsh, tek ne prej vdekjes së kryetarit paraprak me siguri kryetari i ri do të zgjidhet në ditën kur do të zbatohen zgjedhjet presidenciale. Kjo me qëllim që të mos bëhen shpenzime plotësuese", deklaroi Bashkim Mashkulli, kryetar i Këshillit. Kryetari i deritanishëm Ruzhdi Lata, për të cilin ishte mandati i dytë si kryetar komune, pas një sëmundje të shkurtër dhe të rëndë, vdiq më 24 nëntor, në moshën 65-vjeçare. U.d. kryetar i Komunës, Cami u falënderua për besimin dhe theksoi se do të punojë për të mirën e qytetarëve dhe të komunës. Cami është pensionist, i lindur në vitin 1940 në Dibër, ndërsa e ka përfunduar edhe akademinë e lartë pedagogjike.

Shkup, dy të vdekur dhe 31 të lënduar në 34 aksidente

Shkup, 10 dhjetor - Një shofer dhe një shoqërues kanë vdekur në aksidentin, ndërsa dy çiklistë janë lënduar më rëndë në dy aksidente që kanë ndodhur gjatë vikendit në rrethinën e Shkupit. Lëndime të lehta trupore kanë marrë 29 persona në 16 aksi-

dente trafiku. Sipas buletinit policor, në rrethinën e Shkupit gjatë vikendit kanë ndodhur gjithsej 34 aksidente, ndërsa në 15 është shkaktuar dëm material. Gjithsej 180 shoferë kanë vozitur më shpejtë nga se lejohet, ndërsa nga komunikacioni janë

përfshirë 21 persona të cilët kanë vozitur nën ndikimin e alkoolit. Policia ka përfshirë nga komunikacioni edhe 33 shoferë para se të pajisen me të drejtën e vozitjes së automjetit dhe gjashtë shoferë fillestarë, si dhe 26 automjete të paregjistruara.

Njëmbëdhjetë shoferë kanë kaluar dritën e kuqe të semaforit, ndërsa 27 shoferë nuk kanë pasur pajisje adekuate dimërore. Janë shqiptuar 125 gjoba për parkim jo të rregullt, ndërsa me automjetin special "karrotreci" janë larguar 74 automjete.

RRËFEHET TRUPROJA E MITKO ÇAVKOVIT

Më 27 prill, Çavkovi "shëtiste" nëpër Shkup

Shkup, 10 dhjetor - Mitko Çavkov, drejtor i Byrosë për Siguri Publike, gjatë kohës së natën së përgjakshme të 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë, nuk ka qëndruar në selinë e VMRO-DPMNE-së. Këtë deklaratë të enjten e dha Nikolla Dimitrievski, ish-truproje e Çavkovit, i cili me rrëfimin e tij e demantoi të akuzuarin Aleksandar Vasilevski-Ninxha, ku ditë më parë, Ninxha në dëshminë e tij potencoi se Çavkovin, rreth orës 18:10, të 27 prillit, e kishte takuar në katin e tetë të selisë së VMRO-së në të

ashtuquajturin "baza e sulmit të 27 prillit". Në dëshminë e tij, Dimitrievski, theksoi se atë ditë, përveç tij, Çavkovin e kanë siguruar dhe dy truproje tjera.

"Rreth orës 14:00, më 27 prill, Çavkovin e kemi marrë nga shtëpia. Fillimisht shkuam në dentist, më pas në Siti Moll, pas asaj në lokal "Skara bar", tha Dimitrievski. Rreth orës 18 e kanë dërguar tek zyra e tij në ndërtesën "Techno-metal Vardar", ku Çavkovi ka qëndruar dy orë, e pastaj e kanë dërguar në MPB ku ka qenë deri në

mesnatë. Dimitrievski theksoi se rreth orës 19, para derës së zyrës së Çavkovit, ka dëgjuar se ai flet me zë më të lartë dhe u jep urdhra personave zyrtarë.

Në shtabin e MPB-së, sipas dëshmisë së Dimitrievskit, ka ardhur edhe ministri Agim Nuhiu. Gjatë gjithë kohës derisa ka qenë në shtab, Çavkovi i ka dhënë pothuajse 99 për qind të urdhrave, ndërsa rreth mesnatës ka kërkuar që ta dërgojnë në shtabin e VMRO-DPMNE-së që të shihet me Nikolla Todorovin, pas së cilës ka ikur



në shtëpi. Në dëgjimin e kryqëzuar nga i pandehuri Aleksandar Vasilevski Ninxha, Dimitrievski mohoi se Çavkovi ka qenë në VMRO-DPMNE nga ora 18:20 deri në 19:15. Siç tha, me siguri mund të

konfirmojë se Çavkov para mesnate nuk ka qenë në shtabin e VMRO-së. Dimitrievski mohoi edhe se shoferi i Çavkovit, Vangell Cakonçev rreth orës 19:20 ka qenë para Parlamentit. (O.Xh)

Bizneset duhet të gjejnë mënyrë që të krijojnë fitim duke përdorur praktikën e përgjegjësive shoqërore, si dhe për të krijuar vende pune për të gjitha grupet e qytetarëve, pavarësisht statusit të tyre social apo ekonomik

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 dhjetor - Bizneset nevojitet të gjejnë mënyra që të krijojnë fitim duke përdorur praktikën e përgjegjësive shoqërore, si dhe për të krijuar vende pune për të gjitha grupet e qytetarëve, pavarësisht statusit të tyre social apo ekonomik. Biznesi më nuk i është orientuar vetëm të sjellë profit, por edhe të përkujdeset për çështjet sociale dhe të ambientit jetësor, duke punësuar një pjesë të punëtorëve nga kategoritë e prekshme. Njëherazi edhe shteti me masa të ndryshme do të ndihmojë bizneset që punësojnë qytetarët me nevoja të veçanta. Ndërmarrjet sociale konsiderohen si modele të mundshme efektive për adresimin e çështjeve të rëndësishme sociale që ndikojnë drejtpërdrejt në grupet e marginalizuara.

Kjo ndër të tjerash u theksua në Forumin e kompanive të mira "Ekonomi e re, bizneset krijojnë vlera sociale, ekonomike dhe ekologjike", që u mbajt të hënën në Shkup.

"Bizneset, institucionet e qeverisë dhe të gjithë të tjerët në shoqëri duhet të koncentrohen që të gjejnë mënyra, si dhe të identifikojnë procese afariste, apo tregje të reja. E gjithë kjo me përdorimin e teknologjisë. Pra, duhet të gjenden mënyra për të sjellë fitime duke përdorur praktika që janë të favorshme për mjedisin dhe shoqërinë. Të krijohen vende të reja pune për të gjitha grupet e qytetarëve, duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta. Kjo në fakt do të thotë përmirësimin e shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së ambientit" thotë ambasadori i BE-së, Samuel Zhbogar. Sipas tij, kompanitë që kanë përgjegjësi shoqë-

FORUM I EKONOMISË SOCIALE

NDIHMË PËR GRUPET E MARGJINALIZUARA



rore mund të jenë edhe lidere në reduktimin e ndotjes, ku gjendja është alarmante.

Zbogar, më tej shtoi se Bashkimi Evropian ka zhvilluar mënyra të ndryshme për të stimuluar ekonominë sociale. Kompanitë që mbulojnë më shumë se 500 punëtorë duhet të raportojnë për ndikimin e tyre pozitiv social.

Nga ana tjetër, ministri i Financave, Dragan Tevdovski theksoi se qeveria me politika përkatëse do të mbështesë zhvillimin e kompanive që kanë shumë mundësi në kohën e ndryshimeve të shpejta teknologjike. Një nga fushat ku ekziston hapësirë për avancim, është sipërmarrja sociale që arrin rezultate të jashtëzakonshme në Bashkimin Evropian.

"Si pjesë e direktivave të BE-së, në Ligjin e ri të Prokurimit Publik në vitin 2020 është parashikuar që i ashtuquajturin prokurimi i rezervuar, apo institucionet kanë mundësi që me blerjet e caktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kompanitë që punësojnë më shumë se 30 për qind të qytetarëve nga kategoritë e prekshme", shtoi Tevdovski.

Sipas tij, në dy viret e ardhshme, nevojitet dukshëm të përmirësohet sistemi i kontrollit.

Në këtë drejtim, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjatë këtij viti ka krijuar një kornizë ligjore për kompanitë sociale, me qëllim që të nxitet funksionimi i kësaj pjese të rëndësishme dhe të shpejtë të ekonomisë në të gjithë Bashkimin Evropian. Si shembull pozitiv është theksuar ngritja e vetëdijes për grumbullimin e mbeturinave dhe përkrahjes së ideve të reja në biznes.

Nga ana tjetër, në Evropë, ekzistojnë 2 milionë ndërmarrje sociale, që përfaqësojnë 10 për qind të të gjitha bizneseve në Bashkimin Evropian. Në fakt, më shumë se 11 milionë njerëz (ose 6 për qind e të gjithë punëtorëve të BE-së) punojnë në ndërmarrjet e ekonomisë sociale. Ndërmarrjet sociale konsiderohen si modele të mundshme efektive për adresimin e çështjeve të rëndësishme sociale që ndikojnë drejtpërdrejt në grupet e marginalizuara. Prandaj, ekonomia sociale dhe ndërmarrjet sociale kanë një rol dhe ndikim të rëndësishëm si furnizues në çdo treg.

Sugareski i kërkon BE-së mbi 5 milionë euro

Shkup, 10 dhjetor - Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, ka kërkuar përkrahje nga Bashkimi Evropian për financimin e projekteve nga infrastruktura gjatë pjesëmarrjes në Këshillin e dytë ministror të BE-së për Ballkanin Perëndimor që mbahet në Bruksel në kuadër të Marrëveshjes për formimin e Komunitetit të transportit. Për mbështetjen e BE-së ndaj projekteve infrastrukturore Sugareski në Bruksel ka realizuar takime edhe me komisioneren evropiane për transport, Violeta Bulc, njoftoi dje Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Projektet nga Korridoret pan-evropiane 8 dhe 10, ka bërë të ditur ministri i transportit, do të përmirësojnë lidhjen me vendet e rajonit dhe Bashkimin Evropian, ndërsa janë në drejtim të ngritjes të standardeve evropiane deri në vitin 2030. "Qeveria e Maqedonisë, përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dorëzoi aplikacion për grant investues në shumë prej 5.136.000 euro për ndërtimin e një stacioni të përbashkët me Republikën e Serbisë. Në përputhje me planin për furnizime, para-



shihet që punët ndërtimore të fillojnë deri në mesin e vitit 2020", ka potencuar ministri Sugareski. Marrëveshja për formimin e komunitetit të transportit, siç ka theksuar ministri është në përputhje me procesin e filluar të integritetit të Maqedonisë dhe aspiratat tona për anëtarësim në BE. "Besoj se kjo Marrëveshje do të sjellë cilësi të re dhe do të bëjë përshejtimin e reformave sektoriale, ndërsa në afat të gjatë, do të kontribuojë për efikasitet më të mirë, shpenzime më të ulëta dhe cilësi më të mirë të shërbimeve transportuese si për konsumatorët, ashtu edhe për kompanitë në sektor", ka thënë Sugareski, i cili ka prezantuar edhe projektet e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në drejtim të rritjes së sigurisë në transport.

KRONIKË

30 ditë në paraburgim për shkupjanin me mitraloz

Një shkupjan njëzet vjeçar tek i cili është gjetur mitraloz, ka marrë paraburgim 30 ditor. Masa i është caktuar pas kërkesës së Prokurorit publik për shkak të rrezikut nga arratisja. Gjatë bastisjes në shtëpinë e shkupjanit është gjetur mitraloz "Degtyarev Type 56 RPD" me kalibër 7,62x39 mm të prodhimit kinez. "Bëhet fjalë për armë dedikuar për municion, apo armë të cilët qytetarëve u është ndaluar, ndërsa analiza e kryer ka treguar se funksionon normalisht", kanë thënë nga Prokuroria Themelore Publike e Maqedonisë.

Gruaja denoncon burrin për dhunë familjare

Një 31-vjeçare, banore e një fshati të Gostivarit, të dielën rreth orës 13 e 30 minuta ka denoncuar se një ditë më herët, rreth orës 20 e 30 minuta, në shtëpinë e tyre është kryer dhunë familjare, të cilën e ka kryer bashkëshorti i sajë 43-vjeçar, i cili një kohë të gjatë e ka keqtrajtuar psikikisht dhe fizikisht. Bashkëshorti i denoncuar është privuar nga liria dhe mbajtur në Stacionin policor Gostivar për zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohen dy persona me marihuanë

Në rrugën regjionale Gostivar-Sushicë, në afërsi të një objekti hotelierik, mbrëmë rreth orës 20 e 40 minuta, janë privuar nga liria 26 vjeçari A.M. nga fshati Balindoll dhe 25 vjeçari B.R. nga Gostivari. Gjatë privimit nga liria, tek ata është gjetur marihuanë. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Aksident në Çellopek, tre të lënduar

Të dielën mbrëma, dhjetë minuta pas mesnate, në udhëkryqin mes rrugës regjionale Radiovcë-Bërvenicë, dhe rrugës lokale për në fshatin Çellopek të Tetovës, vetura e tipit "Golf" me targa të Tetovës, të cilën e ka drejtuar 28 vjeçari G.Z nga fshati Neproshten ka humbur kontrollin dhe ka dalur nga rruga, ku është përplasur me një shtyllë elektrike prej druri. Me këtë rast bashkudhëtarët në veturë D.D. 24-vjeçar nga fshati Leshkë dhe M.B. 27-vjeçar nga fshati Saraqinë, kanë marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa vozitësi G.Z. ka marrë lëndime të lehta trupore. Pas dhënies së ndihmës mjekësore në Spitalin Klinik të Tetovës, janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes dhe punohet në përcaktimin e shkakut të aksidentit dhe detajet tjera në veçanti.

Aksident në Gostivar, katër të lënduar

Në rrugën magjistrale Gostivar-Kërçovë, në afërsi të gurthyesve të dielën rreth orës 17 e 50 minuta, ka ndodhur aksident trafiku në të cilën kanë marrë pjesë dy vetura, edhe atë vetura e tipit "Opel" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 27 vjeçari H.S. nga Tetova dhe vetura "Kia Sportage" me targa të Shkupit, të cilën e ka drejtuar 54 vjeçari S.P. nga Shkupi. Në këtë aksident, dy vozitësit dhe dy bashkudhëtarët të veturave, B.P. 49 vjeçar nga Shkupi, dhe B.S. 57 vjeçar nga Tetova, kanë marrë lëndime të rënda trupore dhe pas marrjes së ndihmës së parë mjekësore, në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murad" në Gostivar, janë dërguar në Klinikat e Shkupit. Hetimet në vendin e ngjarjes, i ka kryer ekipi nga Stacioni i Gostivarit. (U.H)

KËSHILLA NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

USHQIM CILËSOR PËR T'U MBROJTUR NGA NDOTJA


Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 10 dhjetor - Qytetarët e Maqedonisë vazhdojnë të jetojnë akoma në zona ku ndotja e ajrit është një kërcënim për shëndetin. Ndotja e ajrit jo vetëm që mund të shkaktojë sëmundjen kronike pulmonare e të përkeqësorë astmën, por edhe të vrasë njerëz, thonë mjekët.

Organizatave që luftojnë ndotjen e ajrit thonë se duhet të bëhet ndryshim duke mbështetur ligjet për ajrin e pastër dhe duke kundërshtuar përpjekjet që dëmtojnë këto rregullore. Në aspektin individual, rekomandohet që të shmangët ngrohja me dru apo të plehrave, dhe në ambiente të hapura dhe të mbyllura. Njerëzit, veçmas ata me sëmundje kronike dhe astmë, duhet të mbrohen e të marrin masa për mos keqësimin të gjendjes shëndetësore. Nga institucionet përgjegjëse thonë se të gjitha organet e shtetit kanë për qëllim zbatimin e masave që do të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit. Ministria e Shëndetësisë këshillon të kufizohet lëvizja dhe aktivitetet në hapësirë të hapur, sidomos për kategorinë më të rrezikuar si fëmijët, të moshuarit dhe të sëmurët kronik, dhe për njerëzit që punojnë në ambient jashtë.

"Ushqimi duhet të jetë i pasur me vitamina dhe antioksidantë, ndërsa pacientët kronikë rregullisht të marrin terapinë e përshkruar nga mjeku i tyre", thonë nga Mini-

Ministria e Shëndetësisë këshillon të kufizohet lëvizja dhe aktivitetet në hapësirë të hapur, sidomos për kategorinë më të rrezikuar si fëmijët, të moshuarit dhe të sëmurët kronik, dhe për njerëzit që punojnë në ambient jashtë



stria e Shëndetësisë. Dragan Gjorgjev nga Instituti i Shëndetit Publik thotë se rekomandimet dhe këshillat e autoriteteve shëndetësore duhet të respektohen. Ai ndër të tjera shton se është shumë e

rëndësishme për të gjithë qytetarët që të përmirësojnë imunitetin e tyre.

"Efektet në shëndetësi do të thotë para së gjithash mbrojtjen e sistemit respirator, pra mbrojtje të

mushkërive, astmës në cilën do moshë, ata duhet të jenë vazhdimisht nën vëzhgim për keqësimet e shpeshta në këto kushte pa ajër të pastër. Dhe sigurisht, ata duhen të shmangen nga tubimet masive, ku

në kushte të ndotjes së ajrit, koncentracionet e helmeve janë të larta. Kjo është edhe një nga rekomandimet në këtë periudhë", tha Gjorgjev. Doktor Sedat Limani thotë se duhet të gjithë të marrin masa, prej Qeverisë e deri tek qytetarët.

"Duhet të mbjellim pemë në mënyrë që t'i ndihmohet gjelbërimit të ambientit, kujdes në përdorimin e qymyrit dhe drurit në amvisëri. Të gjithë ndotësit e ajrit ndikojnë në shëndetin e njeriut. Përpos masave mbrojtëse, që duhet ti ndërmerr pacientit, siç janë qëndrimi në ambient të pastër, si dhe shmangia e ambientit të jashtëm, përdorimi i higjienës, duhet edhe ushqim cilësor, me vitamina. Vitaminat A, C dhe E janë antioksidantë të fuqishëm dhe për fat të mirë, gjenden me shumicë në fruta të ndryshme. Një ushqim cilësor e bën më të përballueshëm shëndetin e pacientit ndaj viruseve dhe ndikimit të ajrit të ndotur. Nuk duhet përjashtuar që në raste konkrete, pacientit të merr rekomandimin e mjekut për përdorimin e barnave, veçmas antibiotikëve", tha për KOHA, doktor Limani.

Ndryshe, nëpërmjet sistemit "Termini im", autoritetet shëndetësore tashmë kanë të dhëna të mjaftueshme për numrin e kategorive të rrezikuara të qytetarëve. Ndërsa nga ministria shtojnë se është në procedurë një plan se si dhe kujt do ti ndahen 50 mijë maska mbrojtëse.

SHKUPI DHE SARAJEVA KRYESOJNË ME NDOTJEN

Ditën e enjte, Shkupi u rendit i treti si qyteti më i ndotur në botë, ndërsa Sarajeva ishte i pesti, sipas monitorimit të AirVisual. Prishtina, kryeqyteti i Kosovës i cili mbështetet në dy centrale me qymyr për më shumë se 95 për qind të energjisë elektrike, nuk ishte shumë prapa në renditje. Çdo vit, Shkupi dhe Sarajeva mbulohen nga një mjegull e dendur gri. Sipas një raporti të OKB-së gjatë muajit tetor, bëhet e ditur se emetimet e karburanteve fosile duhet të reduktohen në 12 vitet e ardhshme për të kufizuar rritjen e temperaturës globale. Por qeveritë e Ballkanit po pengojnë disi Evropën duke rritur investimet e qymyrit, në mënyrë që të ndërtojnë centrale të reja në të gjithë rajonin. Pesë

qytetet ballkanike me qymyr janë ndër qytetet më të rrezikuara e më të ndotura të Evropës, sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) të vitit 2017. Ato përfshijnë Tuzla (Bosnje), Pljevlja (Mali i Zi), Shkup, Tetovë dhe Manastir (Maqedoni). Shpenzimet ekonomike janë të larta në një rajon të varfër, me pak të holla shtesë për të kursyer. Sipas një studimi të OBSH, ndotja i kushtonte vendeve të Ballkanit Perëndimor më shumë se 55 miliardë dollarë në vitin 2010. Ai shkaktoi edhe më shumë se 36.000 vdekje të parakohshme gjatë këtij viti në të gjithë rajonin. Që atëherë, nuk ka pasur përpjekje të mëdha për të frenuar ndotjen.

KONFERENCË DONATORËSH

NDIHMË NGA JASHTË KUNDËR NDOTJES SË AJRIT

Shkup, 10 dhjetor - Qeveria kërkon ndihmë financiare dhe teknike nga donatorët ndërkombëtar në luftën kundër ndotjes së ajrit dhe zbatimin e planit dyvjeçar kombëtar me të cilin pritet ulja e nivelit të ndotjes së ajrit për 50 për qind. Mjetet kombëtare të cilat janë siguruar nga buxheti, siç ishte theksuar në konferencën e djeshme të donatorëve organizuar në Qeveri, nuk mjaftojnë për zbatimin e planit për luftën kundër ndotjes së ajrit, ndërsa nevojitet edhe ndihmë teknike dhe shkëmbim i përvojave pozitive nga vendet evropiane në trajtimin e këtij problemi global.

Nga Qeveria paralajmërojnë ndihmë në ndërrimin e sistemeve të vjetra jo-ekologjike me sisteme të reja ekologjike të institucioneve publike dhe në amvisëri, subvencione për blerjen e automjeteve ekologjike dhe për instalimin e pajisjeve të gazit, ndërsa shpresojnë se do të silltet edhe ligji me të cilin do të ndalohej që qymyri të



përdoret si mjet për ngrohje. "Qytetarët nuk duan të ndotin ajrin, por ne duhet t'u ndihmojmë dhe atë do ta bëjmë me subvencione për burime ekologjike, me ngritjen e efikasitetit energjetik të objektit dhe shpresoj se do të marrim mbështetje konsensuale në Kuvend për të kaluar ligji për përdorimin e qymyrit si mjet për ngrohje. Ajo do të jetë një masë e dobishme

e cila nuk duhet të përdoret nga aspekti social, por nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor si një nga komponentët kryesor", tha zëvendësministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Jani Makraduli para fillimit të konferencës.

Sipas tij, zëvendësimi i sistemeve të vjetra dhe jo-ekologjike për ngrohje me të reja do të jepte

rezultat më të shpejtë mbi ndotjen e ajrit, sepse, siç theksoi ai, katër studime të ndryshme kanë dëshmuar se rreth 46 për qind në ndotjen e ajrit marrin pjesë amvisëritë të cilat nuk ngrohen vetëm me dru dhe qymyr, por përdorin edhe plastik dhe goma. "Kjo nuk është vetëm çështje ekologjike, por edhe ekonomike. Për shembull, një kopsht për fëmijë në komunën Qendër i cili ngrohet me naftë dhe për një vit shpenzon 18 mijë euro, nëse ngrohjen e zëvendëson me inventore atëherë fatura do zvogëlohet në 3,5 mijë euro, qartëson Makraduli, duke shtuar se në luftën kundër ndotjes së ajrit nevojitet kyçja e të gjitha palëve të interesuara në vend duke nisur nga institucionet deri tek sektori joqeveritar dhe qytetarët. Ai shpreson se nëse vazhdohet me zëvendësimin e burimeve jo-ekologjike, pastrimin e deponive, mbjelljen e fidaneve, inspektime të përforuara dhe sekuestrimin e mjeteve jo-

ekologjike, rezultati do të shihet.

Ndërsa, sipas zëvendëskryeministrit për Çështje Evropiane Bujar Osmani, i cili është edhe koordinatori kombëtar i ndihmës së huaj, thotë se, ndotja e ajrit nuk mund të zgjidhet me shkop magjik dhe me "ad-hok" zgjidhje, por nevojiten strategji afatshkurta dhe afatgjata me një seri masash dhe aktivitete për tejkalim të plotë të këtij problemi.

"Dhe tani kemi aktivitetet të ndara të donatorëve nëpërmjet projekteve të ndryshme, por me rëndësi që është ato të jenë të kompletuara dhe në përputhje me strategjinë tonë", tha Osmani, duke shtuar se ka pjesëmarrje pozitive nga ana e komunitetit ndërkombëtar, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe organizatave. Pothuajse të gjithë raportet tregojnë se gjatë periudhës së kaluar Shkupi, Tetova dhe Manastiri janë ndër vendet më të ndotura në Evropë. (D.K)

Sipas Ligjit për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18) dhe Vendimi nr. 02-335/1 të datës 28.11.2018 për dhënie me qira të hapësirës afariste, e cila përfaqëson pjesë nga hapësira në objektet e INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir, publikon:

SHPALLJE numër 01/2018

për dhënie me qira të hapësirës afariste (për herë të parë) - përmes ankandit publik elektronik

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lënda e ankandit publik elektronik është hapësira afariste dhe nyje sanitare (tualet i femrave dhe i meshkujve) në INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir në pajtim me pasqyrën tabelore në të cilën janë të parashtruara të dhënat për hapësirën afariste dhe nyjën sanitare.

Numri rendor	Parcela katastrale, Komuna katastrale, Fletë pronësia	Komuna, Adresa, Ndërtesa, Hyrja dhe Kati	Sipërfaqja m ²	Vlera totale e hapësirës afariste(në den.)	Çmimi fillestar i qirasë mujore në denarë (pa TVSH)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës 2%	Afati i parashtrimit të fletëparaqitjeve	Koha e fillimit të ankandit publik
	PK 12899/1 KK Manastir 3 LP 32680	Manastir, Pece Matiçevski 39, Ndërtesa 2, Hyrja 1, Kati 1 (hapësirë afariste) dhe	65 m ²	2.387.922,00den.				
	PK 12899/1 KK Manastir 3 LP 32680	Manastir, Pece Matiçevski 39, Ndërtesa 1, Hyrja 1, Kati 1 (nyje sanitare)	23,70 m ²	625.086,00den.				
TOTAL			88,70m ²	3.013.008,00den.	16.000,00den	60.260,00ден	10 ditë	00.00.00 00.00 ora.

Lënda e ankandit publik elektronik i theksuar në Pasqyrën nr. 1 në Manastir jepet me qira në për periudhë prej 2 (dy) vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për qira me ofertuesin më të volitshëm. Lënda e ankandit publik elektronik jepet për çështje administrative, llogaritje ose zyrë ligjore, qendër edukative, qendër për gjuhë të huaja etj. Lënda e ankandit publik elektronik jepet në gjendjen e parë.

Qiraja në marrëveshjen për qira do të theksohet në shumën-neto pa TVSH. Tatimi për vlerën e dhënë theksohet veçmas në faturën.

Qiramarrësi është i detyruar qiranë ta paguaj paraprakisht, më së voni në ditën e 5-të të muajit, pavarësisht nga marrja e faturës. Për pagesën e qirasë së vonuar llogaritet kamata ligjore si dënim.

Çmimi i cili do të arrin në ankandin publik do të përcaktohen si çmimi mujor i qirasë dhe i njëjti duhet të paguhet paraprakisht. Për periudhën e mbetur për pagesën e qirasë do të përcaktohet në marrëveshjen.

TË DREJTË NË PJESËMARRJE

Të drejtë në pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë subjektet të interesuar fizik dhe juridik vendas dhe të huaj të cilët mund të kenë me qira ndërtesë afariste ose hapësirë afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilët i përmbushin kushtet e dhëna në Shpalljen nën kushte të përcaktuara me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18).

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

- Personat e interesuar parashtrorin Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik në pajtim me kushtet e shpalljes në mënyrë elektronike dhe duhet ti përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë të cilat janë të përcaktuara në këtë shpallje;
- Fletëparaqitja për pjesëmarrje duhet të përmbajë numrin rendor, qytetin dhe adresën nga Pasqyra nr.1 për hapësirën për të cilën parashtrorin fletëparaqitja dhe duhet të jetë e nënshkruar dhe vërtetuar nga personi përgjegjës i subjektit juridik / nënshkruar nga subjekti fizik;
- Garancia bankare për seriozitet të ofertës duhet të parashtrorin më së voni deri në datën dhe orën përfundimtare për parashtrim të fletëparaqitjeve (të theksohet numri rendor nga Pasqyra nr.1, qyteti dhe adresa ku ndodhet objekti afarist);
- Për subjektet juridik dëshmi për regjistrim të subjektit juridik të lëshuar nga regjistri adekuat (nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj të parashtrorin dokument adekuat në të cilin ofertuesi është i regjistruar, lëshuar nga organi kompetent me përkthim në gjuhën maqedonase);
- Gjendja aktuale lëshuar nga Regjistri qendror i R. së Maqedonisë, jo më e vjetër se 6 muaj (për subjekte juridik);
- Vërtetim që nuk ka të hapur procedurë për falimentim ose likuidim, jo më të vjetër se 6 muaj (për subjekte juridik);
- Për subjekt fizik certifikatë të shtetësisë, jo më të vjetër se 6 muaj (për subjekte fizik të huaj - dëshmi për identitet);
- E-mail adresa e parashtruesit së fletëparaqitjes përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje, gjegjësisht do të dërgohen emri i shfrytëzuesit dhe shifra për qasje në internet-faqen në të cilën do të realizohet ankandit publik elektronik;
- Të gjitha këto dokumente së bashku me fletëparaqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik duhet të bashkëngjiten në formë elektronike në ueb faqen: www.deloven-prostor.mk ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës të parashtrorin edhe në formë elektronike në ueb-faqen www.deloven-prostor.mk dhe në formë letre (origjinal) në INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir.

GARANCIA BANKARE

Shuma e garancisë bankare për seriozitet të ofertës është e përcaktuar në Pasqyrën nr. 1 në këtë Shpallje për hapësirë afariste. Afati i vlefshmërisë së garancisë bankare për seriozitet të ofertës është 60 ditë duke filluar nga dita e ankandit publik.

Garancia bankare për seriozitet të ofertës do të kthehet në tërësi parashtruesit së fletëparaqitjes për ankand publik në afat prej 15 ditë nga mbajtja e ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm do të kthehet në afat prej 15 ditë nga dita e pagesës së një qiraje mujore të arritur në ankandin publik.

Detyrë e ofertuesit më të volitshëm është që ti paguajë mjetet në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje, në të kundërtën nuk do të mund të lidhë marrëveshje, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do të shquhet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat e ankandit publik për dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej 1 viti nga dita e shquarjes së ndalesës. Marrëveshja për qira lidhet në afat prej 10 ditë nga pagesa e mjeteve, ndërsa në afat prej 30 ditë parashtrorin në noter për kryerje të solemnizimit. Shpenzimet e solemnizimit të marrëveshjes janë në barrë të ofertuesit.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje të ankandit publik elektronik mund të parashtrorin më së voni deri 20.12.2018. Ankandit publik do të mbahet në internet faqen www.deloven-prostor.mk e Ministrisë së transportit dhe lidhjeve.

Ankandit publik fillon në internet faqen me publikimin e çmimit fillestar të qirasë mujore në denarë dhe realizohet përmes ankandit nga ana e pjesëmarrësve në ditën dhe kohën ashtu siç është publikuar në pasqyrën tabelore.

PROCEDURA

1. Komisioni për realizim të procedurave për ankand publik për dhënie me qira të pronave të patundshme të INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir (në tekstin e mëtuftës: Komisioni) pas pranimit të fletëparaqitjeve, pa prezencën e ofertuesve, përcakton a janë të parashtrorin brenda afatit të përcaktuar dhe a janë të kompletuara sipas kushteve në Shpallje.

2. Brenda periudhës nga përfundimi i shpalljes e deri tek fillimi i ankandit, Komisioni i kontrollon fletëparaqitjet e dorëzuara dhe dokumentet e bashkangjitura dhe i miraton ose refuzon shfrytëzuesit e paraqitur për pjesëmarrje në ankand.

3. Shfrytëzuesit marrin njoftim në e-mail adresën e tyre për vendimin e Komisionit, ndërsa pastaj statusin e fletëparaqitjes së tyre mund ta shohin në panelin e Ankandit në ueb faqen www.deloven-prostor.mk.

4. Ankandit publik do të mbahet edhe nëse pas shpalljes është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili i plotëson kushtet e theksuara në shpallje dhe e jep çmimin fillestar.

5. Ankandit elektronik publik fillon me shpalljen e çmimit fillestar për qiranë mujore të hapësirës afariste dhe zbatohet nëpërmjet mënyrës së ankandit nga ana e pjesëmarrësve

6. Në pesë minutat e para nga ankandit publik, pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht ta rritin çmimin e hapësirës afariste. Ankandit publik llogaritet i përfunduar në momentin e skadimit të kohës së caktuar në shpalljen, gjatë së cilës nëse me kalimin e dy minutave të fundit nga koha e përcaktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ndonjë ofertë, afati i fundit për përfundim të ankandit publik shtyhet për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë të dy minutave të fundit nuk do të ketë ofertë të re.

7. Ankandit publik vazhdon pa kufi deri sa në intervalin prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik oferta nuk është pranuar, gjegjësisht nuk është dhënë çmim më i lartë, çmimi fillestar i hapësirës afariste zvogëlohet për 2% ku pjesëmarrësit përsëri do të kenë mundësi ta pranojnë, gjegjësisht ta rritin çmimin e hapësirës afariste.

8. Nëse pas përfundimit të dy minutave të fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, gjegjësisht është dhënë çmim më i lartë, afati i fundit për përfundim të ankandit shtyhet për dy minuta, ndërsa do të mbaron kur në periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk do të ketë ofertë të re.

9. Nëse në kohëzgjatjen prej pesë minuta përsëri nuk do të ketë ofertë, vlera e hapësirës afariste përsëri zvogëlohet për 2% nga vlera fillestare e hapësirës afariste. Zvogëlimi i çmimit fillestar gjatë ankandit, përderisa bëhet fjalë për shpallje për herë të parë mund të jetë më së shumti 30% nga vlera e përcaktuar e tregut së hapësirës afariste, gjegjësisht vlera totale e përcaktuar për qiranë mujore të hapësirës afariste pa marrë parasysh se sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik.

10. Pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ka ofruar çmimin më të lartë për qira e merr statusin si ofertuesi më i volitshëm.

11. Pas përfundimit të ankandit publik komisioni përgatit procesverbal për ankandin publik të realizuar dhe e parashtrorin në mënyrë elektronike deri tek të gjithë pjesëmarrësit e ankandit publik.

12. Pjesëmarrësit e ankandit publik kanë të drejtë në ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej 3 (tre) ditë nga mbajtja e ankandit publik. Ankesa parashtrorin deri tek Komisioni në formë elektronike në e-mail adresën: nuub@nuub.mk

13. Komisioni vendos për ankesën me vendim. Kundër vendimit të komisionit, pala e pakënaqur mund të parashtrorin ankandit deri tek Komisioni shtetëror për vendosje në procedurën administrative dhe procedurën për marrëdhënie të punës nga shkalla e dytë.

MËNYRA E SHPALLJES

Dhënia me qira të hapësirës afariste bëhet me ankand publik elektronik në ueb-faqen www.deloven-prostor.mk dhe me publikim në dy gazetata ditore të cilat botohen në gjuhë maqedonase dhe një në gazetë ditore e cila botohet në gjuhën të cilët e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshëm nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetet të Manastirit në rajonin e të cilit ndodhet hapësira afariste si lëndë e shpalljes. Ofertuesit e interesuar, hapësirën afaristë e cila jepet me qira mund ta shohin çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 12:00 në INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir.

INBU "Shën Kliment Ohridski" - Manastir

Komisioni për realizim të procedurave për ankand publik për dhënie me qira të patundshme.

VAZHDOJNË PREMTIMET E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

S'KA PAGA, ZHGËNJEHEN STOMATOLOGËT SPECIALISTË



Deri në 2020, asnjë fëmijë në institucionet sociale

Shkup, 10 dhjetor - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale informon se deri në fund të vitit 2018, në institucionet sociale në vend do të vendosen për 60 për qind më pakë fëmijë se sa në gusht të vitit 2017.

"Në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, njofton se plani ambicioz - asnjë fëmijë nën moshën 18 vjeçare të mos mbetet në institucionet sociale deri në vitin 2020, hap pas hapi po bëhet realitet. Në fund të vitit 2018 në institucionet tona

sociale do të vendosen për 60 për qind më pakë fëmijë se në gusht të vitit 2017", thuhet në kumtesën e MPPS. Nga intensifikimi i sërishëm i deinstucionalizimit në gusht të vitit 2017, gjithsej 161 fëmijë të vendosur paraprakisht në institucionet sociale gjenden nën përkujdesje jashtë institucioneve. Në Institucion e posaçëm në Demir Kapi tashmë nuk ka asnjë fëmijë nën 18 vjeç, ndërsa fëmijët e vendosur në Institucionin për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukativo-sociale "25 Maji" janë përkujdesur në pesë shtëpi të vogla grupore në Shkup.

Deri në fund të gjysmë vjetorit të parë shkollor të gjithë 30 fëmijët të cilët aktualisht janë të vendosur në Shtëpinë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror "11 Tetori", gjithashtu, përgjithmonë e braktisin institucionin dhe do të jetojnë në shtëpi të vogla grupore në Shkup dhe në Shtip apo në familje përkujdesje në Shkup. Ministria Mila Carovska thekson se çdo fëmijë meriton familje dhe se me këtë ndryshohet mënyra me të cilën shteti kujdeset për fëmijët të cilët kanë nevojë për kujdes afatgjatë social. Gjithashtu, MPPS u shpreh falënderim UNICEF-it, BE-së dhe UNDP-së mbështetja e të cilëve është ndihmë e madhe dhe shumë e rëndësishme për procesin e deinstucionalizimit.



Nga Ministria e Shëndetësisë thonë për gazetën KOHA se janë paraparë fonde për stomatologët specialistë, por se po presin miratimin e Ministrisë së Financave

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 10 dhjetor - Stomatologët specialistë ende nuk kanë marrë pagat e premtuara nga ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili kohë më parë theksoi se do të marrin kompensim specialistët për punën e tyre. Ndërkaq, premtoi se nuk do të lejojë më që mjekët e rinj, gjatë specializimit të punojnë pa pagesë.

Vendimi i të parit të Shëndetësisë erdhi pas tubimit të specialistëve përpara Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët kërkuan që zgjidhjet e ofruara nga ministri të precizohen. Ata kërkuan nga ministri ta përshpejtojë këtë proces dhe ta rumbullakojë çështjen e pagesave tyre. Madje, atëkohë ministri tha se përmirësimi i pagave të specialistëve bëhet me qëllim ndalimin e ikjes së mjekëve drejt Europës. Megjithatë, deri më sot, asgjë pozitive nuk ka lëvizur në drejtim të pagave.

Specialistët në stomatologji, në shtator, dolën në një protestë paqësore jashtë Ministrisë së Shëndetësisë. Ata kërkuan kompensim financiar për punën e tyre.

Protesta paqësore erdhi pas tetë muaj bisedimesh, ndërsa u premtua se pagesa do të fillojë pikërisht në muajin shtator. Pas protestave të studentëve ministri Filipçe deklaroi se paratë do të ofrohen dhe ata do të fillojnë marrjen e kompensimit financiar nga tetori. Ndërsa, specialistët kërkuan një garanci për këtë, si një masë e dentistëve të rinj për ti mbajtur në vend dhe të mos emigrojnë në masë të madhe, jashtë vendit.

Tani, stomatologët ankohen se të gjitha bisedimet me Ministrinë e Shëndetësisë u degraduan, ndërsa vazhdon injorimi i specialistëve. "Për ne, mjekët, të cilët jemi në specializim privat, secila ditë e kaluar me status të këtitillë të padefinuar është frustrim. Përsëris, paga patjetër të ketë për të gjithë, edhe atë në të njëjtën kohë, sepse pavarësisht se jemi mjekë të rinj, ne kryejmë punë nëpër Klinikë", tha Elmedina Asani, specializante në neurokirurgji. Premtimi se pagat do të fillojnë të merren që në shtator, lëre që nuk është marrë, por kjo nuk ka ndodhë as për muajin tetor dhe nëntor.

Nga Ministria e Shëndetësisë

thonë për gazetën KOHA se janë paraparë fonde për stomatologët specialistë, por se po presin miratimin e Ministrisë së Financave. "Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ka siguruar një buxhet për pagesën e specialistëve të stomatologjisë dhe fondet janë transferuar në Klinikën e Stomatologjisë. Ministria e Shëndetësisë ka dhënë pëlqimin për punësime me kontrata pune përmes së cilës do të paguhen pjesëmarrësit privatë dhe do t'i dërgohet përmes Fondit për Sigurim Shëndetësor, Ministrisë së Financave. Aktualisht po presim miratimin në Ministrinë e Financave", thanë nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këtu shtojnë se specialistët dentarë privatë janë përfshirë në Buxhetin për vitin 2019, ndërsa do të paguhen vitin e ardhshëm.

Specialistët nga ana tjetër thonë se ata vazhdimisht i kërkojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave të miratojnë fondet, por ankohen se kalojnë vazhdimisht topin nga njëri - tjetri. "Në Ministrinë e Shëndetësisë na thanë se dokumentet iu dërguan Ministrisë së Financave

dhe se puna do të përfundojnë shpejt, në mënyrë që të nënshkruajmë kontratat. Pas thirrjes së fundit në Ministrinë e Financave, të cilët e dinin se kush ishin në radhë, na thanë se nuk morën asnjë dokument nga Ministria e Shëndetësisë", thonë specialistët e stomatologjisë. Ankohet se rregullisht i përmbushin detyrimet e tyre të punës, ndërsa ende nuk kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje.

"Kanë kaluar tre muaj dhe ende nuk kemi nënshkruar marrëveshje, as kemi marrë rrogën e parë të pritur në fillim të muajit shtator dhe sot është tashmë dhjetori. Për një periudhë të caktuar po përpiqemi të zbulojmë nëse dhe ku ka pengesë për pagesën tonë dhe përgjigjet që marrim janë të paqarta dhe të pakënaqshme për ne. Mendojmë se nuk jemi subjekt manipulimi, por përkundrazi, duhet të vlerësojmë sipas kontributit tonë. Ne presim me përpjekjet tona për të marrë një zgjidhje pozitive në të ardhmen e afërt, sepse fundi i vitit kalendarik po afrohet dhe kemi frikë se mund të zhgënjehemi", tha një specialist i stomatologjisë.

Benzina lirohet për 1.5, diseli për 2.5 denarë


Shkup, 10 dhjetor - Çmimet me pakicë të benzinës prej sonte në mesnatë ulen për 1.50, ndërsa karburanteve disel për 2.50 denarë për litër, vendosi sot Komisioni

Rregullator për Energjetikë. Çmimi i ri i eurosUPER BS-95 është 61.50 den/l, ndërsa eurosUPER BS-98 arin 63.50 den/l. Një litër eurodisel (D-EV), megjithatë do të shitet për

58.50, ndërsa vaji ekstra i lehtë për amvisëri (EL-1) për 47.000 denarë. Lirohet edhe mazuti M-1 NS për 1.789 denarë dhe një kilogramë do të kushtojë 30.037 denarë.



Kriza e Makronit, një rrezik për mbarë Evropën



Nga
Natalie NOUGAYRÈDE

Për hir të Evropës, Emanuel Makron ka nevojë për ndihmën, dhe jo neverinë apo urrejtjen tonë. Një president i ri, reformist në Francë, që premtoi një "rilindje evropiane", e sheh tanimë veten duke u përpëlitur në krye të një vendi, që po bëhet sërish dhe me shpejtësi "e sëmura e Evropës".

Momenti me domethënës i protestave, ishte kur protestuesit shpërftuuan fytyrën e përmendores së Marianës, simbolit të republikës në Harkun e Triumfit në Paris. Vetëm 3 javë më parë, udhëheqësit botërorë u mblodhën atje me Makronin, për 100-vjetorin e fundit të Luftës së Parë Botërore. Nga "pasionet e trishta" të francezëve, për të cilat Makron kishte paralajmëruar shumë herë, do të preket një kontinent i tërë, dhe jo vetëm karriera politike e një njeriu. Forcat ekstremiste në mbarë Evropën, janë shprehur të entuziamuara gjatë përplasjes së Makron me "Jelekët e Verdhë". Nga mbështetësit e Brexit (majtas dhe djathtas), tek e djathta ekstreme italiane e Mateo Salvini, për të mos përmendur propagandën e Putinin, shija është e pagabueshme. Rebelimi dhe kaosi po lulëzojnë në demokracitë liberale. Çmimi që mëtojnë ekstremistët, është fitimi i zgjedhjeve për në Parlamentin Evropian majin e vitit që vjen.

Ngjarjet në Francë janë ogurzeza, dhe rëndësia e tyre shtrihet shumë më tepër se sa kufijtë e një vendi. Jo shumë kohë më parë, Makron e quajti me krenari veten armikun e Salvinit dhe Viktor Orbanit të Hungarisë, dy liderë që përmes politikave të pazareve, synojnë të ndalojnë hyrjen e emigrantëve në vendet e tyre, mbyllin gojën kundërshtarëve politikë dhe sabotojnë sundimin e ligjit. Makron është dobësuar, është tërhequr në mbrojtje, dhe është përherë e më i izoluar. Skenat dramatike në Francë 2 javë të fundit mund të duken për disa, si një ringjallje e kryengritjes së majit 1968. Por një paralele më e rëndësishme, mund të jetë 6 shkurti 1934.

Atë ditë, bandat e nacionalistëve ekstremistë marshuan në kryeqytetin francez, dhe u përleshën me policinë, në një trazirë që shkaktoi 15 të vdekur. Ngjarjet e asaj dite, shërbyen si një mit themelues për atë brez të së djathtës në Francë. Sigurisht, Makron ka bërë gabime. Shumica e protestue-



sve kanë ankesa të vërteta, ndonëse të shprehura në mënyrë kaotike. Ata e konsiderojnë veten "njerëzit e padukshëm", që trajtohen me përbuzje nga elitat pariziane, dhe se tani janë bërë shumë të dukshëm me xhaketat e tyre fluoreshente. Opinioni publik është pas tyre. Një nga anëtarët më elokuentë të lë-

vizjes është Ingrid Levavazy, një infermiere e re, nënë e divorcuar me 2 fëmijëve nga Normandia. Javën e kaluar, ajo foli me tone prekëse në televizion, mbi përpjekjet e saj për të arritur qëllimin e protestës, dhe për ndjenjën e saj të thellë të padrejtësisë: "Disa njerëz ankohen se ne i bllokojmë

rrugët, por ata nuk ankohen kur ata bllokohen nga trafiku, apo kur janë duke shkuar me pushime në resortet turistike të skive, apo jo?" -pyeti ajo me butësi. Por kriza e Francës ka nënrymë më të këqija, të mishëruara nga një zëdhënës tjetër i jelekë-verdhëve, Kristof Shelencjon. Një kovaç nga rajoni jugor i Vauk-



Lë Penët, Orbanët dhe Salvinët, po presin në cep të rrugës. Nëse nuk gjejmë dot një zgjidhje, zgjedhjet për në Parlamentin Evropian në Francë, rrezikojnë të shndërrohen në një referendum kundër Makronit. Pra, presidenti francez e ka humbur shkëlqimin e tij, si një kampion i liberalëve dhe pro-evropianëve. Por ta shohësh këtë si një lajm i mirë për Evropën dhe për demokracinë në përgjithësi, është tejet e rrezikshme

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 10 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

luz, Shelençon është një anti-mysliman i hapur, dhe ka bërë thirrje për instalimin e një qeverie të udhëhequr nga ushtria, pasi sipas tij "një komandant i vërtetë, një gjeneral, një dorë e fortë, është ajo që na nevojitet".

Partitë e të djathtës, si Aksioni Francez, po përpiqen të rikuperojnë terren, dhe të rikthehen në skenën kombëtare. Njoftimi më i fundit nga qeveria, se rritja e taksave do të pezullohet, është ndoshta shumë pak, dhe shumë i vonuar. Frikërat e francezëve janë të trefishta. Ekziston frika e humbjes së pushtetit dhe prestigjit; frika e ndikimit ekonomik të globalizimit, dhe frika e humbjes së një "identiteti kombëtar". Vendi vuan ndërkohë nga ndarjet e thella brenda vendit, të cilat vështirë se mund t'i mbyllë një president në vetëm 18 muaj.

Grupime të tëra sociale, ndjehen të neveritur me njëri-tjetrin: të rinjtë kundrejt të moshuarve, të papunët përkundrejt të punësuarve, ruralët kundrejt urbanëve, të pakualifikuarit përkundrejt të mirë-arsimuarve. Ndarje të tilla ekzistojnë në shumë vende, por në Francë ato marrin një dimension ekzistencial, për shkak të idealit të barazisë, historikisht të lidhur me republikën. Shumë francezë, ndjejnë se realiteti nuk pasqyron atë që ata kanë të drejtë të kenë.

Kur Makron garoi për president në vitin 2017, ai premtoi një "revolucion" (ky ishte edhe titulli i librit të tij të fushatës), për të adresuar një nevojë të përhapur për një ripërtëritje të brendshme, dhe një rivendosi të prestigjit francez, jo më pak në skenën evropiane. Tani presidenti duket i paralizuar në shtëpi, dhe andrallat e ij të fundit, mund të mbizotërojnë së shpejti mbi planet e tij për Evropën. Ashtu si një Merkel e dobësuar nuk bëri shumë për të ndihmuar Makron në rifillimin e një projekti mbi Evropën, një Makron i dobësuar tani do të sigurojë "ushqim" të ri për ekstremistët dhe populistët anembanë kontinentit.

Lë Penët, Orbanët dhe Salvinët, po presin në cep të rrugës. Nëse nuk gjejmë dot një zgjidhje, zgjedhjet për në Parlamentin Evropian në Francë, rrezikojnë të shndërrohen në një referendum kundër Makronit.

Pra, presidenti francez e ka humbur shkëlqimin e tij, si një kampion i liberalëve dhe evropianëve. Por ta shohësh këtë si një lajm i mirë për Evropën dhe për demokracinë në përgjithësi, është tejet e rrezikshme. Është një lloj si të dëshirosh përmbyshjen e trenit, në mënyrë që të zëvendësohen disa vagona të tij. Dhimbjet sociale në Francë janë reale, dhe duhet të adresohen. Por forcat që po përfitojnë nga revolta dhe dhuna në rrugë, janë ato që do të na hedhin në humnerë.

Shihni kërcënimet me vdekje ndaj jelekë-verdhëve, që thanë se janë gati të negociojnë me qeverinë. Disa vjet më parë një Itali e lodhur dhe e tensionuar, kishte ditët e saj të protestave të dhunshme (mesazhi ishte: Shkofshi në djall, për establishmetin), nga e cila lëvizja populiste Pesë Yjet u rrit si një forcë politike.

Po çfarë ka ndodhur që atëherë? Këtë vit, Italia ra në kthetrat e të djathtës ekstreme.

Protestat aktuale në Francë, do të çojnë në një skenar të ngjashëm, nëse njerëzit me mendje të kthjellët, nuk e ndihmojnë disi Makronin në rindërtimin e një minimumi të besimit nga opinion publik.

Nuk mund të ketë asnjë projekt evropian demokratik apo drejtësi sociale, pa një Evropë dhe Francë demokratike. Fytyra e Marianës, duhet të restaurohet.

(The Guardian)

Mega-Skandal në Absurdistan



Nga
Shaqir ISLAMI

Natën e së Enjtes, e ndoqa emisionin debativ - masturbues "Të pa Ekspozuarit" të Rakipi & 'pajdashët'. E ndjek herë pas here, në copëra-copëra, për shkak se është bajat. Mënyra dhe lehtësia se si trajtohen temat; se si u qasen çështjeve të rëndësishme publike dhe i zhbëjnë ato me papërgjegjësi, është hepten lozakoqe. Jo vetëm ky emision! S'do mend se, të gjitha mediat janë zhytur thellë në mëshirën e gazda Ramës. Sjellja e tij poshtëruese ndaj tyre flet qartë, për marrëdhënien e interesit të ndërsjellë. Çdo temë trajtohet sipas thënies: "Kaktundi digjet, e plaka i kreh leshrat...! Përfundimi i çdo teme mbaron me reklamën për "Kazanin"; pasi, nga vet aktorët pranohet se 'kjo qeverisje është skandaloze dhe kriminale, por ... "nuk është aq keq sa të gjitha qeverisjet e dikurshme të Sali Berishës" !!! Theksi akoma rëndon mbi të. Kjo anti-reklamë qarkullon në të gjitha mediat nacionale dhe çorienton shoqërinë.

Edhe pse qeveria është skandaloze, tek gazetarët akoma mbizotëron paragykyimi ndaj opozitës. Gazetaria e mjeruar, në këtë mënyrë e shfaqëson veten nga rilindja - skandaloze; dhe fsheh partneritetin e vet me të. Ndonëse, nocioni paragykyim në psikologji përkufizohet si; 'një lloj qëndrimi i ngarkuar me emocione shumë negative'. Dhe shkrep si pushka; pasi, funksionon sipas ligjit të balistikës. Nuk e fsheh dot: qëndrimin, paragykyimin dhe stereotipin. Këta janë lehtësisht të ngacmueshëm nga mjedisi i jashtëm. Dhe prandaj janë të pakontrollueshëm dhe të paparashikueshëm, për shkak se shkrepn nga pjesa e pavetëdijshme e individit. Në këto raste vetëdija vepron tepër vonë; kur çdo gjë merr fund. Pra qëndrimi, paragykyimi dhe stereotipi janë më të shpejtë se plumbi. Nganjëherë, dhe bile-bile



Përmbytja e Tiranës

s'është skandal në

Absurdistan! Ua dhjefsha

mediat ... dhe moralin e

tyre. Asnjë media nuk u

morr me rrëfimin e

paturpshëm dhe kriminel

të Rakipit! News 24,

akoma e mban në atë

shtëpi! As 'pajdashët' e tij

që shtirren si roje të

moralit publik, nuk

bëzajnë! Absurdistani

lëngon nga tirania

semantike

shumë herë, fjala është më e dëmshme se plumbi. Gjithmonë ka qenë kështu. Dhe jo ndryshe! Sidomos, në shkrepjen e tre nocioneve të lartpërmendura tradhton gjuha e trupit. Këtë temë e shpjegojnë psikologët; mbase e kanë zanat.

Rakipi me 'pajdashët' gazetarë, si nuk u shqetësuan njëherë në këtë Ramamaniadë - pesëvjeçare! Kur opozita denoncon: mediat nuk shohin; nuk dëgjojnë; nuk e perceptojnë dukurinë skandal! Sepse, emëruesin e përbashkët e kanë mega-skandal! Si mund të ketë kuptim shprehja skandal në një vend që vet gazetaria e shndërroi në Absurdistan? Absurdistan është i vetmi kuptim, 'për tutat në samitin e NATO-s',

'për komunikimin poshtërues dhe ofendues me qytetarët dhe mediat'; për komunikimin kërcënues me partnerët politik ndërkombëtarë; për fyerjen dhe përbuzjen e shqiptarëve dhe të simboleve të tyre; të gjitha këto gafe të qëllimshme, media i percepton dhe i lavdëron si "stil origjinal i komunikimit politik"! Këto shpjegime janë vetëm pallavra të një gazetarie - idiote dhe injorante.

Shembull i mjerimit të gazetarisë është "të Paekspozuarit", që u shitet konsumatorëve të medias si rojtar i moralit shoqërorë dhe të interesit publik! Ky është prostitucion i gazetarisë. Rama e shpërfytyroi gazetarinë duke e shndërruar në zanatin më të vjetër të njerëzimit. Nejse, tema e fundit e 'kompanisë së "Të pa Ekspozuarve" ishte zbulimi i një "mega - skandali - mashtrimi". Përderisa opozita, denoncon ditë për ditë skandale e qeverisë, mediat e akuzonin atë se është "një opozitë pasive". Të enjten e fundit, Rakipi & 'Kompani' nuk e fshihnin dot orgazëm - hakmarrjen ndaj Ramës. Zbulimin e tyre e quanin 'mega - skandal', ndërsa bëhej fjalë "vetëm për 18 milionë"! Përderisa, skandalet kanë qenë përditshmëria e rilindjes-skandaloze.

Ndërsa, para ca ditësh, Rakipi u rrëfye publikisht, (për një skandal personal), se si i kishte bërë "një shërbim personal të vogël" Ramës si Krye-bashkiak. Dhe, dikush tjetër denoncoi Rakipin se "për shërbimin e vogël, ky qenkësh shpërblyer me një leje për një pallat". Për 'kompaninë e interesit' ky s'është skandal! Përmbytja e Tiranës s'është skandal në Absurdistan! Ua dhjefsha mediat ... dhe moralin e tyre. Asnjë media nuk u marr me rrëfimin e paturpshëm dhe kriminel të Rakipit! News 24, akoma e mban në atë shtëpi! As 'pajdashët' e tij që shtirren si roje të moralit publik, nuk bëzajnë! Absurdistani lëngon nga tirania semantike.





TË PREMTEN NË KUMANOVË U SHFAQQ PREMIERA “AS ANDEJ, AS KËNDEJ”

Në Teatrin e Kumanovës të premten u shfaq premiera e dramës “As andej, as këndej” me regji të Kastriot Abdylit. Dramatizimin e shfaqjes e ka bërë Ilir Ajdini, në bazë të tekstit të autorëve Bojan Trifunovski, Simeon Damevski dhe Lupço Todorovski.

Drama “As andej, as këndej” pasqyron realitetin e ditëve tona, ku shumë persona për shkaqe sociale dhe ekonomike marrin rrugën e migrimit për një jetë më të mirë, për të filluar jetën nga fillimi. Kjo është edhe qëllimi i kryepersonazhit, Ilirit, i cili, edhe pse në mo-



shën 50 vjeçare niset drejt Amerikës, për t'u takuar në aeroportin e

Frankfurtit me Bekimin. Ky i fundit, për dallim nga Iliri, pas 18 vitesh

në migrim vendos të kthehet në Maqedoni, po për ta filluar jetën nga fillimi pas problemeve familjare në Amerikë. Ballafaqimi i Ilirit me Bekimin sjell jo vetëm situata komike, por edhe tensione dramatike...

Rolet në këtë shfaqje i interpretuan aktorët Ismail Kasumi, Musa Isufi, Taulant Destani dhe Faton Ibrahim, bashkë me instrumentistët dhe autorë të muzikës Baba Bend dhe Funda Ali. Inspecent është Driton Ramadani, organizator Jakup Jakupi ndërsa skenografinë e ka bërë Ardian Kadriu.

UNESCO nuk ka thënë që lahuta është serbe



Lahuta, si pjesë e pandarë e eposit të kreshnikëve, është instrument muzikor i domosdoshëm për gjallesën e këtij cikli, por është edhe vepër arti arkaik tradicional popullor që mbart subjekte mitike të pantheonit të lashtë iliro-shqiptar. Akademiku Vasil Tole shpjegon se “UNESCO nuk ka thënë që lahuta është serbe, por ka thënë që Serbia ka regjistruar guslën dhe këndimin me të. Kjo do të thotë që ata kanë regjistruar atë trashëgimi që kanë në territorin e vet, dhe detyra jonë si shqiptarë, duke patur parasysh dhe Kosovën dhe kudo që ka shqiptarë, në përputhje me dokumentet dhe me standardet që ka UNESCO për regjistrimin e këtyre dukurive në listën, ne duhet të regjistrujmë pjesën tonë”.

“Në studimet tona na rezultojnë që trashëgimia e kënduar me vegla me një tel dhe me hark, siç është gusla në Serbi apo lahuta në territorin tonë, është një trashëgimi që gati-gati zotëron gjithë pjesën e Shqipërisë së Veriut, Kosovës dhe ku banojnë shqiptar në Mal të Zi”, shprehet Tole. “Ne kemi një detyrim shumë të madh për popullatën shqiptare që kultivon dhe e ka pjesë së identitetit të vet ta regjistrujmë sa më parë në UNESCO. Hapin e kemi hedhur në regjistrimin si listë kombëtare”.

“Doba ljubezni”, Sadije Aliti promovoi në Lubjanë librin “Stinë dashurie”

Sadije Aliti promovoi në Lubjanë librin me poezi të botuar në gjuhën sllovene e shqipe, “Stinë dashurie” - “Doba ljubezni”. Në këtë aktivitet të organizuar në Restorantin “Sole” u prezantua krijuesja, poetja, profesoresha, gazetarja, humanistja

Hasan Elshani, përkthyes dhe organizator i këtij eventi në fjalën e tij mes tjerash theksoi: “Sadije Aliti është shpirt i shkëlqyer i femrës shqiptare e formuar si artiste, si krijuese, e cila i këndon dashurisë dhe jetës. E lindur, e privilegjuar në hapësirat Ilirike është një qytetare speciale e një bote imagjinare, por edhe reale të mundshme, e cila tenton përmes një elani me qëndresë të caktuar e mahnitje antologjike të kultivojë temperamentin krijues



dhe duke e bërë më të përgjegjshme ndaj misionit fisnik për të shpallur përmes unit-femëror botën krijuese. Poetja është duke e lulëzuar në gjuhën amtare poezinë e saj, por tani po e lulëzon edhe në shumë gjuhë të tjera të përkthyer, vargu i saj krahas në gjuhën sllovene, vëllimi me poezi “Doba ljubezni”, apo titulli në gjuhën shqipe “

Stinë dashurie”, komunikon edhe me disa gjuhë të tjera të botës”.

Heset Ahmeti nga Shoqata Kulturore “Iliria” në Kopër, theksoi se promovimi i këtij libri, është shumë i rëndësishëm për shqiptarët në Slloveni, pasi tani poezitë e përkthyer edhe në sllovenisht janë më afër lexuesit slloven e shqiptar.

Recenzentja e librit, Dr. Kaja Le-

nic, potencoi se ndihet shumë e nderuar që ka qenë pjesë e ekipit të punës së këtij libri dhe se bashkëpunimi kulturor është shumë i rëndësishëm për të dy popujt.

Sadije Aliti theksoi se ndihet shumë e nderuar me prezencën e një numri kaq të madh të bashkatdhetarëve që jetojnë në Slloveni, është një kontribut modest kulturor për të afirmuar kulturën dhe vlerën letrare të popullit shqiptar, është angazhim kulturor që ndihmon në ruajtjen e dhe kultivimin e kulturës dhe gjuhës shqipe të bashkatdhetarët në Slloveni, në bashkëpunim dhe afirmim të kulturës të popullit shqiptar dhe popullit slloven dhe në shërbim të përparimit dhe zhvillimit shoqëror e ndërkombëtar.

Poeti Fahredin Shehu, botohet në SHBA

Shtëpia botuese Inner Child Press International LTD, nga New Jersey, SHBA, botoi librin e radhës nga poeti kosovar Fahredin Shehu. Libri titullohet “HERENOW” ose “Këtuania” që shfaq një poezi avangarde me notë të fuqishme të lirikës shpirtërore dhe kontemplative gjë që është vullë kreative e poetit Shehu. Poezitë janë të ndara në ciklet: Humnera e sipërisë, frymëzuar nga filozofia e Jean Baudrillard. Dy masa të prera për të vetmin shpirt, që e riaktualizon Maister Eckhart në epokën digjitale, cikli Fytyrat nga Asgjëkundia, dimensiononi i Afërlargët i njeriut dhe relacioni i tij kosmologjik me kreativitetin. Pësia e dhembjes, një cikël me lirikë shpirtërore nokturnale dhe diurnale dhe cikli i fundit Aktet të pafajshme

të Vetëdijes. Për Librin kanë shkruar emrat më të shquar të letërsisë botërore aktualisht nga vende të ndryshme të botës. Vlen të ceket vështrimi i profesori i letërsisë nga Dublini, Patrick Lodge, i cili shprehet:

“...poezitë janë të ndjera duke mbarsur thelle diçka shpirtërore në çdo varg. Vetëm poezia “Kah shpresa”, do të mund të ishte një vepër e vetme dhe ajo flet...thuaje fjalën o poet, fjalën depërtuese si një raketë, Herenow është një raketë e tillë”, përfundon prof. Lodge. Nga një kënd tjetër i globit shkruan profesori i letërsisë amerikane nga Universiteti Meiji në Tokyo, profesori Keijiro Suga:

“Nadalo së adhuruari Kohën, sepse Koha nuk është më Zot. Tokat e largëta rrotullohen, por për ty poet

nuk ka Lindej as Perëndim. Të jesh këtu, të jesh Tani...të jesh i zëshëm si qielli. Atje ti e gjen vetën që i ngjan askujt dhe e emërton Fahredin Shehu. Engjëlli i fundit i dashurisë në Tokë, ose një, i cili përpigjet të bëhet. Për këtë libër ka shkruar edhe profesoresha Fiona Sampson nga Universiteti Roehampton në Londër. Sampson është njëra nga katër poetë më të mirë të Mbretërisë së Bashkuar. Sampson shkruan: “Fahredin Shehu një shkrimtar më dhunti të shtrira gjithandej të lirikës, vizionit dhe guximit. Poezitë e tij evokojnë botë të mundshme dhe ato botë të pamundshme si dhe gjetjen e revelatave/zbulesave nga jeta e përditshme. Ai është shkrimtar që duhet celebruar, frymëzues në admirim dhe mendjemprehtë



në elegji”. Poeti kombëtar Norvegjez Knut Ødegård, i cili një kohë të gjatë e ndjek krijimtarinë e Shehut thotë:

“në poezinë e Fahredin Shehut unë gjej një kombinim të rrallë të pasionit dhe mëshirës. Ai është një poet i ditur, i cili di se kreativiteti në art është njohja e traditave, fillimisht njohja e traditës së vetë e më pas edhe të traditave tjera. Më pas



Shehu shton diçka të re në këtë traditë krijuese, diçka që nuk ka ekzistuar në letërsi para shkrimit të poezive të tij. Empatia është fjala me, të cilën dua ta përshkruaj poezinë e Shehut. Afërsia e Tokës me Trupin, ndjeshmëria dhe shprehja brilante e epshit njerëzor. Të gjitha këto të kombinuara me vetëdije të Shenjtës...”. Libri i ka 120 faqe dhe gjendet në shitje në Amazon books.



GABRIEL GARCIA MARKEZ, FISARMONICISTI QË FITOI "NOBEL"

(E ëma: Nëse do të bëhesh shkrimtar, duhet të bëhesh vetëm shkrimtar i mrekullueshëm)

Në fakt, s'është i vetmi që s'është kish menduar ndonjëherë që të bëhesh shkrimtar, por kur flitet për Markesin e famshëm, lajmi bëhet interesant. Ai ishte një fëmijë që shkëlqente në gjithçka mes moshatarëve, ndërkohë që ajo që e tërhiqte më shumë ishte muzika. Kështu, vite me radhë, Gabriel mori mësim në fisarmonikë dhe deri në fund të adoleshencës u bë thujse virtuoz. Në Kolumbinë e gjysmës së parë të shekullit të kaluar, panairret e zhurmshme ishin nga festat më të bukura për fëmijët. Dhe pikë-

risht duke bredhur nga njëri panair në tjetrin, doli në pah më shumë talenti i tij, duke bërë që "Gabo" të mos mendonte asgjë tjetër, veç një karriere brilante muzikore.

Mirëpo, dëshira e tij e madhe hasi në kundërshtimin e fortë të familjes. E cila e donte fizikan, ose në një profesion tjetër "më serioz dhe të nderuar". Thuhet që në përfundim të maturës, shkrimtari i ardhshëm më i njohur i "realizmit magjik", ka patur përjetuar diskutime të gjata në shtëpi lidhur me të ardhmen e tij. Por, ka qenë një ba-

shkëbisedim i gjatë me të ëmën, Luisa Santiaga Márquez Iguarán, që duket e ka detyruar në fund, të heqë dorë përfundimisht nga ëndrra e muzikës. Pavarësisht që djalo-shi Markes, vazhdoi studimet për drejtësi në Bogota, gjatë këtij bashkëbisedimi, ka qenë sërish e ëma që e ka joshur për herë të parë me letërsinë, duke i propozuar që të bëhesh shkrimtar. "Ti je krenaria e familjes sonë dhe nëse përipiqesh mund të bëhesh gjithçka"- i ka thënë ajo, mes të tjerave - "kështuqë, ne mendojmë që ke të dhëna

për t'u bërë edhe shkrimtar. Ama, nëse vërtet i futesh kësaj rruge, duhet të jesh një shkrimtar i mrekullueshëm. Ndoshta edhe pse raca e tyre është në zhdukje".

Gjithçka tingëllon si një intuitë nëne, por në vitin 1955, kur ishte 28 vjeçar, Gabriel fiton çmimin e parë në një konkurs me tregimin "Dita pas së shtunës", në moshën 40 vjeçare, më 1967, përfundon kryeveprën e tij "Njëqind vjet vetmi", ndërsa në moshën 65 vjeçare, i akordohet çmimi "Nobel" në letërsi.




Karriera e Mikelanxhelos, falë mashtrimit që i bëri kardinalit

Ishte viti 1496. Imagjinoni një artist të ri të talentuar, pa shtëpi dhe pa një punë të sigurtë, që endet rrugëve të Bolonjës për të kapur një mundësi sado të vogël për të shpalosur aftësitë e tij të veçanta. Të cilit, kur dikush i sheh rastësisht një skulpturë të përfunduar, i propozon diçka: A mundet ai, të realizojë një skulpturë të antikitetit, që ajo të mos dukej si një kopje, por origjinalja? Në lojë ishin shumë para, aq sa skulptori s'i kishte menduar ndonjëherë. Pastaj, personi (që në fakt, ishte një nga përfaqësuesit e familjes së famshme Medici), dukej i fismë dhe i besueshëm. Kështu, artisti 21 vjeçar, që quhej Mikelanxhelo Buonaroti, u bë pjesë e një mashtrimi në fushën e artit, që ndoshta mund ta çonte edhe pas hekurave. Mirëpo, që në fakt i çeli dyert e karrierës.... Vërtetë që porositësi i skulpturës ishte njëri nga "medicët", por blerësi ishte kardinal.

Biografë të Mikelanxhelos, thonë në librat për mjeshterin e madh italian, që kardinali që quhej Rafeale Riario, e njohu shpejt që skulptura s'ishte ajo e antikitetit. Ama, njohu edhe që ajo ishte realizuar nga një mjeshtër i jashtëzakonshëm. Kështuqë, në vend ta padiste, i propozoi të vinte të punonte në Romë, ku dihet që asokohe, ishte kisha katolike ajo që financonte më shumë veprat e artit në katedralet dhe kishat e saj. Pasi realizoi për disa muaj "Pieta-n", njëren nga mrekullitë e sotme të Bazilikës së shën Pjetrit, Mikelanxhelos iu besua "Davidi", në Firence, ndër majat e skulpturës botërore të të gjithë kohërave. Pas rikthimit në Romë, fama e mjeshtrit të ri, kishte marrë dhenë. Kështu, në vitin 1509, pra 12 vjet pas mashtrimit që i kish bërë kardinalit bamirës, karriera e tij në ngjitje, arrin të kurorëzojë tavanin e "Kapela Sistine", njëra nga kryeveprat më të mahnitshme të artit të Rilindjes italiane, e cila si kapela e Papës, ishte zbuluar më parë edhe nga Botiçeli dhe Pruxhino. Mikelanxhelo Buonaroti (1475-1564), që veç skulptor i jashtëzakonshëm, ishte dhe piktor, arkitekt dhe poet, konsiderohet ndër 3 artistët më të mëdhenj të Rilindjes, krahas Karavaxhios dhe da Vinçit. Lavdi kjo, që ndoshta s'do ta kishte prekur nëse s'do të takohej me kardinalin Riario, që e mashtrroi në moshën 21 vjeçare.

Në lindje të Edenit

Botimet Living prezantojnë "Në lindje të Edenit", kryevepra e viteve të fundit të krijimtarisë së shkrimtarit John Steinbeck. Një roman ambicioz, i cili është njëherazi një sagë familjare dhe një ritregim modern i Zanafillës. Në ditarin e tij, Steinbeck



e ka cilësuar librin "Në lindje të Edenit" si librin e tij të parë dhe është që ky libër mbart fuqinë fillestare dhe thjeshtësinë e një miti. Ngjarjet zhvillohen në Lu-

ginën e Salinasit, në Kaliforni dhe romani ndjek dhe zbulon jetën dhe fatet e dy familjeve: Tresk dhe Hemillton, brezat e të cilave duket sikur risjellin në skenë rëniën e Adamit dhe të Evës dhe rivalitetin e hidhur të Kainit dhe Abelit. Personazhe që i mbijetojnë çdo kohe me tematikat e tyre: identitete të mistershme, dashuri të pashpjegueshme dhe pasoja vdekatare prej mungesës së dashurisë.

"Gonkur", çmimi qesharak me 10 euro

(Por më pas, libri fitues botohet në 300 mijë kopje...)

Çmimi francez "Gonkur", përfshihet në "top listën" e 5-6 çmimeve më të rëndësishëm të letërsisë në botë, pas çmimit "nobel". Por, shpërblimi i akorduar për fituesin e tij është mjaft grotesk.

Ai është vetëm 10 euro, me të cilat nuk mund të blesh as njëren këmbë të një palë këpucëve të lira në Francë. Ndërkohë, ai figuron edhe i dyti prej tyre në këtë fushë për nga vjetërsia, që në vitin 1903 (dy vjet pas "nobelit" të parë) dhe jepet vetëm për autorët francezë. Mirëpo, shpërblimi i madh për autorin, nis menjëherë pas ceremonisë. Kështu, libri i autorit fitues, botohet gjithmonë të paktën, në 300 mijë kopje, një tirazh jo i vogël ky, në Francën me 70 milionë banorë. S'është e thënë që gjithmonë të shitet krejt tirazhi i mësipërm, por gjithsesi shuma e përfituar duket e majme,

krahasuar me çmime të tjera analoge, si "Pulitzer SHBA, me 1 mijë dollarë, "National Book Awards" po në SHBA me 10 mijë dollarë, apo "Booker prize" me 20 mijë stërlina në Angli.


Interesante është dhe ceremonia e "Gonkur". Ajo organizohet çdo vit në një nga restorantet historikë të Parisit, ku shtrohet një banket për të ftuarit, pas së cilës një juri me 10 shkrimtarë jo të fushës akademike, shpallin fituesin. Në fakt, lista e të laureuarve me këtë çmim, s'është fort mbresëlënëse. Ndoshta, nga që letërsia e shekullit të XX në Francë, pak emra ka patur me famën e Hygoit, Stendalit, Balzakut apo Dymasë, në të shkuarën. Gjithsesi, me "gonkur" është nderuar Prusti, Amin Maluf, Margaritë Dyrras, Mishel Turnie etj. Fitues i vitit 2018, ishte 40 vjeçari Nikola Matje, ndërsa fituesi i parë, më 1903, Xhon Antuan Nau.



Kush ishte

Jorge Luis Borges?

Jorge Luis Borges (bôr'hës) (Buenos Aires, 24 gusht 1899. – Gjenevë, 14 qershor, 1986), është shkrimtari më i famshëm argjentinas. I njohur për tregime të shkurtëra, por ishte poet dhe eseist. Ngjarjet më të rëndësishme në biografinë e tij janë të lidhura ngushtë me disa nga paraardhësit e tij. Duke qenë se rrjedh nga një familje studiuesish dhe ushtarakësh Borges zgjodhi letërsinë megjithëse e pati një peng të madh për shumë kohë faktin që nuk zgjodhi ushtrinë. Nga 1914 deri 1921 jetoi bashkë me familjen në Evropë. Kreu studimet filimisht në Gjenevë e më pas në Spanjë, ku njohu më mirë letërsinë dhe shkroi disa nga poezitë e tij të para. Në 1923 publikoi librin e tij të parë me poezi, "Fervor de Buenos Aires", dhe pas dy vjetësh librin e dytë "Luna de Enfrente". Në 1925 Borges njohu Viktoria Okampo, muza e tij për shumë vite me të cilën u martua 40 vjet më pas. Me të Borges pati një mirëkuptim intelektual i destinuar për të hyrë në mitologjinë e letërsisë argjentinas. Aktiviteti publicistik i Borges ishte shumë i gjerë. Vargjet e "Kauderno San Martín" u publikuan vetëm në 1929, ndërsa një vit më pas doli "Evaristo Karriego", një vepër që entuziazmoi kritikën argjentinas. Një fatkeqësi tjetër në jetën e shkrimtarit: verbohët. Borges, i cili kishte pasur gjithnjë probleme me sytë, e humbi përfundimisht shikimin në fund të viteve 50' pasi kishte kryer 9 operacione. Por këtë sëmundje ai e përdori për të krijuar akoma më shumë. Kulmin e këtij procesi "sublimimi" ai e pati në vitet 1933 e 1934. Të gjitha tregimet e publikuara prej tij në revistën "Kritika": dolën në një përmbledhje të vetme me titullin "Historia universal de la infamia" (Historia universale e poshtërsisë), që u pasu disa vite më vonë nga "Historia de la eternidad" (Historia e përjetësisë), një vepër ndërthuret Historia dhe Dituria. Annus horribilis (mos e ndrysho!!! nga latinishtja vit i tmerrshëm): Viti 1938. Nisi me vdekjen e babait të Borges, më pas vetë shkrimtari pësoi një aksident që detyroi të mos lëvizte për një kohë të gjatë, e me pas një atak seticemie (sëmundje gjaku) që i rrezikoi seriozisht jetën. Kjo situatë dramatike provokoi te Borges frikën se mund të humbte përgjithnjë aftësitë e tij krijuese. Frike e pabazuar: gjatë viteve kur ishte i sëmura ai krijoi disa nga kryeveprat e tij të cilat u publikuan në 1944 nën titullin "Shtirjet". Pas 5 vjetësh dolën disa nga tregimet e tij në librin e titulluar "Alef". Gjatë kësaj periudhe Borges cilësohej si një nga shkrimtarët më të mirë argjentinas të të gjitha kohërave. Si për të pohuar dhe një herë aftësitë e tij, Borges publikoi një tjetër kryevepër që mban titullin "Inkuizionet e tjera" (1952). Në 1955 Borges u emërua drejtor në Bibliotekën Kombëtare, një nga ëndrrat e tij të hershme. Në fjalimin e rastit ai u shpreh se: "Është një ironi sublime dhe hyjnore që më jepen 800 mijë libra kur unë jam në terr të plotë prej vitesh". Pas 31 vjetësh drejtor ai u nda nga jeta më 14 qershor 1986. Pranë varrit të tij prehen eshtrat e gruas së dytë të Borges-it, María Kodama. Shumë regjisorë janë bazuar në jetën e tij për të realizuar filma, dhe sa për shembull mund të përmendim një mbi të gjithë "Estela Kanto, Un Amor de Borges", nga regjisor i Javier Torre (1999). ku protagonistë është bukuroshja Ines Sastre.



JORGE LUIS BORGES

I KËRCËNUARI

Është dashuria. Duhet të fshihem ose të marr arratinë. Si në një ëndërr mizore, ngrihen muret e burgut të saj. E hirshmja maskë ka ndryshuar, por si gjithmonë është e vetmja. E për çfarë do të më vlejnjë hajmalitë e mia: përdorimi i shkronjave, erudicioni i mugët, mësimi i fjalëve që përdori Veriu i ashpër për të kënduar detet dhe shpatat e tij, miqësia e pastër, galeritë e bibliotekave, gjërat e thjeshta, zakonet, dashuria fëmijërore e sime mëje, hija luftarake e të vdekurve të mi, nata e pakohë, shija e ëndrrës? Të jem apo të mos jem me ty, është përmasa e kohës sime. Tani shtamba thyhet në gurrë, tani njeriu me zërin e shpendit ngrihet, tani ata që këqyrin nga dritarja janë hijesuar, por hija nuk e sjell paqen. E di, dashuria është: ankthi dhe qetësia që të dëgjoj zërin tënd, pritja dhe kujtesa, tmerri i të jetuarit në të pastajmen. Është dashuria me të sajat mitologji, me të sajat të vogla magji të kota. Është një kryqëzim ku s'marr guxim të kaloj. Tani ushtritë më rrethojnë, hordhitë. (Kjo dhomë nuk është reale; ajo nuk e ka parë) Më kallëzon emri i një femre. Në gjithë trupin më dhemb një femër.

Të Drejtët

Një njeri që punon kopshtin e tij, siç donte Voltaire. Ai që është mirënjohës që në tokë ka muzikë. Ai që zbulon me kënaqësi një etimologji. Dy punonjës në një kafene në Jug që luajnë shah në heshtje. Qeramisti që mendon gjatë një ngjyrë dhe një formë. Tipografi që ndërton bukur këtë faqe, që ndoshta nuk e kënaq. Një grua dhe një burrë që lexojnë tercetet e fundit të një kënge. Ai që përkëdhel një kafshë që fle. Ai që justifikon apo do të justifikojë një të keqe që i kanë bërë. Ai që është mirënjohës që në tokë ka një Stevenson. Ai që parapëlqen që të tjerët të kenë të drejtë. Këta njerëz, që askush s' i njeh, po shpëtojnë boten.


SHKRETËTIRË

Para se të hyjnë në shkretëtirë ushtarët pinë për një kohë të gjatë rezervuarin e ujit. Ikerocles hodhi në dysheme ujë dhe shtambës së tij dhe tha: Nëse duhet të hyjmë në shkretëtirë, Unë jam tashmë në shkretëtirë.

Nëse etja duhet të djegë, tashmë ajo më djeg. Kjo është një parabolë. Para se të zhytet në ferr liktorët e zotit më lejuan të shihja një trëndafil. Kjo rozë është tani mundimi im në sferën e errët. Një burrë u braktis nga një grua. Ata pretendonin një takim të fundit. Njeriu tha, Nëse duhet të shkoj në vetmi Jam tashmë vetëm. Nëse etja duhet të djegë, që tani ajo më djeg. Kjo është një shëmbëlltë tjetër. Askush në tokë S'ka guxim të jetë ai njeri.

RETË

S'do të jetë kurrë diçka që s'është një re. Unë jam katedrale e gurit të madh dhe dritareve biblike të qelqit të njomur se koha do të kalojë. Është Odiseja, që ndryshon si deti. Nëse e rihapni atë gjithmonë diçka ndryshon. Edhe reflektimi fytyra juaj është tashmë një tjetër në pasqyrë dhe dita është një labirint i dyshimtë. Ne jemi ai që shkon. E shumta një re që shkon në perëndim është zbukurimi ynë. Vazhdimisht trëndafil lëviz, në një tjetër u rrit. Ju jeni një re, ju jeni një det, ju jeni harresë. Ju jeni gjithashtu gjithçkaja që keni humbur. II Ata shkojnë nëpër ajrin e qetë të malit ose enden me hijet tragjike që errësojnë ditën. Ne i quajmë ato Ato kanë gjithmonë forma të çuditshme. Shekspiri vuri re një prej tyre. Ajo dukej si një dragua. Atë re të një nate ajo e ndriçon dhe ajo digjet në fjalën e saj dhe ne vazhdojmë ta shohim përsëri. Retë ku unë jam?, arkitekturë e rastit? Ndoshta Perëndia ka nevojë për këtë për të kryer punën e pafund: janë temat e komplotit të saj të errët. Ndoshta reja nuk është më pak kotësi e njeriut që e sheh në mëngjes.



Dritë e gushtit


“Dritë e gushtit” është roman i qëndrësës shprehëplotë kundrejt vdekjes dhe rrëfen tre histori, historinë e gruas së re dhe të pafajshme Lina Grouv në kërkim të babait të fëmijës së saj të palindur; historinë e Gejl Hajtauerit i cili jeton në të shkuarën me historitë e dikurshme të kalorësve të Konfederatës, dhe historinë e Xho Krishtlindit, me njërin prind të bardhë dhe njërin zezak, kësajsoj me prejardhje të përzier racore.

Folkneri e nisi shkrimin e romanit duke mos pasur ide tjetër përveçse një personazhit të një gruaje të re, Lina Grouvit, shtatzënë, duke u çapitur e vetme në rrugët e një qyteze të huaj, e mbetur pas asgjë, dhe e vendosur për të gjetur të dashurin e saj. Ajo mund të jetë forma e shkurtër e emrit “Helena” ose “Magdalena” dhe kësajsoj, kombinon bukurinë dhe ngasjen seksuale të Helenës së Trojës dhe ngjyresën kuptimore të Magdalenës, prostitutës së shëlbyer. Personazhi i Lenës të kujton edhe tipare të Virgjërshës Mari dhe fëmija të cilën ajo lind, mund të konsiderohet si një fëmijë-Krisht.

(“Fenomenologjia e shpirtit”-libri para së cilit janë dorëzuar edhe filozofët)

Vepra e madhe e papërkthyeshme e Hegelit


Ajo është botuar fillimisht, plot 211 vjet më parë, më 1807-ën, por ende edhe sot është njëra nga veprat më gjigande e më të thella shkruar nga dora e njeriut dhe mjaft e “pakuptueshme” për t’u asimiluar. Fjala është për veprën filozofike “Fenomenologjia e shpirtit” të Xhorxh Vilhelm Fridrih Hegelit (1770 - 1831), ndër veprat më të monumentale të filozofisë moderne. Një traktat deri në qelizë mes materiales dhe ideale, të cilën mund ta shkruajë vetëm një gjeni si ai. Filozofi i madh gjerman, hodhi poshtë idealizmin e Kantit dhe historinë e ndërjegjes, përballë së cilave shpjegoi me imtësi procesin e Tij dialektik. Ai u end gjithë jetën e tij mes racionalistëve dhe moralistëve, por duke mos rënë për asnjë çast në grackën e secilit prej tyre, dhe mendimi më i pranueshëm për veprën e tij të madhe është, që ai ishte pa asnjë dyshim një pozitivist i mbështetur fort tek



historia. Për më tepër, i pakontestueshëm. Interesant është fakti, që përgjatë më shumë se dy shekujve, më shumë sesa me tezat e tij brilante të “Fenomenologjisë...”, studiuesët janë marrë me shkallën e saj të lartë të vështirësisë në lexim, duke u dorëzuar në një farë mënyre para forcës së logjikës së “profesorit të jashtë-

zakonshëm të filozofisë”, siç quhej. Në fakt, filozofia e Hegelit, përveçse mjaft novatore dhe që shembi skemat e deriatëhershme të mendimit filozofik, ishte tepër e thjeshtë. E përmbledhur deri diku në postulatit e tij të mëposhtëm : “Unë them një pohim. E ky pohim, quhet “tezë”. Një tjetër bën polemikë me tezën time, dhe kjo quhet “antitezë”.

Porse, e gjithë kjo, përbën thelbin e “Fenomenologjia e shpirtit” dhe duket shumë hermetike për të depërtuar në të e për t’u tjerë nga të tjerët. Për kuriozitet, libri i mësipërm i Hegelit, nuk është botuar në të gjithë gjuhët si mjaft vepra të tjera, pikërisht nga vështirësia e jashtëzakonshme në përkthim. Si i tillë, ai s’ka ardhur ende as në shqip. Vepra të tjera të filozofit të madh gjerman, janë edhe : “Enciklopedia e shkencave filozofike”, si edhe “Shkenca e logjikës”.




SPQR, Një histori e Romës së lashtë

Mary Beard na ka dhënë me këtë libër një shembull frymëzues për mënyrën se si duhet ta shohim, analizojmë dhe shkruajmë historinë, jo vetëm atë të Romës së Lashtë, por historinë në tërësi. Ajo çmonton mitet dhe narrativat e ngulitura në mendjet tona që nga koha e Mesjetës për të na dhënë një histori ashtu si realisht mund të ketë qenë dhe jo ashtu si ne e imagjinojmë. Nga karriera e gjeneralëve dhe oratorëve të mëdhenj deri te jeta e të varfërve, historia e Popullit dhe Senatit të Romës na shpaloset si ngjarje që, ndonëse kanë ndodhur dy mijëvjeçarë më parë, vijojnë të na imponojnë mënyrën se si ne mendojmë për shtetin, politikën, të drejtat qytetare dhe rendin kushtetues.

Mjeshtëror... kjo është një histori popullore ekzemplare. Dërfryese por kurrësi e thjeshtëzuar, Beard ofron në këtë libër panoramën e gjerë dhe detajet më intime për të sjellë të gjallë te ne një të shkuar të largët. Economist
‘Beard shpalos sekretet e suksesit të qytetit me një qartësi të mprehtë dhe të pamëshirshme të tillë që unë nuk e kam parë asgjëkund gjetkë...’
The New York Times

“Më quajnë... Arkitekt Sinani” një libër për fëmijë

Libri “Më quajnë... Arkitekt Sinani” është pjesë e serisë që “ALBAS” ka lanuar për promovimin e figurave qendrore të kulturës dhe artit, arkitekturës dhe muzikës, letërsisë dhe historisë, kombëtare dhe botërore. Përmes librit, kjo shtëpi botuese kërkon t’u pasojë gjeneratave testamentin e vlerë të vetëdijes, asaj e cila është shtruar me njësinë e emrave dhe personaliteteve, kontributeve qytetëruese dhe kurajozëve të historisë. “Më quajnë... Arkitekt Sinani” është një urëlidhje e disponimit aktual me atë manifestim gati të hyjshëm aftësishtë gjeniale të këtij personaliteti që dominon traditën islame në fushën e ndërtimit. Ky personalitet vjen përmes këtij botimi për të ofruar një njohje dhe vlerësim për Arkitekt Sinanit, veprimtarinë krijuese që e skaliti emrin e tij në kolanën e gjenive të qytetërimit



botëror. Kjo qasje për të rivlerësuar Arkitekt Sinanin si një shënjim i rëndësishëm në themelet e Orientit, cek momentet më kulmore të jetës së tij. Ardhur e thjeshtuar, kjo galeri jetësore dhe krijuese, ky personazh kërkon të mbajë fëmijët të lidhur me librin, por edhe me historinë, me ato personalitete, të cilët

shkruan emrin e tyre me shkronja të arta në faqen e memories së qytetërimeve. Arkitekt Sinani ka qenë emblema e një etape kulmore të zhvillimit osman. Ai la gjurmë në historinë e arkitekturës dhe ndërtimtarisë. Solli risi dhe sprova të kurajshme në ndërtimin, jo vetëm të objekteve religjioze por edhe atyre sociale, për të mbetur një piketë e qenësishme e etapave të progresit krijues dhe vlerat pasurore të asaj kohe trazimesh, mizorish dhe luftërash të përgjakshme, përmes së cilave orienti penetroi për t’u bërë pjesë e kreshtave civilizuuese, për të zënë vendin që i takonte në vezullimin shkëlqyes të diejve që u panë me njeriun në rrugëtimin e tij transformues të botës. “Më quajnë... Arkitekt Sinani” e gjeni te botimet ALBAS në të gjitha libraritë, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni.

Një roman ku Eco hyn thellësisht në misterin e shpirtit njerëzor

“Flaka misterioze e mbretëreshës Loana” (Originali: La Misteriosa Fiamma della Regina Loana), nga Umberto Eco botuar nga “Dituria”. Romani është i ndërtuar në kujtimet e personazhit kryesor, i cili është një librashitës bukinist që ka humbur kujtesën dhe mban mend vetëm librat që ka lexuar gjatë gjithë jetës. Është ndër romanet e fundit shkruar nga autori, botuar për herë të parë, më 2004. Ka 455 faqe dhe pavarësisht që s’konsiderohet nga veprat e tij më të famshme, padyshim që dhuron magjinë e shkrimtarit dhe mendimtarit të madh italian bashkëkohor

goditje cerebrale dhe jeton në mjegull. Humbja e kujtesës së tij është e çuditshme – ai mund të kujtojë përmbajtjen e çdo libri që ka lexuar, çdo varg poezie, por ai nuk di më emrin e vet, nuk e njeh gruan e vajzat e tij, dhe nuk i kujtohet asgjë nga fëmijëria.

Në përpjekje për t’u rimëkëmbur, gruoja e bind që të kthehet në shtëpinë e familjes ku është rritur,

diku në kodrat midis Milanos dhe Torinos. Atje, në papafingon e shtëpisë, ai kërkon e gjen nëpër kuti gazeta të vjetra, libra vizatimorë, disqe muzikore, albume fotografish dhe ditarë të adoleshencës.

Dhe kështu Jambo nis e rrëfen historinë e brezit të tij: nga himni fashist “Giovinezza” te Musolini, nga edukimi katolik me ndjenjën e

fajit te autorët e preferuar Salgari etj., aktoret e famshme dhe hartimet e shkollës. Jeta që garon para syve të tij merr formën e një romani grafik. Jambo lufton përmes boshllëqeve të kujtesës për të kapur një imazh të thjeshtë dhe të pafajshëm: atë të dashurisë së tij të parë dhe për të rijetuar gjurmët e një përvoje të rëndë personale në vitet e Rezistencës. Ideja e jetës, kufijtë

dhe perspektivat e saj, janë rrëfyer në këtë roman përmes kujtimeve. Ky është një libër që të bën të mendosh e kuptosh se si automatizmi i ekzistencës i ka thyer edhe gjërat më të rëndësishme në jetë, si të mirëqena. Dhe personazhit i duhet të humbë kujtesën që të rizbulojë botën! Një roman ku Eco, si kurrë më parë, hyn thellësisht në misterin e shpirtit njerëzor.



MBI LIBRIN

Jambo, një librar antikuarësh që jeton në Milano, ka pësuar një

Rama, dukshëm i tensionuar gjatë diskutimit të tij, këmbëngul për një zgjidhje të përbashkët. "Unë nuk jam Zoti që i zgjidh punët në mënyrë magjike kur i shkruajnë nga lart. Prandaj duhet zgjidhja dhe gjetja e zgjidhjeve bëhet në mënyrë të përbashkët. Unë nuk hyj dot në universitet të gjej zgjidhje siç i doni ju. Nuk mendoj se jam më i miri, por mund ta bëj këtë punë shumë më mirë duke mbajtur veshët hapur"

Gjatë një video-konferencë, dje, kryeministri Rama u këmbëngul për një dialog me studentët të se dialogu është shumë i rëndësishëm në këtë rast, ai po ashtu tha se për negociatën nuk kemi asgjë për të negociuar, por vetëm për të dialoguar.

"Nëse protesta është e atyre që dolën spontanisht në një protestë për një gjë të drejtë, duhet të dialogojmë. Dialogu nuk është një akt martese me zorrë, por është një akt ku palët flasin dhe dëgjojnë. Vazhdoni protestoni dhe shumë mirë bëni që protestoni. Si mund të jemi sot në këtë Shqipëri, duke bërë një

TË DISKUTOJMË, PAJTOHEM ME SHQETËSIMET E STUDENTËVE



rrugë të gjatë dhe të vështirë, dhe të punojmë kundër dialogut me qeverinë dhe kryeministrit. Pse ca është kryeministri dyqan, magazinë, ku shkruhen kërkesat dhe merren përgjigjet nga televizori?"

Rama, dukshëm i tensionuar gjatë diskutimit të tij, këmbëngul për një zgjidhje të përbashkët. "Unë nuk jam Zoti që i zgjidh punët në mënyrë magjike kur i shkruajnë nga lart. Prandaj duhet zgjidhja dhe gjetja e zgjidhjeve bëhet në mënyrë të përbashkët. Unë nuk hyj dot në universitet të gjej zgjidhje siç i doni ju. Nuk mendoj se jam më

i miri, por mund ta bëj këtë punë shumë më mirë duke mbajtur veshët hapur. S'doni të dialogoni është e drejta juaj, rrii atje dhe mos ndaloni së protestuar", tha ai.

Kërkesat e studentëve kanë evoluuar që nga fillimi i protestave 5 ditë më parë. Ata fillimisht protestuan për ulje tarifash për studime dhe arsim më cilësor publik, mirëpo në ditën e pestë, ata kanë renditur 8 pika tjera që kanë të bëjnë me përfaqësimin e tyre në borde administrative dhe mbështetje financiare të aktiviteteve dhe kërkimeve të tyre shkencore. "Nuk ka negocia-

ta, le të marrë vendim për të na i plotësuar kërkesat", tha një student. "E papranueshme ftesa e tij! Nuk e pranojmë dialogun. Duam vendime të shkruara, jo fjalë", tha një tjetër student.

Ata, pas fjalës së kryeministrit brohoritën së bashku "nuk ka negociatë" dhe "ulni tarifën". Qeveria e Shqipërisë thotë se tarifën nuk i përcakton ministria, por ato caktojnë universitetet. Megjithatë, protestuesit pohojnë të kundërtën, duke thënë se është Qeveria ajo që ka caktuar çmimet tavan.

Si përgjigje ndaj protestës, Ministria e Arsimit u pajtua të heqë pagesat për provimet e mbartura, mirëpo studentët kërkojnë plotësimin të secilës kërkesë që ata e kanë parashtruar. Tarifën e shkollimit në universitetin shtetëror të Shqipërisë konsiderohen të jenë ndër më të lartat në rajon dhe Evropë, sa i përket shkollimit publik. Shqipëria, që është anëtare e NATO-s që nga viti 2009 dhe i është dhënë statusi i kandidatit për BE në vitin 2014, është një nga vendet më të varfra në Evropë.



Masa tjera ndaj Serbisë

Pas vendosjes së taksës doganore prej 100 për qind për mallrat e Serbisë dhe të Bosnje e Hercegovinës, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka paralajmëruar masa shtesë për Serbinë. Mediat serbe dje raportuan se masat që qeveria e Kosovës pritet t'i vendosë kundër Serbisë janë: heqja e sistemit të pagesave në veri të Kosovës, ndalimi i hyrjes së ministrave dhe zyrtarëve serbë, si dhe ndalimin e hyrjes për automjetet me targa të Serbisë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se nuk guxon të flas kur u pyet nga KTV-ja për masat e mundshme ndaj Serbisë. Për këtë temë Haradinaj ka kërkuar mirëkuptim dhe se do të flasë nesër pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës. "Për sot nuk guxoj të flas. Nesër e kemi mbledhjen e qeverisë dhe për këtë dhe tema të tjera mund të flas", tha ai. Gjatë së dielës është raportuar në media se në mesin masave të reja ndaj Serbisë është edhe ajo e ndalimit të veturave me targa të Serbisë në Kosovë.

Veriu shqiptar, më i varfëri në Europë

Të ardhurat e banorëve të Veriut të Shqipërisë janë vetëm sa 24% e mesatares së shteteve të Bashkimit Europian (BE), duke e renditur atë në rajonin më të varfër të Europës. Shifrat janë bërë të ditura së fundmi nga Eurostat në një raport për prodhimin e brendshëm bruto në nivele rajonale dhe i përkasin vitit 2016 dhe janë bazuar në standardet e barazisë së fuqisë blerëse (PPS) në

raport me mesataren e 28 vendeve të BE (BE-28 = 100). Shqipëria është e ndarë në tre rajone, Veriu, Jugu dhe Qendra. Të ardhurat për frymë të Veriut janë vetëm 23.8% të mesatares së BE, shumë më të ulëta sesa rajoni i dytë më i varfër në listë, që është Severozapaden i Bullgarisë, me 29.47%, sipas tabelës së publikuar nga Eurostat dhe të përpunuar nga Monitor. Rajoni i tretë më i varfër i

Europës është Jugu i Shqipërisë, me 29.52% të mesatares së Bashkimit Europian. Më pas renditen Mayotte në Francë (33.27%), dy rajone të Bullgarisë "Yuzhen Tsentralen" (33.53) dhe "Severen Tsentralen" (33.95). Qendra e Shqipërisë, ndonëse është më e pasur sesa Veriu dhe Jugu, duke pasur të ardhura për frymë sa 34.45% e mesatares së BE, sërish është ndër më të varfërat e Europës,

duke u renditur e shtata nga fundi. Në fakt, nga 7 rajonet më të varfra të Europës, 3 prej tyre janë të Shqipërisë. Si një e tërë, të ardhurat për frymë të Shqipërisë janë sa rreth 30% e mesatares së BE-së, duke e renditur edhe si shtet si më të varfrin e Europës. Serbia dhe Maqedonia e kanë këtë tregues në rreth 37% dhe 35% përkatësisht, ndërsa në Mal të Zi është rreth 40%.

Philip S. Kosnett, ambasadori i ri i SHBA-së në Prishtinë, ka thënë se Kosova ka miratuar 9 ligje dhe reforma në sektorin e drejtësisë, por sipas tij, disa qeveritarë marrin mito, ndërhyjnë në sistemin drejtësisë dhe punësojnë të afërmit e tyre, e kjo sipas tij, duhet të stopohet

Është hapur dje "Java Kundër Korrupsionit 2018", ku morën pjesë ambasadorët e shteteve të Quintit, të cilët përçuan mesazhin e tyre për luftimin e korrupsionit në Kosovë. Nataliya Apostolova shefe e zyrës së BE në Kosovë, tha se korrupsioni si fenomen prish imazhin

Në Kosovë jepet mito dhe ndërhyhet në drejtësi



e Kosovës. Ajo ka thënë se një pako e ligjeve për luftimin e korrupsionit janë miratuar, por edhe duhet të zbatohen. "Kemi kërkuar nga autoritetet e Kosovës kemi kërkuar të marr veprim të rreptë kundër korrupsionit. Ka pasur disa ligje që e mundësojnë këtë si ligji penal, ligji i sinjalizuesve që duhet edhe të zbatohen", theksoi ajo. Apostolo-

va ka shtuar se Kosova ende po përballë me korrupsionin, por duhet luftuar bashkë për çdo ditë të vitit.

Philip S. Kosnett, ambasadori i ri i SHBA-së në Prishtinë, ka thënë se Kosova ka miratuar 9 ligje dhe reforma në sektorin e drejtësisë, por sipas tij, disa qeveritarë marrin mito, ndërhyjnë në sistemin

drejtësisë dhe punësojnë të afërmit e tyre, e kjo sipas tij, duhet të stopohet. "Në Kosovë ka zyrtarë që shpeshherë e vendosin në prioritet çështjen personale para asaj të shoqërisë. Ka ardhur koha që duhet të veprohet nga transparenta në luftimin e korrupsionit", ka thënë Kosnett. Ambasadori i Britanisë Ruari O'Connell ka thënë se Kosova të jetë një shtet i fort dhe i sigurt, duhet të luftoj korrupsionin, sikur që luftohet në Britani. Ai ka shtuar se në sistemin e drejtësisë ka ndërhyrje nga pushtetarët. Ambasadori i Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi ka thënë se asnjë vend nuk është imun prej korrupsionit, e as Kosova. "Transparenta është e domosdoshme kur ka fonde publike, siç është sektori i prokurimit. Korrupsioni pengon potencialin ekonomik, shoqë-

ror dhe politik dhe lufta kundër korrupsionit duhet të ndodhë. Për luftën kundër korrupsionit gjend vend mbështetja edhe nga Italia për Kosovë", theksoi ai. Ingarkuari me punë në ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Jan Axel Voss ka thënë se korrupsioni ka të bëjë me lakminë që të merren të mirat e shoqërisë. Kjo thjesht sipas tij, e minon të ardhmen e qytetarëve. "Dëshirojmë që mos të ketë korrupsion dhe parat e qytetarëve mos t'i shkujnë në xhepat e të korrupuarve. Të prehet korrupsioni, sepse sa më pak korrupsion aq më shumë do të ketë zhvillim ekonomik", tha ai. Ambasadori i Francës Didier Chabert theksoi se Kosova ka miratuar ligjet kyçe për konflikt interesi, andaj Kosova duhet të bëhet shembull për luftimin e kësaj të keqe.

Mes rreziqeve të tjera për ekonominë botërore në vitin 2019 ekspertët i cekin gjendjet me çmimet e naftës, si dhe zgjedhjet e ardhshme në disa vende të mëdha vitin e ardhshëm

NJË HAP PARA KRIZËS EKONOMIKE



LONDRA PËRGËNJESHTRON SHTYRJEN E VOTIMIT PËR BREXIT

Qeveria britanike i ka hedhur poshtë raportimet për një shtyrje të votimit për Brexitin në parlament. Përgjithësisht pritet që kryeministria May të pësojë disfatë në votimin në Parlament. Zyra e kryeministres britanike, Theresa May kundërshtoi spekulimet për një shtyrje të mundshme të votimit për Brexitin në parlamentin britanik. "Votimi do të mbahet të martën", tha një zëdhënës i Downing Street për agjencinë britanike të lajmeve PA. Më parë mediat patën njoftuar se May dëshiron ta shtyjë votimin, përballë disfatës që e kërcënon. Me shtyrjen ajo do të përpiqej të



fitonte kohë, ku me një "moment të çantës së dorës", ajo do të përpiqej të negocionte kushte të reja. Sipas të dhënave të "Sunday Times", May dëshironte të pengonte me këtë rrëzim e mundshëm të qeverisë së saj. Me "momentin e çantës së dorës" kuptohet dalja e ish-kryeministres britanike Margaret Thatcher, e cila në takimin e nivelit të lartë të vitit 1984 në Francë arriti lëshime më të mëdha në kontribute për Britaninë e Madhe. Në diskutim e sipër ajo e vendosi disa herë në mënyrë demonstrative çantën e saj të dorës mbi tavolinë.

për vitin 2019, duke korrigjuar vetëm një pjesë të treguesve në projekt. Rrezik për ekonominë gjatë vitit të ardhshëm paraqet edhe Brekziti - dalja e Britanisë së Madhe nga BE-ja. Nga fundi i muajit të kaluar liderët e BE-së e votuan marrëveshjen me Britaninë për Brekzitin dhe miratuan deklaratë politike për marrëdhëniet e ardhshme me Londrën. Që të hyjë në fuqi, marrëveshja duhet të miratohet nga parlamenti evropian dhe deputetët britanikë.

Parlamenti britanik duhet të votojë sot. Vetë dalja nga Unioni është paraparë për më 29 mars të vitit të ardhshëm, pas çka, sipas planit, duhet të ketë periudhë transitorie e cila do të zgjasë deri në fund të vitit 2020. Ekspertët konsiderojnë se nëse Britania e Madhe e braktisë BE-në pa marrëveshje (të ashtuquajtur "brekziti i vështirë") atëherë ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar do të ulet për rreth shtatë për qind deri në vitin 2030 në krahasim me anëtarët e tjera të BE-së. Njëkohësisht, madje edhe nëse arrihet marrëveshje pas Brekzitet, e cila do të përfshijë anëtarësim të vendit në unionin doganor të BE-së deri në vitin 2030, BPV-ja e Mbretërisë së Bashkuar do të ulet për rreth tre për qind. Mes rreziqeve të tjera për ekonominë botërore në vitin 2019 ekspertët i cekin gjendjet me çmimet e naftës, si dhe zgjedhjet e ardhshme në disa vende të mëdha vitin e ardhshëm.

Rreziqet më të mëdha botërore në vitin 2019 konsiderohen luftërat tregtare, Brekziti dhe gjendja me çmimet e naftës. Lidhur me luftërat tregtare botërore, ekspertët posaçërisht flasin për raportet mes SHBA-së dhe Kinës. Më 2 dhjetor liderët e Kinës dhe SHBA-së u dakorduan ta ndërprejnë procesin e mospajtimeve të ndërsjellta tregtare. Konkretisht, presidenti kinez, Xi Jinping dhe kolegu i tij amerikan, Donald Trump hollësisht e shqyrtuan situatën rreth marrëdhënieve kineze-amerikane.

Pritet të dyja palët të arrijnë marrëveshje për çështjet kyçe, si për shembull qasjen e shtuar drejt tregjeve, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, mënjanimin e kufizimeve për eksport të teknologjive bashkëkohore, garantimin e sigurisë kibernetike dhe luftën kundër krimit kibernetik. Në rast se nuk gjendet zgjidhje për situatën në tre muajt në vijim, Uashingtoni premtoi t'i rrisë tarifën e tanishme prej 10 për qind për listë të gjerë të prodhimeve kineze deri në 25 për qind. Nëse SHBA-ja vendosë doganë të importit për të gjitha mal-

irat kineze, atëherë bruto prodhimi vendor i Kinës mund të ulet për 1,5 për qind vitin e ardhshëm, ndërsa ekonomia globale tërësisht deri pesë për qind, pohojnë ekspertët.

Rreziqet e tjera analistët shohin në gjendjen ekonomike në Itali. Nga fundi i tetorit, KE-ja kërkoi nga Italia ta saktësojë propozim-buxhetin për vitin 2019. Në qershor KE-ja e porosi Italinë ta ulë deficitin buxhetor për 0,6 për qind të BPV-së në krahasim me këtë vit, përderisa propozim-

buxheti i Italisë, i cili ishte prezantuar KE-së në tetor, parasheh rritje të deficitit për 0,8 - 0,9 për qind përmes programeve të zgjeruara sociale. Edhe krahas asaj, Qeveria italiane e la të pandryshuar deficitin e prognozuar buxhetor



Norvegjia dhe Zvicra, rrugët më të sigurta për të udhëtuar në Evropë

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka publikuar të dhënat e reja lidhur me vdekjet në aksidentet rrugore për 100 mijë banorë. Me 13.7 vdekje për 100 mijë banorë, Shqipëria renditet ndër vendet me nivelin më të lartë të vdekjeve nga aksidentet në Evropë. Raporti thekson se Rusia ka rrugët më vdekjeprurëse në Evropë, me 18 vdekje për 100 mijë banorë. Më pas renditet Armenia me 17.1, Bosnjë Hercegovina me 15.7, Gjeorgjia me 15.3 dhe Shqipëria dhe Ukraina me 13.7.

Norvegjia dhe Zvicra, me përkatësisht 2.7 dhe 2.8 kanë rrugët më të sigurta për të udhëtuar në Evropë, transmeton 'monitor'.

Përdoruesit e rrugës në këto vende kanë 5 herë më pak të ngjarë që të vriten në një aksident rrugor se në Shqipëri dhe 7 herë më pak se në Rusi, përcjell al-binfo.ch. Rekordin më të keq në botë e ka Afrika me 26.6 vdekje për 100 mijë banorë, e ndjekur nga Azia Juglindore me 20.7, sipas grafikëve që janë publikuar nga Euronews dhe i përkasin vitit 2016.

"Nuk mund të marr frymë", fjalët e fundit të gazetarit Khashoggi

Fjalët e fundit të gazetarit saudit, Jamal Khashoggi, përpara se ai të vritej, kanë qenë "nuk mund të marr frymë"

Zbulohet se fjalët e fundit të gazetarit saudit, Jamal Khashoggi, kanë qenë "nuk mund të marr frymë". Sipas lajmit në televizionin amerikan CNN bëhet e ditur se fjalët e fundit të gazetarit Jamal Khashoggi, përpara se ai të vritej, kanë qenë "nuk mund të marr frymë". CNN e bazoi lajmin e tij në një burim informacioni mbi hetimet rreth vrasjes së Khashoggit dhe përkthimin e një regjistrimi të zërit të momenteve të fundit të gazetarit Khashoggi.

Burimi i lajmit thekson se vdekja e Khashoggit nuk është një vrasje e kryer nga fillestarë, por e planifikuar paraprakisht, ku dhe Khashoggi ka bërë përpjekje kundër vrasësve. Në lajm jepen edhe informacionet që sipas regjistrimeve të zërit, trupi i Khashoggit është ndarë në pjesë me sharrë dhe se autorët kanë rekomanduar dëgjimin



e muzikës gjatë copëtimit të trupit të gazetarit. Po ashtu në lajm theksohet se nga regjistrimet e zërit konstatohet se pas krimit janë kryer disa biseda telefonike ku i janë dhënë informacione palës përballë.

Princi saudit, Mohammad bin Salman, ka qenë objekti i kritikave pas vrasjes së gazetarit, Jamal Khashoggi, më 2 tetor në Konsullatën e Përgjithshme të Arabisë Saudite. Është njoftuar se edhe Agjencia Qendrore Amerikane e Intelgjencës (CIA) ka arritur në rezultatin se Mohammad bin Salman ka dhënë urdhrin për vrasjen e Khashog-

git.

Ndryshe, dje, ministri i Jashtëm saudit, Adel al-Jubeir ka refuzuar kërkesat e Turqisë për t'i ekstraduar të dyshuarit e lidhur me vrasjen e gazetarit saudit, Jamal Khashoggi, i cili është vrarë në konsullatën saudite në Stamboll. "Ne nuk i ekstradojmë qytetarët tanë", ka thënë al-Jubeir para gazetarëve në Riad më 9 dhjetor, në fund të samitit, Këshilli për Bashkëpunim mes vendeve të Gjirit. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan ka kërkuar që Arabia Saudite të dorëzojë të dyshuarit për vrasjen e Khashoggit.



Nga Qerim LITA

(vazhdon nga numri i kaluar)

Me rastin e këtij përvjetori me peshë historike, e pashë të arsyeshme që përmes gazetës shqiptare KOHA - Shkup, të bëjmë shpalosjen e një pjesë të stenogramit nga mbledhja e jashtëzakonshme të Konferencës Komunale të LKM-Tetovë, mbajtur më 27 dhjetor 1968, në të cilën përveç udhëheqjes komunale morën pjesë edhe udhëheqës të lartë partiak e shtetëror si Angell Çemerski, sekretari Sekretariatit të KQ të LKM-së, Hysen Ramadani, anëtar i Sekretariatit të KQ të LKM-së, Hixhet Ramadani, nënkryetari i Kuvendit të RSM-së, Qamuran Tahir, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv (Qeverisë) së Maqedonisë etj. Shpalosja e pjesërishme të dokumentit bëhet për shkaqe teknike (i njëjti numëron rreth 100 faqe), ku përparësi u dhëm fjalimeve të tre funksionarëve të lartë komunistë shqiptar: Xhemali Veseli, kryetar i Konferencës komunale të LKM të Tetovës, Hysen e Hixhet Ramadani.

XHEMAIL VESELI: Vazhdimisht kanë qenë prezent përpjekjet për ndryshimin e strukturës ekzistuese e të punësuarve në organet e administratës pranë Kuvendit komunal në favor të kombësive. Viteve të fundit, për shkak përpjekjeve për krijimin e kuadrit profesional, është rritur dukshëm numri i vendeve udhëheqëse të pjesëtarëve të kombësive. M'u nga 12 vende udhëheqëse në administratën e Kuvendit, 6 prej tyre tash janë plotësuar me pjesëtarë të kombësive.

Duhet të nënvizohet se vëmendja e LK-së ka qenë vazhdimisht e orientuar kah sjellja e akteve të tilla normative, të cilat sigurojnë barazi të plotë. Kështu, në Kuvendin e Komunës së Tetovës, obligimeve në këtë drejtim u janë dhënë 10 neneve. Shumica e atyre akteve gjejnë vend e zbatim në jetë. Kështu, për shembull, aktet për sjelljen e detyrueshme të akteve më të rëndësishme të Kuvendit, edhe në gjuhët e kombësive janë realizuar në tërësi, madje në praktikë të gjitha materialet e aktet kuvendore botohen edhe në gjuhën shqipe, në disa shërbime në administratën e Kuvendit është siguruar dygjuhësia, firmat janë të shkruara në gjuhën shqipe, gazeta lokale "Pollog" botohet në dy gjuhë e ngjashëm. Viteve të fundit vërehen rezultate, veçmas nga krijimi i bazës së gjërë kadrovike të kombësive që kushtëzoi aktivitetet më të gjerë shoqëror dhe përfshirjen e tyre më të madhe në trupat përfaqësuese në organizatat shoqërore-politike, organeve vetëqeverisëse. Kështu, për shembull, nga gjithsej 26 deputetë nga regjioni i Komunës, 12 janë maqedonas, ndërsa 14 nga kombësitë. Nga gjithsej 120

ME RASTIN E 50 VJETORIT TË DEMONSTRATAVE TË TETOVËS (2)

SHQIPTARËT, PAKICË NË TETOVË

këshilltarë të zgjedhur, në të dy dhomat e Kuvendit të komunës, 67 janë maqedonas.

Përfshirja e kombësive në organizatat shoqërore-politike në Komunë, edhe pse nuk është në disproporcion me strukturën nacionale të popullsisë, tregon tendencë të rritjes së përhershme. Numri i kombësive në organizatat shoqërore-politike flet qartë për këtë: në LSPP nga gjithsej 54,509 anëtarë, 38.000 janë shqiptarë, ndërsa 2.852 turq; në LRS nga 7.901 anëtarë, 4.109 janë shqiptarë e 319 turq; në LKM nga gjithsej 3.177 anëtarë, 1.054 janë shqiptarë, 57 turq e 120 të tjerë. Të gjitha këto momente e shumë të tjera flasin se kombësitë, së bashku me kombin maqedonas, janë ngritur në subjekt aktiv të politikës e praktikës së përgjithshme në komunë. Këto ndërhyrje janë shumë evidente dhe asçfarë sjellje nihiliste nuk mund t'i përbuzin, t'i mohojnë.

Po në këtë periudhë, kur vëmendja e LK-së dhe të forcave tjera subjektive dhe të njerëzve punëtorë nga ky regjion, që orientuar në realizimin e detyrave shoqërore-ekonomike të cilat burojnë nga plani afatmesëm i zhvillimit të komunës, detyrat që i imponon reforma, në këtë periudhë kur bëhen përpjekje për realizimin e Orientimeve të KQ të LKJ-së, erdhi deri te demonstratat armiqësore, të cilat e cenuan rrjedhën normale të marrëdhënieve. Në fakt, më 22 e sidomos më 23 dhjetor të vitit 1968 në Tetovë, disa qindra pjesëtarë të kombësive shqiptare në mesin e tyre edhe një numër i mirë i nxënësve demonstruan nëpër rrugët e qytetit. Sheshi kryesisht ishte poligon për demonstratat të cilat zgjatën deri në orët e mbrëmjes, me çka sërisht erdhi deri te cenimi serioz i rendit e qetësisë publike e shqetësim për tërë opinionin tetovar. Gjatë kësaj, nga gjuajtja me gurë, janë lënduar katër policë, është demoluar një veturë e policisë, më shumë vitrina të dyqaneve tregtare, e gjithashtu janë thyer xhamat e disa veturave.

Diku rreth orës 14 një grup më i madh demonstruesish u futën në ndërtesën e organizatave shoqërore-politike, i demoluan hapësirat e Komitetit Komunal të LKM-së dhe nga dritarja e zyrës së kryetarit të Lidhjes së komunistëve marshuan me flamurin shqiptar. Gjatë tërë kohës sa zgjatën demonstratat, demonstruesit me një brohoritje rituale shprehnin parulla me përmajtje armiqësore.

Tërë çështja filloi me protestën e një grupi të pjesëtarëve të kombësive shqiptare, për shkak të gjoja përpjekjes së një qytetari maqedonas ta heq flamurin shqiptar të vendosur në dyqanin e një zejta-

ri. Më vonë u shfrytëzua si shkas për demonstrata, që patën karakter me përcaktim shumë të qartë dhe qëllime shumë të shprehura armiqësore. Shumë fakte (prezenca e njerëzve nga fshatrat, por edhe të tillë të cilët nuk jetojnë në regionin e komunës; vendosjen me dhunë të flamujve nëpër minare gjatë kohës së festës së Bajramit, jashtë dëshirës e udhëheqjes fetare; thirrja e punëtorëve të arsimit nga fshatrat të lajmërohen në Kuvendin komunal për shkak të xhirimit; thirrja e nxënësve shqiptarë të dalin në shesh për shkak mbajtjes së tubimit për Vietnamin; transparentat e shkruara e tjerë), flasin se demonstratat nuk kanë qenë spontane, nuk janë të rastësishme, të paqëllimta, por përkundrazi, të përgatitura paraprakisht, të pararenduar e të organizuara paraprakisht.

Është më se e qartë se demonstruesit nuk shtrinin kërkesa për zgjidhjen e çfarëdoqështjeje nga jeta shoqërore, ekonomike e politike të komunës, për të cilat angazhohet LK e bashkësia më e gjerë. Pra, demonstratat nuk e shtruan publikisht platformën, ato ishin pa orientim e kërkesa për zgjidhjen e problemeve e çështjeve nga jeta e marrëdhënieve socialiste te ne. Madje, nuk u shtruan as çështjet nga politika e barazisë së kombësive. Duhet të vlerësohet se çështje të tilla as që mund të shtraheshin, në radhë të parë se LKJ ka të përcaktuar politikë të drejtë ndaj çështjeve nacionale, dhe për këtë arsye Komiteti Qendror i LKM-së vetëm gjatë këtij viti (Mbledhja e Katërmbëdhjetë e KQ të LKM-së e Konkluzionet e Sekretariatit të KQ të LKM-së), në dy herë përcaktoi platformë edhe për realizimin e politikës së barazisë së kombësive në atë relacion në Komunë e Republikë, por edhe për arsye se qëllimet e demonstratave nuk ishin të orientuar në atë drejtim, por kanë qëllime irredentiste tejet të shprehura të orientuara kundër integritetit të Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, të cilat vepra në mënyrë të hapur i karakterizuan iniciatorët, organizatorët e bartësit e demonstratave.

Në thelb, ndaj tërë asaj që ndodhi këtyre ditëve në Tetovë, në mënyrë të dukshme gjendet shprehja e nacionalizmit e shovinizmit, një keqpërdorim i marrëdhënieve shoqërore demokratike, për zgjerimin e së cilës viteve të fundit janë investuar aq përpjekje të mëdha, në të cilat kombësitë realizojnë të drejta shumë të zgjeruara.

Është fakt se qëllimet e demonstratave fshehin orientimin e tyre kundër vëllazërimit bashkimin e uni-

tetin e maqedonasve, shqiptarëve, turqve e të kombeve tjera që jetojnë në këtë vend. Qasjet armiqësore e të dhunshme përbëjnë përpjekjen për zhvlerësimin e cenimin e asaj të arritjeve të ndritshme, përfitimt bazë të revolucionit popullor, për çka ky regjion dha shumë dëshmorë. Një ndër qëllimet e demonstratave është cenimi i marrëdhënieve demokratike vetëqeverisëse socialiste nga ku nisët kjo shoqëri, e njëherit injorimin e përpjekjeve të njerëzve punëtor për krijimin e kushteve për zhvillim të papenguar e sa më të shpejtë të jetës. Parullat të cilat u paraqitën gjatë kohës së demonstratave, taktika e tyre (në rreshtat e para të gjenden fëmijët), flasin për përgatitjen e organizimin e tyre. Parulla të caktuara dëshmojnë bindshëm se demonstratat kanë për qëllim të cenohet integriteti i Republikës Socialiste të Maqedonisë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. M'u për këtë shkak, nuk duhet të nënçmohen parullat, sepse nga ta mund të shihen marrëdhëniet e qëllimet e caktuara të demonstruesve. Ajo që demonstruesit dolën nën parullën "Tito - Parti", është njohuria e armikut se ajo parullë gjendet në zemrën e çdo qytetari tonë, e bëhet përpjekje që pas asaj parulle të fshehin, sepse në të kundërtën do të demaskoheshin. Ajo, është një maskë për tërheqjen në rrugë, sepse me parulla tjera do të ishte e pamundur një dalje e tillë.

Aspirata për cenimin e integritetit të Maqedonisë, bashkëngjitjen e këtyre krahinave kah Kosmeti dhe krijimin e Shqipërisë së dytë, është shprehur në parullën "Tito - Fadil". Kërkesa e tillë paraqet aktin kundër integritetit të RSM-së, një herë e përgjithmonë i cenon marrëdhëniet e përcaktuara shtetërore dhe ka implikime të parashikuara negative e të gjëra në marrëdhëniet ndërkombëtare. Më tej, parullat e brohoritura "Të jetoj Shqipëria", flasin për ndikimin e propagandës armiqësore shqiptare. Theksimi i emrave nga një shtet tjetër deri te të cila zbulohen qëllimet irredentiste të organizatorëve të demonstratave. Orientimi i demonstratave në Komitetin Komunal të LKM-së dhe demolimi i tij nuk është e rastit. Është më se e qartë se dikush u pengon në realizimin e qëllimeve të tyre. Ajo pengesë përbën LK, politika e sajë, angazhimi i sajë për zhvillimin e shoqërisë socialiste demokratike vetëqeverisëse, siç qe theksuar, të gjitha kombet e kombësitë në Jugosllavi, njëkohësisht i realizojnë të drejtat e tyre nacionale.

Është e domosdoshme të vlerësohet se armiku në realizimin e qëllimeve të veta nuk hasi në përk-

rahje të gjerë te njerëzit punëtor nga kombësia shqiptare, por arriti të përfshijë një pjesë të rinisë shkollore nga kombësia shqiptare në mesin e të cilëve veprojnë elemente të njohura konservative reaksionare e armiqësore nga ky regjion.

Pjesa më e madhe e popullsisë maqedonase dhe popullsisë paqdashëse shqiptare, ndaj asaj çmendurie të paparë, reagoi me mençuri, duke i vlerësuar demonstratat si akt të një qasjeje provokuese, armiqësore e shoviniste. Sjellja e këtyrë të njerëzve punëtorë e të qytetarëve maqedonas, shqiptarë e turq, në këto momente e të forcave tjera socialiste paraqet një kapital të madh, një adut e shtyllë e fuqishme për realizimin e mëtutjeshëm të politikës së LK-së. Tash kur ngjarjet analizohen në mënyrë më të qetë, shqyrtohen arsyet dhe jepet vlerësimi për aktivitetin politik të LK-së arrihet deri te tre konstatime themelore:

1. Se në mjedisin tonë ekzistojnë armiq të rregullimit shoqëror, se ata organizohen për aksione dhe se një "çmenduri" të tillë në Komunën e Tetovës është dëshira e tyre e kamotshme. Disa momente e përpjekje tregojnë se një punë e këtyrë është përgatitur një periudhë më të gjatë në këtë regjion. Ka pasur përpjekje për shënime pompoze të datave të historisë shqiptare, me qëllim - ndezjen e nacionalizmit e shovinizmit. Në diskutimet nëpër tubime të ndryshme, sidomos në mbledhjet e Kuvendit, ekzistojnë raste që të ngarkohet për qëndrime e raporte, të cilat janë të huaja për politikën e LK-së, në kundërshtim me reformat e ngjashëm.

2. Edhe pse LK-së i ishin të njohura këto momente e incidente, është fakt se ato nuk ishin sa duhet në qendër të vëmendjes së aktivitetit ideopolitik. Kjo nuk do të thotë se nuk pati luftë të hapur ideopolitike kundër bartësve të dukurive shoviniste nga të gjitha ngjyrat e frekuencat, por nuk pati ndërmarrje të masave konkrete. Për në të ardhmen, kjo duhet të jetë një mësim serioz.

3. Shumë brengosës paraqet fakti se në demonstratat mori pjesë edhe rinia. Kjo flet se elementet armiqësore te ajo ka siguruar një ndikim të caktuar. Mund të ketë pasojë shumë katastrofale për këtë shoqëri, për zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve vëllazërore nëse rinia lejohet të futet, të veprojnë në jetën shoqërore me botëkuptime të skajshme nacionaliste. Ky është një moment, i cili duhet të na brengos e të na obligojë të gjithë neve, veçmas ata që punojnë në edukimin e arsimitin e gjeneratave të reja.

(vijon në numrin e ardhshëm)

“Këtë do ta shohim, nëse ka diskonim nga delegatët dhe të gjithë sportdashësit në Maqedoni, do të ekzistonte mundësia që edhe un të kandidohem për kryetar të Federatës”, deklaroi Muhamed Sej dini.

Shkup, 10 dhjetor - Federata e Futbollit të Maqedonisë mbledhi Asamblesë e jashtëzakonshme, ku janë marrë disa nga vendimet kryesore për sa u përket ndryshimeve të statutit të saj. Në të ardhmen kandidat për postin e kryetarit të FFM-së, mund të jetë secili që shprehë interesim edhe pse nuk është delegat i kuvendit. Ky ndryshim në Statutin e FFM-së, u miratua me një vendim unanim të 88 nga 96 delegatëve të kuvendit që votua pro këtij ndryshimi. Kështu është ndryshuar zgjidhja e mëparshme sipas së cilës kandidati për kryetar duhej të zgjidhej nga radhët e delegatëve. Propozim ndryshimet në statutin e FFM-së, ishin pikët kryesore të këtij kuvendi, ndërsa qëllimi kryesor ishte lehtësimi i zgjedhjes së kryetarit të FFM-së. Në të ardhmen FFM-ja, do të ketë vetëm një nënkryetarë. Pas miratimit të këtyre ndryshime-

FFM-ja HAP DYERT PËR KANDIDATËT E MUNDSHËM PËR KRYETAR

KANDIDOHEM SEJDINI?



ve në statut, kryetari i FFM-së, mund të zgjidhet në Kuvendit e rregullt, që është planifikuar të mbahet në mars të 2019-tës. Ushtruesi i detyrës të presidentit të FFM-së, Muhamed Sej dini, pas Asamblesë së zhvilluar në fundjavë të Federatës së Futbollit të Maqedonisë, theksoi se tani me ndryshimit të një pjesë të statutit është hapur rruga për të gjithë që të konkurrojnë për vendin e parë në Shtëpinë e Futbollit vendor, një gjë nuk ka qenë asnjëherë e mundshme në këto 25 vite e fundit. “Me sa më kujtohet mua diku 25 vite nga ekzistimi i Federatës së futbol-


lit të Maqedonisë asnjëherë nuk ka qenë që kandidati për kryetar të FFM-së, të mos jetë delegat në kuvendin e federatës. Ndërsa tani i mundësohet që edhe nëse nuk është delegat në kuvend e ka atë të drejtë që të kandidohet për kryetar të FFM-së”, theksoi Muhamed Sej dini. Muhamed Sej dini, beson se Kuvendi i jashtëzakonshëm i Federatës së Futbollit të Maqedonisë do të zhvillohet në fund të muajit shkurt, kur pritet të zgjidhet edhe presidenti i ri i futbollit vendor. “Nëse gjithçka shkon si duhet besoj se nga fundi i muajit shkurt do të kemi kuvendin e jashtëzakon-

shëm për zgjedhjen e kryetarit të FFM-së”, tha Sej dini. Nga ana tjetër Sej dini, ende është në dilemë se a do të konkurrojë për numrin një të futbollit vendor. Mirëpo nëse merr pëlqimin e delegatëve, ai është i gatshëm që të kandidohet për postin e presidentit të FFM, një detyrë që është duke u ushtruar aktualisht në Shtëpinë e futbollit vendor. “Këtë do ta shohim, nëse ka diskonim nga delegatët dhe të gjithë sportdashësit në Maqedoni, do të ekzistonte mundësia që edhe un të kandidohem për kryetar të Federatës”, deklaroi Muhamed Sej dini.



Shkëndija pas Eduart Rrocas

Shkup, 10 dhjetor - Skuadra e Shkëndijës pasi përfundoi sezonin si kampion vjeshtor, menjëherë është hedhur në sulm për të forcuar ekipin për pjesën e dytë të kampionatit. Emri i fundit që lidhet me kuqezinjët është ai i mesfushorit Eduart Rroca i cili luan në kampionatin shqiptari te ekipi i Luftëtarit. Rroca kohëve të fundit ka probleme me skuadrën e tij aktuale, ndërsa sipas mediave në Shqipëri tani më ka depozituar kërkesën për zgjidhje të njëanshme të kontratës. Në këtë mënyrë, Shkëndija, përfiton shërbimet e lojtarit me parametra zero, duke mos paguar asnjë detyrim transferimi ndaj klubit të Luftëtarit. Kontrata e Eduart Rroca përfundon në vitin 2019, por janë pikërisht problemet financiare ato që favorizojnë ndërprerjen e këtij bashkëpunimi mes tij dhe klubit më herët.



Berisha ka përjetuar në moshë të re emocionet e përbaljes me Anglinë

Gjashtë vjet më parë, Valon Berisha pati mundësinë të luajë kundër yjeve të përfaqësueses së Anglisë. Atëbotë mesfushori i Lazios përfaqësonte Norvegjinë. Si 19-vjeçar, Berisha u paraqit gjashtë minuta në miqësoren që Norvegjia e humbi nga Anglia me rezultatin 1:0. Ndeshja e 26 majit të vitit 2012 ishte zhvilluar para rreth 21 mijë shikuesve në Oslo, shkruan sot “Koha Ditore”. Për 25-vjeçarin Berisha, ndeshja kundër Anglisë, për të cilën në atë ndeshje luajtën yje si Steven Gerrard, Ashley Young, James Milner e shumë të tjerë, do të mbetet ndër ndeshjet më të veçanta në karrierë. Kundër Anglisë, Berisha tani do të luajë me fanellë të Kosovës. Ai është lojtari i vetëm i Kosovës që në të kaluarën ka luajtur kundër Anglisë.

Dajaku i lumtur për debutimin në Bundesligë


Leon Dajaku të dielën ka konfirmuar se ka të ardhme të ndritur dhe se në Gjermani vlerësohet lart. Ndonëse ende vetëm 17-vjeçar, Dajaku ka debutuar në Bundesligën gjermane, njëren prej pesë ligave më të forta të futbollit në Evropë. Dajaku ka luajtur prej minutës së 75-të për Stuttgartin që pësoi 3:0 nga Borussia Mönchengladbach, në ndeshjen e javës së 14-të të Bundesligës. Dajaku e zëvendësoi grekun Anastasios Donis. Pak minuta pas hyrjes së tij në lojë, Stuttgarti mbe-

ti me një lojtar më pak në fushë dhe Dajaku nuk mundi të bënte shumë. Por regjistroi debutimin në Bundesligë si 17-vjeçar, si pak lojtarë të tjerë. “E kam thënë më herët se ndeshjen e parë në Bundesligë dua ta luaj si 17-vjeçar dhe këtë e arrita sot. Jam i kënaqur që kam debutuar, por natyrisht jo me rezultatin. Ky ishte vetëm fillimi për mua. Dua të luaj sërish. Pres të kem edhe paraqitje tjera në Bundesligë këtë edicion”, ka thënë Dajaku për gazetën të dielën mbrëma.



Ajdareviç pranë kalimit tek ish-skuadra në Suedi

Disa ditë më parë, mesfushori i kombëtares shqiptare të futbollit, Astrit Ajdareviç, u largua nga klubi i AEK Athinës. Pas një eksperience të konsiderueshme në këtë klub, ku pati jo pak suksese, ndër to dhe ftesën në ekipin kombëtar të Shqipërisë, Ajdareviç tashmë është në pritje të gjetjes të klubit të ri. Për momentin mesfushori agresiv është kthyer pranë familjes së tij në Suedi, por po këtu pritet të jetë dhe e ardhmja e tij në futboll. Janë mediat suedeze ato që tregojnë se dy janë alternativat e momentit për Astrit Ajdareviç.



Goteborg është një prej klubeve që është lidhur së fundi me një interes për mesfushorin shqiptar, por gjasat janë që Ajdareviç të rikthehet te skuadra e Orebro. Ish-

klubi i mëhershëm i futbollistit shqiptar ka pranuar se lojtari është me cilësi, që do t`u bënte punë në skuadër. Tifozët e Orebro janë një tjetër faktor që shtynë

klubin të afrojë lojtarin në skuadër, tashmë që ai është me parametra zero. Ndërkohë, trajneri i Orebro, Axel Kjall, ka konfirmuar këtë fakt, në një intervistë të dhënë për mediat në Suedi. “Astrit Ajdareviç është një lojtar shumë i mirë, që kam pasur privilegjin të punoj me të dhe ai ka qenë në klubin tonë më parë. Unë kam biseduar me të diku, edhe pse nuk ka qenë kohë e fundit këtu, di që Drejtori Sportiv, Mangus Skoldmark, ka pasur kontakte me të dhe agjentin e tij. Ne po presim të shohim se çfarë do të ndodh”, është shprehur trajneri i Orebro.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
IP QENDRA NDËRKOMUNALE PËR PUNË SOCIALE TË QYTETIT TË SHKUPIT

Në bazë të nenit 110-e të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) ndërsa në lidhje me nenin 20-g dhe nenin 20-d paragrafi 3 dhe 4 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18) dhe Rregulloja për elementet e detyrueshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe forma, përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së regjistrimit të personave të cilët kanë parashtruar të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15), Drejtori i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të qytetit të Shkupit publikon

SHPLLJE PUBLIKE (e sërishme) NUMËR – 1/2018

Për punësim me kohë të pacaktuar të pesë (5) ofruesve të shërbimeve publike të kategorisë A profesionalë (punëtor social, psikolog, pedagog dhe jurist) në IP qendrën Ndërkomunale për punë sociale në qytetin e Shkupit, për vendet e punës në vijim:

1. CO30303A05002 **Punonjës social i diplomuar** - shërbyes profesional i pavarur nga niveli i pestë, dy (2) realizues:
- Shërbimi për të drejta të ndihmës me të holla në rajonin e komunës së Butelit - 1 (një) realizues;
- Shërbimi për të drejta të ndihmës me të holla në rajonin e komunës së Çairit - 1 (një) realizues;

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njih gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e veçanta

- Për nivelin A5, së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose VII/1 shkallë të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) dhe së paku dy vite përvojë të punës në sferën e mbrojtjes sociale.
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Kompetencat e përgjithshme të nivelit të mesëm:
- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/ punë ekipore,
- Orientim drejt palëve/ palëve të interesuara dhe
- Menaxhim financiar.

Orari i punës:

- Ditë pune: E hënë - E premte
- Orë pune në javë: 40 orë
- Orari i punës: nga 08:00 deri 16:00

Shuma neto e rrogës: 23.197,00 denarë
Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim të institucionit për vitin 2018 punësimet janë parapara për: 1(një) maqedonas/e dhe 1 (një) Shqiptar/e.

2. CO30303A05004 **Psikolog** - shërbyes profesional i pavarur nga niveli i pestë, 1 (një) realizues:
- Shërbimi për martesë dhe familje dhe dhunë familjare, Departamenti për dhunë familjare - 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njih gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e veçanta

- Për nivelin A5, së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose VII/1 shkallë të mbaruar (Pedagogji) dhe së paku dy vite përvojë të punës në sferën e mbrojtjes sociale.
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Kompetencat e përgjithshme të nivelit të mesëm:
- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/ punë ekipore,
- Orientim drejt palëve/ palëve të interesuara dhe
- Menaxhim financiar.

Orari i punës:

- Ditë pune: E hënë - E premte
- Orë pune në javë: 40 orë
- Orari i punës: nga 08:00 deri 16:00

Shuma neto e rrogës: 23.197,00 denarë
Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim të institucionit për vitin 2018 punësimet janë parapara për: 1(një) maqedonas/e dhe 1 (një) Shqiptar/e.

3. CO30303A05005 **Pedagog** - shërbyes profesional i pavarur nga niveli i pestë, 1 (një) realizues:
- Shërbimi për martesë dhe familje dhe dhunë familjare, Departamenti për dhunë familjare - 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njih gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e veçanta

- Për nivelin A5, së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose VII/1 shkallë të mbaruar (Pedagogji) dhe së paku dy vite përvojë të punës në sferën e mbrojtjes sociale.
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Kompetencat e përgjithshme të nivelit të mesëm:
- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/ punë ekipore,
- Orientim drejt palëve/ palëve të interesuara dhe
- Menaxhim financiar.

Orari i punës:

- Ditë pune: E hënë - E premte
- Orë pune në javë: 40 orë
- Orari i punës: nga 08:00 deri 16:00

Shuma neto e rrogës: 23.197,00 denarë
Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim të institucionit për vitin 2018 punësimet janë parapara për: 1(një) maqedonas/e dhe 1 (një) Shqiptar/e.

4. CO30303A05003 **Jurist** - shërbyes profesional i pavarur nga niveli i pestë, 1 (një) realizues:
-Shërbimi për mbrojtje të fëmijëve – 1 (një) realizues.

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njih gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e veçanta

- Për nivelin A5, së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose VII/1 shkallë të mbaruar (Shkenca juridike) dhe së paku dy vite përvojë të punës në sferën e mbrojtjes sociale.
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Kompetencat e përgjithshme të nivelit të mesëm:
- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/ punë ekipore,
- Orientim drejt palëve/ palëve të interesuara dhe
- Menaxhim financiar.

Orari i punës:

- Ditë pune: E hënë - E premte
- Orë pune në javë: 40 orë
- Orari i punës: nga 08:00 deri 16:00

Shuma neto e rrogës: 23.197,00 denarë
Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim të institucionit për vitin 2018 punësimet janë parapara për: 1 (një) Shqiptar/e.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e duhura është 5 (pesë) ditë pune llogaritur nga dita e nesërme nga publikimi i shpalljes (duke mos e llogaritur ditën e publikimit të shpalljes). Kushtet të theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë që nga momenti i paraqitjes.

Fletëparaqitja për shpalljen mund të tërhiqet nga arkivi i IP qendra Ndërkomunale për punë sociale Shkup ose të shkarkohet nga faqja e internetit të IP qendra Ndërkomunale për punë sociale të qytetit të Shkupit - <http://www.jumcsrskopje.gov.mk>

Kandidatët janë të detyruar që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, saktësisht dhe me të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin për kontroll të besueshmërisë së provave dhe kryerjen e një interviste, në faqen e internetit të IP qendrës Ndërkomunale për punë sociale të qytetit të Shkupit - <http://www.jumcsrskopje.gov.mk>

Të drejtë në pjesëmarrje kanë të gjithë banorët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim. Kandidatët me fletëparaqitjen duhet t'i parashtrorin dëshmitë për përmbushjen e kushteve, në formën origjinale ose kopje e vërtetuar në noter.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet t'i parashtrorin dokumentet e duhura për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta:

-Certifikatë të shtetësisë;
-Certifikatë për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;

-Vërtetim/Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

-Dëshmi për përvojën e punës;
-Dëshmi - Diplomë/Certifikatë për arsim të mbaruar;

-Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Fletëparaqitjen me dokumentacionin e duhur, kandidatët duhet ta parashtrorin në arkivin e IP qendrës Ndërkomunale për punë sociale Shkup ose përmes postës në adresën në vijim: rr."Nikola Vapcarov" nr. 11 - Shkup (me shënim për "shpalljen publike numër - 01/2018")

Departamenti i çështjeve administrative dhe menaxhimi i burimeve njerëzore - Komisioni për zgjedhjen e kandidatëve për ofrues të shërbimit publik.

Kontakt telefon: 02/3297-703; 02/3297-702

Fletëparaqitjet dhe dokumentet e dorëzuara me vonesë nuk do të mbikëqyren.

Pas skadimit të afatit për paraqitje shpallja do të largohet nga faqja e internetit të IP qendrës Ndërkomunale për punë sociale Shkup.

Drejtor
Natasha Stanojeviq

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mbrojtjes Jetësore
dhe Planifikimit Hapësinor
Ministria e mjedijet jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë
SHPLLJE
A - Lajm i integruar ekologjik për QD Çirani NHA SHkup, Ohridi
Ekonomi, Inkuubim, Tranzicion
Instalimi i QD Çirani NHA SHkup, (Ohridi, Tranzicion, Inkuubim, Tranzicion), do të realizohet nën mbrojtjen e Mbrojtjes Jetësore dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë. Ky objekt i projektuar do të përbëjë pjesën A-Lajm i integruar ekologjik. Instalimi sipas Rregullores për projektimin e skemave të instalacioneve, sipas skemave të:
1. Instalimi e montimi;
1.1 Ekipa instaluese e instalimit me kapacitet të përgjithshëm të cilësor për tërësinë e instalimit të objektit;
1.2 Ekipa instaluese të instalimit hapësinor i projektimit - (10/18)

NJOFTIM
Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" në Shkup, njofton që më datë **26.12.2018 (e mërkure) në ora 13**, kandidatja **M-r Aneta Arnaudovska** do ta mbron disertacionin e doktoraturës së saj me temë: **"Ndikimi i argumentimit juridik mbi cilësinë e aktgjykimeve penale në Republikën e Maqedonisë"**.
Mbrojtja do të realizohet në sallën e mbledhjeve në Fakultetin juridik "Justiniani i parë" - Shkup, Bul. "Goce Dellçev" 96 - Shkup (salla për NNS nën dekanin).
Nga Fakulteti juridik
"JUSTINIANI I PARË" Shkup

SHPLLJE
Shitet tokë në f.Arnaqi cila gjendet në PK 490/3, Vendi i quajtur Gjurište, me sipërfaqe prej 559 m2, e regjistruar në Fletë Pronësi nr. 192 për KK Arnaqi, në bashkëpronësi të Qamil Rustemi.
Të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, personat që pretendojnë përparësi të blerjes dhe persona tjerë të interesuar, ofertat e tyre mundë t'i paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

Instituti publik komunal çerdhja për fëmijë "Prolet" - Karposh - Shkup, bën korrigjim të shpalljes nga data 06.12.2018 në pjesën për vendin e punës 2. Mirëmbajtës i higjienës për kohë të pacaktuar, me arsim të mbaruar katërvjeçar, fshihet dhe ndryshohet si në vijim: me arsim fillor ose të mesëm, me ose pa përvojë pune.

SHPLLJE
Shitet tokë në f.Llaskarcë e cila gjendet në PK 761, Vend i quajtur HURDA OGRADA, me sipërfaqe prej 1517 m2, e regjistruar në Fletë Pronësi nr. 412 për KK Llaskarcë, në bashkëpronësi të Mehas Sait dhe Huna Hasani.
Të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, personat që pretendojnë përparësi të blerjes dhe persona tjerë të interesuar, ofertat e tyre mundë t'i paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

URGJENTISHT
Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

“Kam shkuar për të ndihmuar një Milan në vështirësi. Avantazhi i të qenit një ish-lojtar i madh zgjati një javë në stol, pastaj u mora me substancën e profesionit. Isha shumë i vetmuar në atë periudhë, por përkundër kësaj, ne krijuam një grup të bashkuar, për të siguruar numra të rëndësishëm: 35 pikë në 19 ndeshje, me një lojë të pranueshme. Isha gati të filloja sezonin e ri, por ata morën vendime të tjera”, ka deklaruar Seedorf


SEEDORF TREGON SEKRETET E MILANIT



gjithçka dhe pranova të bëja trajnerin e Milanit. Pas 24 vitesh aktiv në fushën e blertë, isha gati për një sfidë të re”, ka theksuar Seedorf. Një nga temat e nxehta mbetet “Topi i Artë”, një trofe që kurrë nuk e fitoi në karrierën e tij: “Edhe shumë kampione të tjerë, me të cilët kam luajtur, nuk e kanë fituar atë. Kam fituar trofe shumë të rëndësishëm me klubet, ku kam luajtur. Pastaj, edhe për zgjedhje taktike, nuk kam luajtur gjithmonë me numrin 10. Për një kohë të gjatë kam qenë në rolin e mesfushorit në të gjithë fushën dhe kjo ka marrë pak protagonizëm”, tha ai. I pyetur se sa kushton koka (truri) në futboll, ai tha: “Çdo gjë fillon nga koka, është thelbësore. Pastaj vjen çdo gjë tjetër, si fiziku

dhe ambicia”. Disa fjalë edhe mbi modelet që e frymëzojnë: “Ka shumë njerëz, që më frymëzojnë. Të tillë si Oprah Winfrey, ose Phil Jackson. Ka shumë njerëz, madje jo në botën e sportit, të cilët më kanë frymëzuar dhe shpresoj t'i takoj një ditë”. Një tjetër temë e nxehtë është fakti i braktisjes së fushës, në rast të koreve raciste, siç tha Ançeloti: “Unë pajtohem se duhet bërë diçka. Por, gjithmonë kam qenë kundër faktit që të gjithë duhet të paguajnë për disa persona, që bëjnë kësi gjërash. Sot kemi të gjitha mjetet për të identifikuar ato grupe të vogla dhe, siç bënim në Angli, vetëm ata njerëz duhet të dëbohen. Asgjë nuk ka ndryshuar, që nga largimi im nga fusha e blertë”, ka deklaruar Seedorf.

Natyrisht, holandezi ka nostalgji për Ligën e Kampionëve: “Kësi kompeticionesh ju lejojnë të konkurroni me më të fortët. Aty doni të provoni se jeni më të fortë se të tjerët. Kjo është bukuria e Championsit, kjo të stimulon shumë”, theksoi Clarence. Për avantazhet e bërjes së rolit të trajnerit, pas të qenit lojtar i madh, ai thotë: “Ky avantazh me lojtarët nuk zgjat më shumë se një javë, pastaj substanca është e nevojshme”. Në fund, Seedorf zbulon ëndrrat që ende dëshiron të përmbushë: “Unë ëndërroj vazhdimisht. Sigurisht, duke qenë brenda futbollit. Ky sport është një mjet për të kontribuar në një botë më të mirë”, ka deklaruar Clarence Seedorf.



E duan gjigantët e Europës, babai i yllit holandez zbulon klubin e ri

Deklaratat e fundit vijnë nga babai i Frenkie De Jong, i cili hedh poshtë spekulimet mediatike se djali i tij është fare pranë PSG-së. Po ashtu, ai hedh dritë mbi qasjen e Barcelonës në këtë rast: “Me 95%, djali im do ta lërë Ajax në fund të sezonit. Sidoqoftë, e pranoj se Barcelona do të ishte vendimi më i mirë për të ardhmen e tij”, – thotë babai i futbollistit holandez. “De Telegraf” ka shkruar të premten se klubi parizien kishte arritur një marrëveshje me Ajax, por vetë lojtari dhe përfaqësuesi i tij e mohoi këtë gjë. Pra, e ardhmja e talentit holandez është pezull. Babai ka besim te zgjedhja e De Jong: “Ai duhet të vendosë vetë, sepse është një djalë shumë i zgjuar. Jam i sigurt se do të marrë vendimin e duhur në pranverë. Ka 95% shanse për ta lënë Ajax. E përsëris, për mua, Barcelona do të ishte zgjedhja më e mirë”, shpjegoi ai. Për një nga yjet e rinj të futbollit holandez janë interesuar disa prej skuadrave më të mëdha, duke përfshirë Barcelonën, Manchester City dhe PSG. Nëse deri më tani besohej se francezët e kishin “kopsitur” mesfushorin e Ajax, fjalët e babait të De Jong vendosin katalanasit në ballë të kësaj beteje në merkato.

“Te Milani e ndjeva vetëm si trajner, atje bëmë gjëra të mëdha”, kështu tha Clarence Seedorf, teksa ishte mysafir i “Pressing”. Aty ka folur mbi përvojën e fundit të tij në Itali, si trajner te kuqezinjtë. “Kam shkuar për të ndihmuar një Milan në vështirësi. Avantazhi i të qenit një ish-lojtar i madh zgjati një javë në stol, pastaj u mora me substancën e profesionit. Isha shumë i vetmuar në atë periudhë, por përkundër kësaj, ne krijuam një grup të bashkuar, për të siguruar numra të rëndësishëm: 35 pikë në 19 ndeshje, me një lojë të pranueshme. Isha gati të filloja sezonin e ri, por ata morën vendime të tjera”. Holandezi i është rikthyer karrierës së tij: “Unë jam shumë i kënaqur me karrierën si futbollist. Vetëm për këtë arsye kam hequr dorë nga

Barcelona gjen zëvendësuesin e Suarezit

Barcelona dëshiron ta transferojë sulmuesin e Evertonit, Richarlisonin. Sulmuesi brazilian u transferua në verë te ‘Toffees’ për shumën e 50 milionë eurove, duke braktisur klubin e Watfordit, shkruan “Daily Stars”. Richarlison është duke shkëlqyer te Evertoni, ndërsa Barcelona po tenton t’i marrë shërbimet e tij që në merkaton e janarit. Richarlison konsiderohet si zëvendësuesi ideal i Luis Suarezit që pritet t’i japë fund aventurës tek Barcelona.



Messi dhe goditjet e dënimit, gjithë klubet e Europës nuk shënojnë sa ai



Nuk është harruar ende çudia e Topit të Artë, ku Lionel Messi u rendit në vendin e pestë, dhe argjentinas vazhdon të tregojë se është ende në majën e botës, aty

ku vetëm Ronaldo ka guxuar t’i bëjë shoqëri. Portugezi po mahnit në Itali dhe Messi vazhdon të dhurojë spektakël në Spanjë, së fundi në sfidën kundër Espanyol-it, derbi i

madh i qytetit. Triumf me poker, vendi i parë në La Liga dhe paraqitje madhështore nga numri 10 argjentinas. Janë 17 gola në 17 ndeshje këtë sezon, por dy golat kundër Espanyol-it janë të veçantë, sepse Messi i shënoi direkt nga goditja e dënimit. Një specialitet për të majtën e “Pleshtit”, i cili shënoi në minutat 17 e 65, hera e parë që e bënte brenda një ndeshjeje. I fundit që e ka bërë diçka të tillë është një djalosh që quhet Ronaldinho, në vitin 2007. Prej fillimit të sezonit 2017/18, duke marrë në konsideratë 5 kampionatet më të fortë të Europës, Messi ka shënuar 9 gola me goditje dënimi në La Liga. Një bi-

lanc fenomenal, vetëm Enis Bardhi i afrohet, me 6 gola për Levanten e vogël, ndërsa janë larg Kolarov, Depay e Fekir, me nga 4 gola nga goditja e dënimit. Nëse bëhet një bilanc për 4 sezonet e fundit në 5 kampionatet më të mëdhenj në Europë, shifrat janë impresionuese. Messi ka shënuar 19 gola nga goditja e dënimit në 4 sezone, ndërsa asnjë klub nuk ka mundur ta kalojë, me Juventusin që i afrohet, me 18 gola nga goditjet e dënimit, falë emrave si Pjanic e Dybala. Pas tyre, Reali ka 5 gola më pak se Messi, ashtu si Lyon e Roma, ndërsa Bayern ka shënuar 13 gola nga goditjet e dënimit në 4 sezonet e fundit.




Marotta prezantohet me 13 dhjetor te Interi

Mediat italiane raportojnë datën e zyrtarizimit të Giuseppe “Beppe” Marottas në krye të Interit. Sipas burimeve të “Corriere della Sera”, Marotta ditën e enjte (13 dhjetor) do të zyrtarizohet dhe prezantohet në cilësinë e drejtuesit më të ri të Interit. Ish-administratori i deleguar i Juventusit do të ketë menjëherë detyrën aspak të thjeshtë, të ndihmojë trajnerin zikaltër, Luciano Spalletti dhe skuadrën që të dalin nga një moment i komplikuar. “Në këtë mision të vështirë, Interi mund të ndihmohet nga afrimi i Marottas. Prezantimi i tij në rolin e ri si drejtuesi i ekipit zikaltër do të bëhet ditën e enjte. Administratori i deleguar i ri, do të jetë një mbështetje për trajnerin Spalletti. Të fitojë me PSV, duke shpresuar më pas në kualifikim për në fazën tjetër, është misioni i parë për të mbytur krizën dhe histerizmat”, shkruan gazeta e njohur italiane.

Pavarësisht se kush do të luajë, ne e respektojmë shumë këtë kompeticion dhe duam ta fitojmë ndeshjen. Do ta bëj formacionin në bazë të interesave të Barcelonës dhe jo në bazë të atyre të Interit", ka deklaruar Valverde

LIGA E KAMPIONËVE

VALVERDE DHE MESAZHI ENIGMATIK QË SHQETËSON INTERIN



Një fitore e rrumbullakosur dhe bindëse, mjaftueshëm për t'i dërguar një mesazh Tottenham përpara ndeshjes së Champions League të martën. Me Inter-in veçanërisht të interesuar për rezultatin e kësaj ndeshjeje. Barcelona u largua nga "Cornelia el Prat" me një rezultat 4-0 në derbin kundër Espanyol. Tani djemtë e Valverdes janë duke e përgatitur ndeshjen kundër "Spurs" në qetësi të plotë, duke qenë se janë të parët në grup. Por trajneri blaugranas ka siguruar se: Barcelona nuk do të bëjë as mbledhje dhe as zbritje, por do të futet në "Camp Nou" me qëllimin për ta fituar ndeshjen. Muzikë, për veshët e tifozëve zikaltër: "Jam shumë i kënaqur me fitoren, sepse e dimë sa i rëndësishëm është një derbi. Nuk është e lehtë të fitosh në fushën e Espanyol-it dhe ne e dimë mjaft mirë këtë pasi humbëm ndeshjen e parë të sezonit këtu", ka theksuar Valverde. Më pas, në mënyrë enigmatike, ka

shtuar: "A do të jetë Messi në fushë kundër Tottenham? Pavarësisht se kush do të luajë, ne e respektojmë shumë këtë kompeticion dhe duam ta fitojmë ndeshjen. Do ta bëj formacionin në bazë të interesave të Barcelonës dhe jo në bazë të atyre të Interit", ka deklaruar Valverde. Trajneri i Interit, Luciano Spalletti, ka zbuluar se Radja Nainggolan është jashtë sfidës vendimtare ndaj PSV-së. Ndërkohë, në dyshim të madh është edhe Matias Vecino i cili po ashtu është në dyshim për sfidën kryesore të Ligës së Kampionëve. Nerazzurët kanë nevojë për fitore ndaj kampionit të Hollandës, ndërsa duhet të shpresojë se Tottenhami nuk fiton në Camp Nou. "Nainggolan nuk do të jetë gati me kohë për të martën. E lashë Vecinon në stol sepse ka pasur problem muskular dhe nuk mund të

luajë. Ne do të shohim nëse ai rikuperohet për të martën, por mjeku ka thënë që ta lëmë të psuhohet dhe do të rikuperohet. Duke parë se Roberto Gagliardini dhe Joao Mario nuk janë në listën tonë, është dashur ta lë Borja valeron në stol dhe më pas ta pushoj Politanon që të jetë në formë për të martën", deklaroi Spalletti. Mesfushori i Tottenhamit Dele Alli e konsideron Lionel Messin si "lojtarin më të mirë në botë dhe një gëzim për ta parë", por thotë se "Tottenham nuk e ka frikë Barcelonën", sepse edhe skuadra katalanase është njerëzore dhe të gjithë bëjnë gabime. Gjigandët e La Ligas janë kualifikuar në fazën me eliminim direkt të Ligës së Kampionëve, ndërsa të besuarit e Mauricio Pochettino luftojnë me Interin për vendin e dytë në grup. Sulmuesi anglez, Dele Alli, ka thënë: "Mes-

si është një lojtar i adhuruar, për shkak të asaj që ka arritur në karrierën e tij. Për mua është lojtari më i mirë në botë. Është një gëzim për ta parë. Për të qenë i sinqertë, megjithatë, nuk jam shumë i shqetësuar për atë që katalanasit bëjnë me lojtarët e tyre". Tottenham, megjithatë, është duke u përpjekur të fokusohet në lojën e vet, me Dele Alli plot besim se mund të sigurohet raundi tjetër në Champions. Ai shtoi: "Ne, patjetër do të shkojmë me besim në transfertën me Barcelonën. E dimë se do të jetë e vështirë, por edhe katalanasit janë njerëzorë, si të gjithë, edhe ata bëjnë gabime. Do t'i ndëshkojmë, nëse japim gjithçka kemi. Barcelona është një nga skuadrat më të mira në botë, por ne do të shkojmë atje për të dhënë maksimumin. Mendoj se jemi gati. Do të jetë një ndeshje e vështirë, por këto janë lojërat, në të cilat dëshironi të jeni e ta tregoni veten. Kush nuk do të donte të luante kundër njërit nga ekipet më të mira në botë dhe disa prej lojtarëve më të mëdhenj në botë. Ju doni të sfidoni veten në kësi sfidash. Ne po shkojmë atje me mentalitetin që mund të fitojmë, prandaj duhet të besojmë", ka deklaruar Dele Alli. Carlo Ancelotti shijon Napolin e tij që fiton lehtësi-

sht me shumë gola ndaj Frosinone, pavarësisht përballjes që pritet të bëjë në mesjavë kundër Liverpool, në ndeshjen e vlefshme për fazën e grupeve të UEFA Champions League. Tashmë Napoli është i lirë të mendojë për transfertën e Anfield, ku do të diskutojë kualifikimin për në fazën tjetër të Champions. "Duhet të qëndrojmë të qetë dhe të ruajmë përqendrimin. Jemi në formë dhe disa futbollistë kanë përshtuar sot, kështu që shkojmë në kushtet më të mira. Është thelbësore që të kemi një përjasje pozitive, të tentojmë të marrim iniciativën, edhe sepse nuk dimë të luajmë në mënyrë tjetër. Nuk mund të mendojmë që të shkojmë atje dhe të parkojmë autobusin përpara portës tonë", deklaroi Ancelotti. Nga ana tjetër, Salah ishte këtë të shtunë autor i një tregolëshi kundër Bournemouth, aq sa për të trembur Napolin e Ancelottin: "Shpresojmë që të ketë dhënë gjithçka sot dhe të përfundojë pa energji për të martën... Unë kam një kujtim fantastik në Anfield, aty kam fituar Premier League me Chelsea. Sa për Championsin e humbur në Stamboll kundër Benitez, me Milan, preferoj të mbajë në kujtesë fitoren e Athinës kundër Liverpool", vijoi Ancelotti.

Publicitet



PESTOVA SHPK

THIRRJE PER TENDER

Furnizim „PAKETUESE BINJAKE PER PAKETIMIN E CHIPSIT“

- Referenca e publikimit : 02/2018
- Procedura : E Hapur
- Programi : MASA 103-INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE (NEN MASA E PERPUNIMIT TE , DHE PEMEVE PERIMEVE)
- Financuar : MBPZHR
- Autoriteti Kontraktues : PESTOVA sh.p.k
- Lloji i Kontratës : FURNIZIM
- Vendi : Pestovë, Vushtrri, 42000, Republika e Kosovës
- Koha : Dorëzimi i ofertave duhet te behet deri me **25.12.2018, ora 16:00.**
- Kriteri për përfutuesin e kontratës: Operatori me i favorshme ekonomikisht
- Dosja për tender mund te kërkohet me shkrim ose me e-mail nga ana e operatoreve te autoritetit kontraktues: vipa@pestova.org ose bedrikasumi@hotmail.com


Informata:

Për me shumë informata ju lusim kontaktoni direkt në zyrën e kompanisë Pestova sh.p.k apo ne tel. +377 44 360 182

Afati i fundit për dorëzim te propozimit 25/12/2018,ora 16:00



Government of Kosovo
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development





DASHI 21. mars - 20. prill

Mos kërkoni gjate gjithë kohës te dominoni jetën tuaj ne çift apo ta kritikoni për çdo gjë partnerin. Kjo metode është e gabuar dhe mund t'iu sjelle shume probleme. Beqaret duhet te tregoheni shume te vëmendshëm sepse mund t'iu dalin para persona vërtet interesante. Planetët do jene te favorshëm për planin financiar dhe do mundohen t'ua plotësojnë dëshirat.



DEMI 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia me partnerin do jete me e ngrohte gjate kësaj dite. Plutoni do iu nixte te tregoheni me te hapur dhe te mos keni druajtje te shprehni edhe ato qe nuk iu pëlqejnë ne çift. Takimet e beqareve do te shtohen. Do jeni me romantike dhe do bëni gjithçka qe ai qe iu pëlqen te behet i juaji. Kujdes me financat. Jupiteri do iu beje te shpenzoni shume dhe do hasni probleme goxha te mëdha.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Marrëdhënia me partnerin nuk do shkoje ashtu si e keni menduar. Do ketë një ftohtësi me njeri-tjetrin dhe nuk do ndiheni shume rehat. Beqaret do jene te rrethuar nga persona interesante. Përfitoni për t'i njohur sa me mire ata sepse jo gjithmonë vijnë dite te tilla. Nëse bëni shpenzime te tejskajshme do keni shume probleme financiare.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeta ne çift do jete shume e qëndrueshme gjate kësaj dite. Asnjë planet nuk do influencojë tek ajo dhe do ndiheni mire. Venusi do favorizojë takimet për beqaret por ju ende nuk do ndieni gëzim ne shpirt. Personat qe do takoni nuk janë ata qe keni ëndërruar. Situata financiare pritet te rregullohet, por gjithsesi duhet te bëni kujdes me shpenzimet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Venusi do jete i pozicionuar mire ne jetën e çifteve sot. Shume prej jush do ndihen me se mire dhe gati per te marre vendime te rëndësishme mbi te ardhmen. Beqareve do iu jepet një mundësi nga e cila duhet te përfitojnë sa me shume. ne fakt disa probleme te jashtme do iu afrojnë me tepër me te. Jupiteri do iu mbështesë ne planin financiar.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dashuria ne çift do jete prioriteti juaj gjate kësaj dite. Do bëni gjithçka qe është e nevojshme për t'i dhënë me shume gjallëri marrëdhënies qe keni krijuar. Beqaret do kenë një takim me rëndësi. Do jeni joshës dhe bindes. Dita do jete plot dite dhe ngrohtësi. Kujdes nga Marsi ne planin financiar sepse ai mund t'iu shtyje te bëni shpenzime super te mëdha.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Jupiteri do iu shtyje te luani si fëmijë te lumtur ne dashuri. Mos abuzoni me këtë loje sepse do përballeni me disa konflikte e debate. Beqaret nuk duhet te nxitohen për te bere për vete atë qe duan sepse do pengohen dhe do lëndohen. Ambienti planetar për financat nuk do jete shume i favorshëm. Mos jepni hua sepse nuk do mund t'i rikuperoni dot dhe do keni shume probleme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mund ta ndjeni veten të frenuar për shkak të disa problematikave lidhur me të kaluarën, e cila do të rishfaqet në këtë periudhë. Kryesisht do të dominojnë keqkuptimet të natyrës sentimentale dhe familjare.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Çiftet do i zgjidhin me mirëkuptim dhe qetësi mosmarrëveshjet qe kane pasur kohet e fundit. Do merrni edhe një vendim te rëndësishëm për te ardhmen. Fale mbështetjes se Venusit dhe Plutoni iu do mund te krijoni një lidhje mjaft intensive me dike qe jeton jashtë por qe ka ardhur për pak kohe këtu. Do ndiheni mire. Do keni një strategji te mire financiare dhe do ruani ekuilibrin.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Nëse jeni ne çift nuk duhet t'i merrni gjerat me vrull dhe te nxitoheni. Nëse e doni aq shume sa thoni njeri-tjetrin gjithçka do shkoje për mrekulli dhe ndjenjat nuk mund te shuhen. Nëse jeni beqaret nuk duhet te keni frike te tentoni. Mundësitë për takime do jene te shumta dhe interesante. Ne planin financiar do kryeni transakcione te rëndësishme dhe do tregoheni me realiste.



UJORI 21. janar - 19. shkurt


Jupiteri do iu beje edhe me entuziaste sot ne jetën ne çift. Klima do jete e ngrohte dhe harmonike. Shfrytëzoni ditën sa me shume te mundni. Për beqaret dita do jete e qete dhe nuk do keni takime. Qëndroni pak me shume kohe me miqtë dhe me familjaret. Me financat duhet te tregoheni me te kujdesshëm nëse nuk doni qe ato te tronditen. Do merrni një ndihme goxha te madhe nga dikush.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ne jetën ne çift do ndiheni mjaft mire gjate kësaj dite. Disa do kalojnë momente te mrekullueshme dhe plot emocione. Beqareve do iu vije ne maje te hundës vetmia. Mos u mërziniti sepse sot mundësitë do jene te shumta dhe mjaft te mira. Sektori i parave nuk do ketë ndonjë ndryshim te madh. Mundohuni te shpenzoni me kursim dhe do e shihni qe gjerat do shkojnë mire.

Mensur Mamuti	SHKENCËTARI SAKSONI NË FOTO	JOJETAR	SHKRONJA FOINJE	BABAI	DEGA E CMMIT NOBEL, E FITUAR NGA SHKENCËTARI NË FOTO, NË VITIN 1905
HUMORISTI KOSOVAR, THAQI (CIMA)					
RËNKOJ T'HELLË E PSHERETU					
BASHKIMI EVROPIAN			TETOVA BANOR I KRYEQYTETIT TË NIGERIT		
QË LIDHET ME NJË POPULL APO NJË KOMB					
RADIO TELEVIZIONI ITALIAN				ZANORJA E TRETË JO POZITIV	
EKSTAZË					
KALUMI		ATLETI ITALIAN, STEFANO VJAJA QË LAKOHET NË TË DYJAJA ANËT			
ISH FUTBOLLISTI RUS, BLOHIN					PJESËTARI I LËVIZJES PASHTU TË AFGANISTANIT



NE KETE DATE

11 DHJETOR 1843
27 MAJ 1910

SHSHI PARA SHTEPISË						QYTET NË INDONEZI	SHUMË I MADH (PERD. MB.)	PJESA RROTULLJESË E NJË MEKANIZMI	AGIM POSHKA	ITHTARI I NUDIZMIT
KOHA	LLOJ BARKE INDIANE ME VELA KULMI I NJË ZHVILLIMI (SH.)									
VOJVODE MOLDAVE NË VITET 1634-1653										
LUAN DAKA			FUTBOLLISTI KILIAN, ARTURO KLUB FUTB. I SELANIKUT						GJERMANIA I VËRTETË	
NDËRTIMI MBI LUMË				ISH PRESIDENTI TOPI (SHQ.) METRI						
SHITËSIA E SHKENCËTARIT NË FOTO								AJNSHTAJNIUMI RENTGENIUMI		
I VOGLI I DHISË				KRIPË E ACIDIT NITRIK TEMPERATURA						
PJESË E TASTIERËS (SHQ.)						FUTBOLLISTI SHQIPTAR, TARE				

ZGJIDHJET: RASIM, OFSHAJ, BE, TE, ETNIK, RAI, E, TRANS, K, MEI, OLEG, HAJAT, KATAMARAN, VASILE LUPU, LD, VIDAL, D, URA, BAMIRI, GJERMANE, ES, EDHI, NITRAT, TASTI, IGLI.

shumë i lehtë

		3	1			2	
5			4				8
	4			3			
		2				1	
			6		3		
		8				4	
				7			3
2			8				5
	5			9		6	

Sudoku

8	7	4					
2			9	6			
6	3				5		
	3						8
	8			1			9
7							2
		9				8	4
			6	8			1
					5	7	2

mesatar

Shumë i lehtë: 683915724, 529467318, 741238569, 962754183, 415683297, 378129456, 194576832, 236841975, 857392641. Mesatar: 897453216, 245196387, 613278549, 936524178, 482317695, 751869423, 529731864, 374682951, 168945732.

24 MILIARDË DOLLARË PËR KAFSHËT SHTËPIAKE!

Tregu i qenve dhe maceve në vend vlerësohet të arrijë mbi 170 miliardë juanë (rreth 24 miliardë dollarë amerikanë) në 2018-n, një rritje 27 për qind nga viti në vit, thuhet në raport, sipas CRI-së. Raportin thekson gjithashtu shpenzimet e pronarëve të qenve në vitin 2018 janë 5.000 juanë për kafshë, një rritje prej 15 për qind nga viti 2017. Pronarët e kafshëve në qytetet kryesore janë më të gatshëm për të blerë ushqim cilësor dhe të shtrenjtë për kafshët e tyre, sipas raportit. Wang, i cili pu-

non në një kompani të huaj me seli në Pekin, tha se preferon ushqimin e importuar të maceve, i cili i kushton rreth 300 juanë çdo muaj.

Shpenzimet e tjera për kafshët shtëpiake përfshijnë sterilizimin, vaksinat, trajtimin mjekësor dhe trajnimin. Wang Junyue, një 24-vjeçare nga Pekini shpenzon një të dhjetën e pagës së saj për pjesëtarin e familjes me qime, maçokun shtatë muajsh, për ushqimin, nevojat e përditshme, lodrat etj. Shpenzime të tilla janë të



zakonshme tek mbajtësit e kafshëve shtëpiake në Kinë të cilët shpenzojnë shifra jo pak të vogla për kafshët e tyre, sipas një raporti nga goumin.com, një forum në internet në muajin gusht. Sipas raportit, mbajtësit e kafshëve shtëpiake në zonat urbane mbajnë një prej 91.49 kafshësh shtëpiake ku pjesa dërrmuese janë qentë dhe macet.



Kanella, erëza që sulmon viruset



Një nga zgjidhjet natyrore për viruset është aroma e kanellës antimikrobiale, e cila ka fuqinë për të ndaluar rritjen dhe riprodhimin e baktereve, viruseve dhe kërpudhave. Studimet tregojnë se ajo shpesh është më efektive se shumica e barnave. Ekspertët në bazë të studimeve erdhën në përfundim se kanella është shumë e fuqishme kundër viruseve, pasi është në gjendje të ndalë zhvillimin e organizmave të rrezikshëm patogjen deri në 60 ditë. Ata sugjerojnë ta vendosni kanellën në menyne e përditshme si një erëz në ëmbëlsira, gjellët e kripura dhe pijet frutore.

8 muajshe shtatzënë, fqinja i çan barkun për t'i vjedhur foshnjën


Një vajzë 22-vjeçare, e cila ishte 8 muajshe shtatzënë, vdiq pasi fqinja i preu barkun duke vjedhur foshnjën e saj. Viktima e re ishte një infermiere, gjithmonë e gatshme për të ndihmuar të tjerët. Edhe në atë rast, vajza kishte rënë dakord të ndihmonte qiramarrësen në katin e sipërme që të qepte një fustan. Pastaj tragjedia. Kjo ndodhi në Dakotën e Veriut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Siç raporton Mirror, Savannah Greywind, ky është emri i viktimës e, kishte shkuar lart për të ndihmuar Brooke Creës, 36 vjeçe, për të qepur një fustan. Brooke madje i kishte ofruar paratë e saj për shqetësimin që i kishte shqetësuar. Savannah nuk mundi të priste të bëhej nënë, ajo ishte vetëm një muaj larg nga dita e madhe. Edhe Brooke dëshironte të mbante në dorë një fëmijë. Madje kishte mashtruar edhe të dashurin e saj, William Hoehn, 32 vjeç, se ajo ishte sh-

tatzënë. Por humbja e kohës dhe dështimi për të mbetur shtatzënë, fqinja përbindësh kishte hartuar planin e keq. Ajo e kishte ftuar Savannah në shtëpi me një justifikim. Pastaj nis që të përleshet duke e hedhur në tokë nënë e re.

Në këto momente Savannah kishte humbur ndjenjat dhe Brooke i hap barkun për t'i vjedhur fëmijën e saj. Sipas hetuesve, vajza 22-vjeçare ishte akoma gjallë kur fëmija ishte marrë nga barku i saj. Fqinja djallëzore nuk kishte marrë ambulancën që t'i shpëtonte jetën asaj, por e la që të vdiste. Duke mos gjetur Savannah, burri i saj Ashton Matheny, 21 vjeç, ngriti alarmin. Dhe në një kohë të shkurtër hetuesit arritën tek Brooke që rrëfeu krimin. Babai Ashton, zemërthyer nga humbja e Savannah, e quajti foshnjën Haisley Jo, emrin që kishte zgjedhur së bashku me gruan e tij.



KY VIÇ ËSHTË MË I VOGËL NË BOTË



Ky viç në foto thuhet se është më i vogli në botë. I quajtur Lil' Bill, peshon vetëm 4.5 kilogramë, i njëjtë me një mace shtëpiake dhe afërsisht sa një e dhjeta e viçave tjerë të moshës së tij. Viçi i vogël është dërguar në kolegjin e veterinarisë "The

Mississippi State College of Veterinary Medicine", në Shtetet e Bashkuara, për t'u kontrolluar pasi pronarët e saj ishin të shqetësuar se mos është i sëmurë, shkruan Mirror. Por, fatmirësisht, Lil' Bill është në gjendje shumë të mirë shëndetësore përveç se është shumë më i vogël se viçat tjerë të të njëjtës moshë.

Me të arritur në këtë universitet, ekspertët e kafshëve kanë publikuar menjëherë fotografitë e Lil' Billit në faqen e tyre të Facebookut me mbishkrimin: "Kohë pas kohe, na vijnë rastet që na bëjnë të habitemi. Lil' Bill është njëri nga ato rastet? Ai është lindur me peshë gati sa 1/10-ta e peshës së viçave të porsalindur".

1419 - Heretiku Nicolaas Serrurier largohet nga Firenca.

1618 - Rusia dhe Polonia nënshkruajnë Traktatin e Dailinos për paqe.

1688 - Arrestohet Mbreti Xhejms II.

1710 - Beteja e Villa Viciosa (Franca mund Habzburgët)

1816 - Indiana shpallet shteti i 19 i SHBA.

1906 - Presidenti amerikan Ruzvelt dënon abuzimet në Kongo.

1907 - Ndërtesa e parlamentit në Zelandë të Re shkatërrohet nga zjarri.

1917 - Lituania e okupuar gjermane shpall pavarësinë nga Rusia.

1930 - Banka e Shteteve të Bashkuara hapet në Nju Jork Siti.

1937 - Italia largohet nga Lidhja e Kombeve.

1941 - Qeveria holandeze në Londër i shpall luftë Italisë.

1941 - Gjermania dhe Italia i shpallin luftë SHBA.

1946 - Spanja përjashtohet nga OKB.


1946 - Themelohet Fondi për fëmijë (UNICEF).

1979 - Britania e Madhe i dhuron pavarësinë Zimbabvesë.



BROKOLI MUND TË DETOKSIFIKOJË ORGANIZMIN

Brokoli ka një efekt të fortë dhe pozitiv në sistemin e detoksifikimit të organizmit dhe është përgjegjës për kombinimin e tre fitonutrientëve, të cilat janë në një kombinim të veçantë në këtë ushqim. Këta tre elementë ndihmojnë të gjitha hapat në procesin e detoksifikimit të organizmit - aktivizimi, neutralizimi dhe eliminimi i substancave të padëshirueshme. Gjithashtu, brokoli përmban një kombinim jashtëzakonisht të fortë të vitaminave A dhe K, dhe për ata që nuk kanë vitaminë D, kjo perieme është një ushqim ideal që duhet të përfshihet në dietë. Një tjetër pasuri e dobishme e brokollit është një efekt antiinflamator, dhe në uljen e kolesterolit të keq.



Nuk mund të ketë atdhetarizëm pa liri, liri pa virtyt, virtyt pa qytetar. Krijoni qytetarin dhe keni çdo gjë që iu nevojitet. (Rousseau)